Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 17
Kontratat e Sigurimit

Objektivi

1 **SNRF 17 *Kontratat e sigurimit* paraqet parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese për *kontratat e sigurimit* të cilat janë objekt i këtij Standardi. SNRF 17 synon të garantojë që njësia ekonomike jep informacion përkatës (të rëndësishëm), i cili paraqet në mënyrë besnike këto kontrata. Ky informacion u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare që të vlerësojnë efektin që kontratat e sigurimit kanë në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare të një njësie ekonomike.**

2 Kur zbaton SNRF 17, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë të drejtat dhe detyrimet e saj kryesore që vijnë nga një kontratë, ligj ose rregullim tjetër. Kontrata është një marrëveshje mes dy ose më shumë palëve, që krijon të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme me forcë. Ekzekutimi me forcë i të drejtave dhe detyrimeve në një kontratë është çështje ligjore. Kontratat mund të jenë të shkruara, verbale ose të nënkuptuara nga praktikat e zakonshme të biznesit të një njësie ekonomike. Kushtet kontraktuale përfshijnë të gjitha kushtet dhe afatet në një kontratë, të shprehura ose të nënkuptuara, megjithatë një njësi ekonomike mund të shpërfillë kushtet që nuk kanë përmbajtje tregtare (d.m.th efekt të dukshëm ekonomik në kontratë). Kushtet e nënkuptuara në një kontratë përfshijnë ato të përcaktuara nga ligji ose ndonjë rregullim tjetër. Praktikat dhe procedurat e lidhjes së kontratave me klientët ndryshojnë në varësi të juridiksionit, industrisë dhe njësive ekonomike. Ato mund të ndryshojnë edhe brenda një njësie ekonomike (për shembull, ato mund të varen nga klasa e klientit ose natyra e mallrave apo shërbimeve të premtuara).

Objekti

3 Një njësi ekonomike do të zbatojë SNRF 17 për:

(a) kontratat e sigurimit, duke përfshirë *kontratat e risigurimit*, që ajo lidh;

(b) kontratat e risigurimit që ajo mban; dhe

(c) *kontratat e investimit me tipare të pjesëmarrjes së lirë* që ajo lidh, me kushtin që njësia ekonomike lidh edhe kontratat e sigurimit.

4 Të gjitha referencat në SNRF 17 për kontratat e sigurimit zbatohen edhe për:

(a) kontratat e risigurimit të mbajtura, me përjashtim të:

(i) referimit ndaj kontratave të sigurimit të lidhura; dhe

(ii) siç përshkruhet në paragrafët 60–70A.

(b) kontratat e investimit me tipare të pjesëmarrjes së lirë siç paraqiten në paragrafin 3(c), me përjashtim të referencës për kontratat e sigurimit në paragrafin 3(c) dhe siç përshkruhet në paragrafin 71.

5 Të gjitha referencat në SNRF 17 për kontratat e sigurimit të lidhura zbatohen edhe për kontratat e sigurimit të blera nga njësia ekonomike gjatë një transferimi të kontratave të sigurimit ose në një kombinim biznesi, të ndryshme nga kontratat e risigurimit të mbajtura.

6 Shtojca A përkufizon një kontratë sigurimi dhe paragrafët B2–B30 të Shtojcës B japin udhëzime mbi përkufizimin e një kontrate sigurimi.

7 Një njësi ekonomike nuk do të zbatojë SNRF 17 për:

(a) garancitë e dhëna nga një prodhues, ndërmjetës ose shitës me pakicë, lidhur me shitjen e mallrave apo shërbimeve të tij tek një klient (shih SNRF 15 *Të ardhurat nga kontratat me klientët*).

(b) aktivet dhe detyrimet e punëdhënësit sipas skemave të përfitimeve të punonjësve (shih SNK 19 *Përfitimet e punonjësve* dhe SNRF 2 *Pagesat e bazuara në aksione*) dhe detyrimet e përfitimit të pensionit të raportuara nga skemat e përfitimit të pensionit të përcaktuar (shih SNK 26 *Kontabiliteti dhe raportimi për skemat e përfitimeve për pensione*).

(c) të drejtat ose detyrimet kontraktuale të lidhura me përdorimin e ardhshëm, ose e drejta e përdorimit, të një zëri jo-financiar (për shembull, disa tarifa licencimi, pagesa për përdorimin e

pronës, pagesa të ndryshueshme dhe të kushtëzuara të qirasë si dhe zëra të ngjashëm: shih SNRF 15, SNK 38 *Aktive jo-materiale* dhe SNRF 16 *Qiratë*).

(d) vlera e mbetur e garantuar e siguruar nga prodhuesi, ndërmjetësi ose shitësi me pakicë dhe vlera e mbetur e garantuar e një qiramarrësi kur ato janë të përfshira në një qira (shih SNRF 15 dhe SNRF 16).

(e) kontratat e garancisë financiare, me përjashtim të rastit kur emetuesi ka deklaruar qartë se i sheh ato kontrata si kontrata sigurimi dhe ka përdorur trajtimin kontabël të zbatueshëm për kontratat e sigurimit. Emetuesi duhet të zgjedhë të zbatojë ose SNRF 17 ose SNK 32 *Instrumentet financiare: Paraqitja*, SNRF 7 *Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese* dhe SNRF 9 *Instrumentet financiare* për të tilla kontrata të garancisë financiare. Emetuesi mund ta bëjë zgjedhjen veçmas për çdo kontratë, por zgjedhja për secilën kontratë është e pakthyeshme.

(f) shuma e kushtëzuar e pagueshme ose e arkëtueshme në një kombinim biznesi (shih SNRF 3 *Kombinimi i bizneseve*).

(g) kontratat e sigurimit në të cilat njësia ekonomike është *policë mbajtës*, me përjashtim të rastit kur këto kontrata janë kontrata risigurimi të mbajtura (shih paragrafin 3(b)).

(h) kontratat e kartave të kreditit ose për kontrata të ngjashme të cilat ofrojnë marrëveshje kreditimi ose pagese, që plotëson përkufizimin e një kontrate sigurimi nëse dhe vetëm nëse njësia ekonomike kur vendos çmimin e kontratës për atë klient nuk pasqyron një vlerësim të *rrezikut të sigurimit* të lidhur me klientin individual (shih SNRF 9 dhe SNRF-të e tjera të zbatueshme). Megjithatë nëse dhe vetëm nëse SNRF 9 kërkon që njësia ekonomike të veçojë përbërësin mbulim sigurimi (shih paragrafin 2.1(e)(iv) të SNRF 9) të përfshirë tashmë në një kontratë të tillë, njësia duhet të zbatojë SNRF 17 ndaj atij përbërësi.

8 Disa kontrata plotësojnë përkufizimin e një kontrate sigurimi por kanë si qëllim kryesor të tyre sigurimin e një shërbimi kundrejt një komisioni fiks. Njësia ekonomike mund të zgjedhë të zbatojë SNRF 15 në vend të SNRF 17 për disa kontrata të që ajo lëshon, vetëm dhe vetëm, nëse plotësohen kushtet e cilësuara. Njësia ekonomike mund ta bëjë zgjedhjen veçmas për çdo kontratë, por zgjedhja për secilën kontratë është e pakthyeshme. Kushtet janë:

(a) njësia ekonomike nuk pasqyron një rrezik të lidhur me një klient të veçantë në vendosjen e çmimit të kontratës me atë klient;

(b) kontrata kompenson klientin duke i ofruar shërbimin, dhe jo duke i bërë atij pagesa në mjete monetare; dhe

(c) rreziku i sigurimit i transferuar me kontratë vjen kryesisht nga përdorimi i shërbimeve nga klienti sesa nga pasiguria mbi kostot e atyre shërbimeve.

8A Disa kontrata plotësojnë përkufizimin e një kontrate sigurimi por kufizojnë kompensimin për *ngjarjet e siguruara* në shumën që do të kërkohej sipas rastit për të shlyer detyrimin e policë mbajtësit të krijuar nga kontrata (për shembull, huatë me heqje dore në rast vdekje). Njësia ekonomike duhet të zgjedhë të zbatojë SNRF 17 ose SNRF 9 ndaj kontratave të tilla të cilat i emeton me përjashtim të rastit kur këto kontrata përjashtohen nga objekti i SNRF 17 nga paragrafi 7. Njësia ekonomike duhet të bëjë këtë zgjedhje për secilin *portofol kontratash sigurimi*, si dhe zgjedhja për secilin portofol është e pakthyeshme.

Kombinimi i kontratave të sigurimit

9 Një grup ose seri kontratash sigurimi me të njëjtën palë ose palë të lidhur mund të arrijë ose të projektohet për të arritur një efekt tregtar të përgjithshëm. Me qëllim që të raportohet thelbi i kontratave të tilla, mund të jetë e nevojshme që grupi apo seria e kontratave të trajtohen si një kontratë e vetme. Për shembull nëse të drejtat ose detyrimet në një kontratë nuk bëjnë gjë tjetër veçse mohojnë plotësisht të drejtat ose detyrimet në një kontratë tjetër të lidhur në të njëjtën kohë me të njëjtën palë, efekti i kombinuar është që nuk ekzistojnë të drejta apo detyrime.

Ndarja e përbërësve nga një kontratë sigurimi(paragrafët B31–B35)

10 Një kontratë sigurimi mund të përmbajë një ose më shumë përbërës të cilët mund të jenë brenda objektit të ndonjë Standardi tjetër nëse ato do të ishin kontrata të veçanta. Për shembull, një kontratë sigurimi mund të përfshijë një *përbërës investimi* ose një përbërës për shërbime të ndryshme nga *kontrata sigurim shërbimesh* (ose të dy). Njësia ekonomike do të zbatojë paragrafët 11–13 për të identifikuar dhe për të trajtuar përbërësit e kontratës.

 © Fondacioni i SNRF-ve

11 Njësia ekonomike do:

(a) të zbatojë SNRF 9 për të përcaktuar nëse ka një derivativ të përfshirë për t'u ndarë veçmas dhe nëse ka, për të përcaktuar sesi duhet të trajtohet ai derivativ.

(b) të veçojë nga kontrata e sigurimit mëmë (mbajtëse) një përbërës investimi nëse dhe vetëm nëse ai përbërës investimi është i dallueshëm (shih paragrafët B31–B32). Njësia ekonomike duhet të zbatojë SNRF 9 për trajtimin e përbërësit të veçuar të investimit përveç nëse është një kontratë investimi me tipare të pjesëmarrjes së lirë brenda objektit të SNRF 17 (shih paragrafin 3(c)).

12 Pas zbatimit të paragrafit 11 për të veçuar flukset e mjeteve monetare të lidhura me derivativët e përfshirë dhe përbërësit e investimit të dallueshëm, njësia ekonomike do të veçojë nga kontrata e sigurimit mëmë çdo premtim për të transferuar tek një policë mbajtës mallra të dallueshëm ose shërbime të ndryshme nga kontrata sigurim shërbimesh, duke zbatuar paragrafin 7 të SNRF 15. Njësia ekonomike do të trajtojë premtime të tilla duke zbatuar SNRF 15. Gjatë zbatimit të paragrafit 7 të SNRF 15 për të veçuar premtimin, njësia ekonomike do të zbatojë paragrafët B33–B35 e SNRF 17dhe në njohjen fillestare do të:

(a) zbatojë SNRF 15 për të përcaktuar hyrjet e mjeteve monetare mes përbërësit sigurues dhe çdo premtimi për të ofruar mallra të dallueshme ose shërbime të dallueshme të ndryshme nga kontrata për sigurim shërbimesh; dhe

(b) përcaktojë daljet e mjeteve monetare mes përbërësit sigurues dhe çdo malli ose shërbimi të premtuar të ndryshëm nga kontrata për sigurim shërbimesh, të trajtuar duke zbatuar SNRF 15 në mënyrë të tillë që:

(i) daljet e mjeteve monetare që lidhen drejtpërdrejt me secilin përbërës i caktohen atij përbërësi; dhe

(ii) ndonjë dalje e mjeteve monetare e mbetur shpërndahet mbi baza sistematike dhe racionale duke marrë parasysh daljet e mjeteve monetare që njësia ekonomike do të priste të ndodhnin nëse ai përbërës do të ishte një kontratë e veçantë.

13 Pas zbatimit të paragrafëve 11–12, njësia ekonomike do të zbatojë SNRF 17 tek të gjithë përbërësit e kontratës së sigurimit mëmë. Në vijim, të gjitha referencat në SNRF 17 për derivativët e përfshirë u referohen derivativëve që nuk janë veçuar nga kontrata e sigurimit mëmë dhe të gjitha referencat për përbërësit e investimit u referohen përbërësve të investimit që nuk janë veçuar nga kontrata e sigurimit mëmë (me përjashtim të referencave në paragrafët B31–B32).

Niveli i bashkimit në kontratat e sigurimit

14 Njësia ekonomike do të identifikojë portofolet e kontratave të sigurimit. Portofoli përfshin kontrata të cilat janë objekt i rreziqeve të ngjashme dhe që menaxhohen së bashku. Kontratat brenda së njëjtës linjë prodhimi pritet të kenë rreziqe të ngjashme, prandaj nëse menaxhohen së bashku, ato pritet të jenë në të njëjtin portofol. Kontratat në linja të ndryshme prodhimi (për shembull me prim të njëjtë vjetor të fiksuar krahasuar me një sigurim jete me kushte të rregullta) nuk pritet që të kenë rreziqe të ngjashme prandaj pritet që të jenë në portofole të ndryshme.

15 Paragrafët 16–24 zbatohen për kontratat e sigurimit të lëshuara. Kërkesat për nivelin e bashkimit të kontratave të risigurimit të mbajtura, paraqiten në paragrafin 61.

16 Njësia ekonomike do të ndajë një portofol të kontratave të sigurimit të lëshuara në një minimum të:

(a) një grupi kontratash të cilat janë me kushte rënduese në njohjen e tyre fillestare, nëse ka të tilla;

(b) një grupi kontratash, të cilat në njohjen fillestare nuk kanë shumë mundësi që më pas, të bëhen me kushte rënduese, kur ka të tilla; dhe

(c) një grupi kontratash të mbetura në portofol, nëse ka të tilla.

17 Nëse një njësi ekonomike ka informacion të arsyeshëm dhe mbështetës për të dalë në përfundimin se një grup kontratash do të jetë në të njëjtin grup në zbatim të paragrafit 16, ajo mund të masë grupin e kontratave për të përcaktuar nëse kontratat janë me kushte rënduese(shih paragrafin 47) dhe mund të vlerësojë grupin e kontratave për të përcaktuar nëse kontratat nuk kanë shumë mundësi për t'u bërë me kushte rënduese më pas (shih paragrafin 19). Nëse njësia ekonomike nuk ka informacion të arsyeshëm dhe mbështetës për të dalë në përfundimin se një grup kontratash do të jetë në të njëjtin grup, ajo do të përcaktojë grupin të cilit i përket secila kontratë, duke analizuar veçmas secilën kontratë.

18 Për kontratat e lëshuara, për të cilat njësia ekonomike zbaton metodën e shpërndarjes së primit (shih paragrafët 53–59), njësia ekonomike do të supozojë se asnjë kontratë në portofol nuk është me kushte

rënduese në njohjen fillestare, me përjashtim të rastit kur faktet dhe rrethanat sugjerojnë për të kundërtën. Njësia ekonomike do të vlerësojë nëse kontratat të cilat nuk janë me kushte rënduese në njohjen fillestare nuk kanë shumë mundësi për t'u bërë të tilla më pas duke vlerësuar mundësinë e ndryshimit të fakteve dhe rrethanave përkatëse.

19 Për kontratat e lëshuara dhe për të cilat njësia ekonomike nuk zbaton metodën e shpërndarjes së primit (shih paragrafët 53-54), njësia ekonomike do të vlerësojë nëse kontratat të cilat nuk janë me kushte rënduese në njohjen fillestare nuk kanë shumë mundësi të bëhen të tilla:

(a) bazuar në mundësinë e ndryshimeve në hipotezat të cilat nëse ndodhin, do të ndikonin që kontratat të bëheshin me kushte rënduese.

(b) duke përdorur informacionin rreth vlerësimeve të dhëna në raportimin e brendshëm të njësisë ekonomike. Kështu, që për vlerësimin nëse kontratat të cilat nuk janë me kushte rënduese në njohjen fillestare, nuk kanë shumë mundësi që të bëhen të tilla:

(i) njësia ekonomike nuk do të heqë dorë nga informacioni i dhënë nga raportimi i brendshëm i saj rreth efektit të ndryshimeve në supozimet mbi kontratat e ndryshme dhe mundësinë e tyre për t'u bërë me kushte rënduese; por

(ii) një njësie ekonomike nuk i kërkohet të mbledhë informacion shtesë përtej atij të siguruar nga raportimi i brendshëm rreth efektit të ndryshimeve në supozimet e kontratave të ndryshme.

20 Nëse gjatë zbatimit të paragrafëve14–19, kontratat brenda një portofoli do të shpërndaheshin në grupe të ndryshme vetëm sepse ligji apo ndonjë rregullim tjetër kushtëzon në mënyrë specifike mundësinë praktike të njësisë ekonomike për të vendosur një çmim tjetër ose një nivel tjetër të përfitimeve për policë mbajtësit me karakteristika të ndryshme, njësia ekonomike mund t'i përfshijë këto kontrata në të njëjtin grup. Njësia ekonomike nuk do të zbatojë këtë paragraf në analogji me zërat e tjerë.

21 Një njësi ekonomike lejohet të rindajë grupet e përshkruara në paragrafin 16. Për shembull, njësia ekonomike mund të zgjedhë të ndajë portofolet në:

(a) më shumë grupe të cilat nuk janë rënduese në njohjen fillestare—nëse raportimi i brendshëm i njësisë ekonomike ofron informacion i cili dallon:

(i) nivelet e ndryshme të përfitueshmërisë; ose

(ii) mundësitë e ndryshme që kontratat të bëhen me kushte rënduese pas njohjes fillestare; dhe

(b) më shumë se një grup të kontratave të cilat janë me kushte rënduese në njohjen fillestare—nëse raportimi i brendshëm i njësisë ekonomike ofron informacion në një nivel më të detajuar rreth shkallës në të cilën kontratat janë me kushte rënduese.

22 Njësia ekonomike nuk do të përfshijë në të njëjtin grup kontratat e lëshuara më shumë se një vit larg nga njëra tjetra. Për të arritur këtë njësia ekonomike do të ndajë më tej, nëse është e nevojshme, grupet e përshkruara në paragrafët 16–21.

23 Një *grup kontratash sigurimi* duhet të përfshijë një kontratë të vetme nëse kjo është rrjedhojë e zbatimit të paragrafëve 14–22.

24 Njësia ekonomike do të zbatojë kërkesat për njohjen dhe matjen të SNRF 17, për grupet e kontratave të përcaktuara duke zbatuar paragrafët 14–23. Njësia ekonomike duhet të krijojë grupet në njohjen fillestare dhe të shtojë kontrata në grupe duke zbatuar paragrafin 28. Njësia ekonomike nuk do të rivlerësojë më pas përbërjen e grupeve. Për të matur një grup kontratash, njësia ekonomike mund të vlerësojë *flukset e realizuara të mjeteve monetare* në një nivel më të lartë të bashkimit se grupi apo portofoli, me kushtin që njësia ekonomike të jetë në gjendje të përfshijë flukset e duhura të realizuara të mjeteve monetare duke zbatuar paragrafët 32(a), 40(a)(i) dhe 40(b), duke i shpërndarë këto vlerësime tek grupet e kontratave.

Njohja

25 Njësia ekonomike do të njohë një grup të kontratave të sigurimit që ajo lëshon nga periudha më e hershme e sa vijon:

(a) e fillimit të *periudhës së mbulimit* të grupit të kontratave;

(b) e datës kur pagesa e parë nga një policë mbajtës në grup bëhet e detyrueshme; dhe

(c) për një grup kontratash detyruese, kur grupi bëhet me kushte rënduese.

 © Fondacioni i SNRF-ve

26 Nëse nuk ka një datë të kontraktuar shlyerjeje, pagesa e parë nga policë mbajtësi konsiderohet e detyrueshme kur ajo merret. Një njësie ekonomike i kërkohet të përcaktojë nëse një kontratë bën pjesë në një grup kontratash me kushte rënduese, në zbatim të paragrafit 16, para datës më të hershme të datës së paraqitur në paragrafët 25(a) dhe 25(b) nëse faktet dhe rrethanat sugjerojnë se ka një grup të tillë.

27 [Fshirë]

28 Gjatë njohjes së një grupi kontratash sigurimi në periudhën e raportimit, njësia ekonomike do të përfshijë vetëm kontratat që plotësojnë individualisht një nga kriteret e përcaktuara në paragrafin 25 dhe duhet të vlerësojë normat e skontimit në datën e njohjes fillestare (shih paragrafin B73) dhe njësitë e mbulimit të siguruara në periudhën e raportimit (shih paragrafin B119). Njësia ekonomike mund të lëshojë më shumë kontrata në grup pas fundit të periudhës së raportimit, objekt i paragrafit 14–22. Njësia ekonomike mund të shtojë një kontratë në grup në periudhën e raportimit në të cilën kontrata plotëson një nga kriteret e paraqitura në paragrafin 25. Kjo mund të sjellë një ndryshim në përcaktimin e normave të skontimit në datën e njohjes fillestare gjatë zbatimit të paragrafit B73. Njësia ekonomike do të zbatojë normat e rishikuara nga data e fillimit të periudhës së raportimit në të cilën kontratat e reja janë shtuar në grup.

Flukset e mjeteve monetare të blerjes së sigurimit (shih paragrafin B35A-B35D)

28A Njësia ekonomike duhet të shpërndajë *flukset monetare të blerjes së sigurimit* tek grupet e kontratave të sigurimit duke përdorur një metodë sistematike dhe racionale në zbatim të paragrafëve B35A–B35B, me përjashtim të rastit kur ajo zgjedh t'i njohë ato si shpenzime në zbatim të paragrafit 59(a).

28B Një njësi ekonomike që nuk zbaton paragrafin 59(a) duhet të njohë flukset monetare të blerjes së sigurimit të paguara si një aktiv (ose flukset monetare të blerjes së sigurimit për të cilin është njohur një detyrim në zbatim të një SNRF tjetër) para se të njihet grupi përkatës i kontratave të sigurimit. Njësia ekonomike duhet të njohë një aktiv të tillë për secilin nga grupet përkatëse të kontratave të sigurimit.

28C Njësia ekonomike duhet të çregjistrojë aktivin për flukset monetare të blerjes së sigurimit nëse këto flukse janë përfshirë në matjen e grupit përkatës të kontratave të sigurimit në zbatim të paragrafit 38(c)(i) ose paragrafit 55(a)(iii).

28D Nëse zbatohet paragrafi 28, njësia ekonomike duhet të zbatojë paragrafët 28B–28C në përputhje me paragrafët B35C.

28E Në fund të çdo periudhe raportimi, njësia ekonomike duhet të vlerësojë rikuperimin e një aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit nëse faktet dhe rrethanat tregojnë se aktivi mund të jetë zhvlerësuar (shih paragrafin B35D). Nëse njësia ekonomike identifikon një humbje nga zhvlerësimi, ajo duhet të rregullojë vlerën kontabël (neto) të aktivit dhe të njohë në rezultatin e periudhës humbjen nga zhvlerësimi.

28F Njësia ekonomike do të njohë në fitim ose humbje (rezultatin e periudhës) anullimin e një pjese ose të të gjithë humbjes nga zhvlerësimi të njohur më parë në përputhje me paragrafin 28E dhe një rritje në vlerën kontabël (neto) të aktivit në masën që kushtet për zhvlerësim nuk ekzistojnë më ose janë përmirësuar.

Matja (paragrafët B36–B119F)

29 Njësia ekonomike do të zbatojë paragrafët 30–52 tek të gjitha grupet e kontratave të sigurimit që janë brenda objektit të SNRF 17, me përjashtimet në vijim:

(a) për grupet e kontratave të sigurimit që plotësojnë kriterin e cilësuar në paragrafin 53, njësia ekonomike mund të thjeshtojë matjen e grupit duke përdorur metodën e shpërndarjes së primit në paragrafët 55–59.

(b) për grupet e kontratave të risigurimit të mbajtura,njësia ekonomike do të zbatojë paragrafët 32–46 siç kërkohet në paragrafët 63–70A. Paragrafët 45 (për *kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë*) dhe 47–52 (për kontratat me kushte rënduese) nuk zbatohen për grupet e kontratave të risigurimit të mbajtura.

(c) për grupet e kontratave të investimit me tipare të pjesëmarrjes së lirë, njësia ekonomike do të zbatojë paragrafët 32–52 sipas modifikimit nga paragrafi 71.

30 Kur zbaton SNK 21 *Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit* tek një grup kontratash sigurimi që gjenerojnë flukse të mjeteve monetare në një monedhë të huaj, njësia ekonomike do ta trajtojë grupin e kontratave, përfshirë *marzhin kontraktual të shërbimit*, si një zë monetar.

31 Në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike që ka emetuar kontratat e sigurimit, flukset e realizuara të mjeteve monetare nuk do të reflektojë rrezikun në lidhje me mos-performancën e asaj njësie ekonomike (rreziku në lidhje me mosrealizimin e performancës përkufizohet në SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*).

Matja në njohjen fillestare (paragrafët B36–B95F)

32 Gjatë njohjes fillestare, njësia ekonomike do ta masë një grup kontratash financiare me totalin e:

(a) fluksit të realizuar të mjeteve monetare, që përfshin:

(i) vlerësimet e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare (paragrafët 33–35);

(ii) një rregullim që reflekton vlerën në kohë të parasë dhe *rreziqet financiare* të lidhura me flukse mjetesh monetare të ardhshme, në masën që rreziqet financiare nuk janë përfshirë në vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme (paragrafi 36); dhe

(iii) një *rregullim për rrezikun jo-financiar* (paragrafi 37).

(b) marzhin e kontraktuar të shërbimit, të matur sipas kërkesave të paragrafëve 38–39.

Vlerësimet e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare B36–B71)

33 Njësia ekonomike do të përfshijë në matjen e njëgrupi kontratash sigurimi të gjitha flukset e ardhshme të mjeteve monetare brenda kufijve të secilës kontratë në grup (shih paragrafin 34). Duke zbatuar paragrafin 24, njësia ekonomike mund të vlerësojë flukset e ardhshme të mjeteve monetare në një nivel më të lartë grupimi dhe më pas të shpërndajë fluksin e realizuar të mjeteve monetare që rezulton tek grupet individuale të kontratave. Vlerësimet e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare do të:

(a) përfshijnë, në një mënyrë të paanshme, të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe mbështetës në dispozicion pa kosto apo përpjekje të panevojshme rreth madhësisë, kohës dhe pasigurisë të këtyre flukseve monetare të ardhshme (shih paragrafët B37–B41). Për të realizuar këtë njësia ekonomike do të vlerësojë vlerën e pritur (d.m.th mesataren e ponderuar të mundshme) të gamës së plotë të rezultateve të mundshme.

(b) reflektojnë perspektivën e njësisë ekonomike, me kusht që vlerësimet e variablave përkatës të tregut të jenë në përputhje me çmimet e vrojtueshme në treg për këto variabla (shih paragrafët B42–B53).

(c) jenë aktualë—vlerësimet do të pasqyrojnë kushtet ekzistuese në datën e matjes, përfshirë supozimet në atë datë lidhur me të ardhmen (shih paragrafët B54–B60).

(d) jenë të qarta—njësia ekonomike do të vlerësojë rregullimin për rrezikun jo-financiar veçmas nga vlerësimet e tjera (shih paragrafin B90). Gjithashtu njësia ekonomike duhet të vlerësojë flukset monetare veçmas nga rregullimi për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun financiar, me përjashtim të rastit kur një teknike matjeje më e përshtatshme i kombinon këto vlerësime (shih paragrafin B46).

34 Flukset e mjeteve monetare janë brenda kufijve të një kontrate sigurimi nëse ato vijnë nga të drejta dhe detyrime thelbësore të cilat ekzistojnë gjatë periudhës së raportimit, në të cilën njësia ekonomike mund të detyrojë policë mbajtësin të paguajë primet ose në të cilën njësia ekonomike ka një detyrim themelor për t'i ofruar policë mbajtësit kontratë sigurim shërbimesh (shih paragrafët B61–B71). Një detyrim thelbësor për të ofruar kontratë sigurim shërbimesh përfundon kur:

(a) njësia ekonomike ka aftësitë praktike për të rivlerësuar rreziqet e një policë mbajtësi të caktuar dhe si pasojë mund të vendosë një çmim ose nivel përfitimesh që reflekton plotësisht këto rreziqe; ose

(b) plotësohen të dyja kushtet vijuese:

(i) njësia ekonomike ka aftësitë praktike për të rivlerësuar rreziqet e një portofoli kontratash sigurimi që përmbajnë kontratën dhe si pasojë mund të vendosë një çmim ose nivel përfitimesh që reflekton plotësisht rrezikun e atij portofoli; dhe

(ii) vendosja e çmimit për primet deri në datën kur rreziqet rivlerësohen nuk merr në konsideratë rreziqet që lidhen me periudhat pas datës së rivlerësimit.

35 Njësia ekonomike nuk do të njohë si një detyrim ose si një aktiv shumat që lidhen me primet e pritshme ose kërkesat shtesë të pritshme jashtë kufijve të kontratës së sigurimit. Këto shuma lidhen me kontrata sigurimi të ardhshme.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Normat e skontimit (paragrafët B72–B85)

36 **Njësia ekonomike do të rregullojë vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme për të pasqyruar vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet financiare të lidhura me këto flukse mjetesh monetare, në masën që rreziqet financiare nuk janë përfshirë në vlerësimet e flukseve monetare. Normat e skontimit të përdorura për të vlerësuar flukset monetare të ardhshme të përshkruara në paragrafin 33 do të:**

(a) pasqyrojnë vlerën në kohë të parasë, karakteristikat e flukseve monetare dhe karakteristikat e likuiditetit të kontratave të sigurimit;

(b) jenë në përputhje me çmimet aktuale në tregjet e mbikëqyrura (nëse ka) për instrumenta financiarë me flukse monetare, karakteristikat e të cilëve janë në përputhje me ato të kontratave të sigurimit, përsa i takon për shembull kohës, monedhës dhe likuiditetit; dhe

(c) përjashtojnë efektet e faktorëve që influencojnë këto çmime në tregje të mbikëqyrura por nuk ndikojnë flukset e ardhshme monetare të kontratave të sigurimit.

Rregullimi i rrezikut për pjesën e rrezikut jo-financiar (paragrafët B86–B92)

37 **Njësia ekonomike do të rregullojë vlerësimin e vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme për të pasqyruar kompensimin që njësia kërkon për mbajtjen e pasigurisë rreth shumës dhe kohës së ndodhjes së flukseve monetare që vijnë nga rreziku jo-financiar.**

Marzhi i kontraktuar i shërbimit

38 **Marzhi i kontraktuar i shërbimit është një përbërës i aktivit ose detyrimit për grupin e kontratave të sigurimit dhe paraqet fitimin e parealizuar që njësia ekonomike do të njohë në të ardhmen kur të kryejë shërbimet e kontratës së sigurimit. Njësia ekonomike do të masë marzhin e kontraktuar të shërbimit në njohjen fillestare të një grupi kontratash sigurimi me një shumë e cila, me përjashtim të rastit kur zbatohet paragrafi 47 (për kontratat me kushte rënduese) ose paragrafi B123A (mbi të ardhurat e sigurimit të lidhura me paragrafin 38(c)(ii), nuk sjell të ardhura apo shpenzime që vijnë nga:**

(a) njohja fillestare e një shume për flukset monetare të realizuara, të matur sipas kërkesave të paragrafëve 32–37;

(b) çdo fluksi të mjeteve monetare të ardhur nga kontratat në grup në atë datë;

(c) mosnjohje (çregjistrim) në datën e njohjes fillestare të:

(i) çdo aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit duke zbatuar paragrafin 28C; dhe

(ii) çdo aktivi ose detyrimi tjetër të njohur më parë në flukset monetare të grupit të kontratave siç specifikohet në paragrafin B66A.

39 Për kontratat e sigurimit të blera në një transferim kontratash sigurimi ose në një kombinim biznesi brenda objektit të SNRF 3, njësia ekonomike duhet të zbatojë kërkesat e paragrafit 38 në përputhje me paragrafët B93–B95F.

Matja e mëpasshme

40 **Vlera kontabël (neto) e një grupi kontratash sigurimi në fund të çdo periudhe raportimi do të jetë shuma:**

(a) e *detyrimit për mbulimin e mbetur* duke përfshirë:

(i) flukset monetare të realizuara, të lidhura me shërbimin e ardhshëm të shpërndarë tek grupi në atë datë, të matur duke zbatuar paragrafët 33–37dhe B36–B92;

(ii) marzhin e kontraktuar të shërbimit të grupit në atë datë, të matur duke zbatuar paragrafët 43–46; dhe

(b) e *detyrimit për kërkesën shtesë të pësuar*, duke përfshirë flukset monetare të realizuara, të lidhura me shërbimin e kryer tashmë dhe të shpërndarë tek grupi në atë datë, të matur duke zbatuar paragrafët 33–37 dhe B36–B92.

41 **Një njësi ekonomike do të njohë të ardhura dhe shpenzime për ndryshimet në vijim në vlerën kontabël (neto) të detyrimit për mbulimin e mbetur:**

(a) të ardhura sigurimi—për pakësimin në detyrimin për mbulimin e mbetur për shkak të shërbimit të kryer gjatë periudhës, të matur duke zbatuarparagrafët B120–B124;

(b) shpenzime të shërbimit të sigurimit—për humbjen në grupet e kontratave me kushte rënduese dhe kthimet (rimarrjet) nga humbje të tilla (shih paragrafët 47–52); dhe

(c) të ardhura ose shpenzime financiare nga sigurimi—për efektin e vlerës në kohë të parasë dhe efektin e rrezikut financiar siç cilësohet në paragrafin 87.

42 Njësia ekonomike do të njohë të ardhura dhe shpenzime për ndryshimet në vijim në vlerën kontabël (neto) të detyrimit për kërkesat shtesë të pësuara:

(a) shpenzime të shërbimit të sigurimit—për rritjen në detyrim për shkak të kërkesave shtesë dhe shpenzimeve të ndodhura gjatë periudhës, me përjashtim të përbërësve investime;

(b) shpenzime të shërbimit të sigurimit—për të gjitha ndryshimet e mëpasshme të flukseve monetare të realizuara,që lidhen me kërkesat shtesë dhe shpenzimet e ndodhura; dhe

(c) të ardhura ose shpenzime financiare nga sigurimi—për efektin e vlerës në kohë të parasë dhe efektin e rrezikut financiar siç cilësohet në paragrafin 87.

Marzhi i shërbimit kontraktual (paragrafët B96—B119B)

43 Marzhi i kontraktuar i shërbimit në fund të periudhës raportuese paraqet fitimin nga grupi i kontratave të sigurimitqë nuk është njohur ende në fitim apo humbje për shkak se lidhet me shërbimin e ardhshëm që do të kryhet sipas kontratave në grup.

44 Për *kontratat e shërbimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë*, vlera kontabël (neto)e marzhit të shërbimit kontraktual të një grupi kontratash, në fund të periudhës raportuese është sa vlera kontabël (neto) në fillim të periudhës raportuese e korrigjuar me:

(a) efektin e çdo kontrate të re të shtuar në grup (shih paragrafin 28);

(b) interesin e maturuar mbi vlerën kontabël (neto) të marzhit të kontraktuar të shërbimit gjatë periudhës raportuese, të matur sipas normave të skontimit të cilësuara në paragrafin B72(b);

(c) ndryshimet në flukset monetare të realizuara, të lidhur me shërbimin e ardhshëm siç specifikohet në paragrafët B96–B100, me përjashtim të madhësisë që:

(i) rritje të tilla në flukset monetare të realizuara tejkalojnë vlerën kontabël (neto) të marzhit të kontraktuar të shërbimit, duke sjellë si pasojë një humbje (shih paragrafin 48(a)); ose

(ii) këto rënie në flukset monetare të realizuara janë shpërndarë tek përbërësi humbje i detyrimit për mbulimin e mbetur sipas kërkesave të paragrafit 50(b).

(d) efektin e çdo diference nga këmbimi i monedhave në marzhin e kontraktuar të shërbimit; dhe

(e) shumën e njohur si e ardhur nga sigurimi për shkak të transferimit të shërbimeve të kontratës së sigurimit gjatë periudhës, e përcaktuar nga shpërndarja e marzhit të kontraktuar të shërbimit të mbetur në fund të periudhës së raportimit (para çdo shpërndarjeje) gjatë periudhës aktuale dhe të mbetur të mbulimit, duke zbatuar paragrafin B119.

45 Për kontratat e sigurimit me një tipar të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë(shih paragrafët B101–B118), vlera kontabël (neto) e marzhit të kontraktuar të shërbimit të një grupi kontratash, në fund të periudhës raportuese është sa vlera kontabël (neto) në fillim të periudhës raportuese e korrigjuar për shumat e cilësuara në nënparagrafët (a)–(e) më poshtë. Njësisë ekonomike nuk i kërkohet që të identifikojë veçmas këto korrigjime. Por një shumë e vetme mund të përcaktohet për disa apo të gjitha korrigjimet. Korrigjimet janë:

(a) efektin e çdo kontrate të re të shtuar në grup (shih paragrafin 28);

(b) ndryshimi në shumën e pjesës së njësisë ekonomike në vlerën e drejtë të *zërave bazë* (*të nënkuptuar*) (shih paragrafin B104(b)(i)), me përjashtim të madhësisë për të cilën:

(i) zbatohet paragrafi B115(mbi zbutjen e rrezikut);

(ii) pakësimi në shumën e pjesës së njësisë ekonomike në vlerën e drejtë të zërave bazë, tejkalon vlerën kontabël (neto) të marzhit të kontraktuar të shërbimit, duke sjellë si pasojë një humbje (shih paragrafin 48); ose

(iii) rritja në shumën e pjesës së njësisë ekonomike në vlerën e drejtë të zërave bazë, anulon shumën në pikën (ii).

(c) ndryshimet në flukset monetare të realizuara të lidhura me shërbimin e ardhshëm siç specifikohet në paragrafët B101–B118, me përjashtim të madhësisë për të cilën:

 © Fondacioni i SNRF-ve

(i) zbatohet paragrafi B115(mbi zbutjen e rrezikut);

(ii) rritje të tilla në flukset monetare të realizuara tejkalojnë vlerën kontabël (neto) të marzhit të kontraktuar të shërbimit, duke sjellë si pasojë një humbje (shih paragrafin 48); ose

(iii) këto rënie në flukset monetare të realizuara janë shpërndarë tek përbërësi humbje i detyrimit për mbulimin e mbetur sipas kërkesave të paragrafit 50(b).

(d) efektin e çdo diference nga këmbimi i monedhave në marzhin e kontraktuar të shërbimit; dhe

(e) shuma e njohur si e ardhur nga sigurimi për shkak të transferimit të shërbimeve të kontratës së sigurimit gjatë periudhës, e përcaktuar nga shpërndarja e marzhit të kontraktuar të shërbimit të mbetur në fund të periudhës së raportimit (para çdo shpërndarjeje) gjatë periudhës aktuale dhe të mbetur të mbulimit, duke zbatuar paragrafin B119.

46 Disa ndryshime në marzhin e kontraktuar të shërbimit kompensojnë ndryshimet në flukset monetare të realizuara për detyrimin për mbulimin e mbetur, duke mos sjellë ndryshime në totalin e vlerës kontabël (neto) të detyrimit për mbulimin e mbetur. Për pjesën që këto ndryshime në marzhin e kontraktuar të shërbimit nuk kompensojnë ndryshimet në flukset monetare të realizuara për detyrimin për mbulimin e mbetur, njësia ekonomike do të njohë të ardhura dhe shpenzime për këto ndryshime, duke zbatuar paragrafin 41.

Kontratat me kushte rënduese

47 Një kontratë sigurimi është me kushte rënduese në datën e njohjes fillestare nëse flukset monetare të realizuara që i takojnë kontratës, ndonjë fluks monetar i blerjes së sigurimit i njohur më parë dhe ndonjë fluks monetar që vjen nga kontrata në datën e njohjes fillestare në total janë flukse dalëse neto. Në zbatim të paragrafit 16(a), njësia ekonomike do të grupojë kontrata të tilla veçmas nga kontratat që nuk janë me kushte rënduese. Deri në masën që zbatohet paragrafi 17, njësia ekonomike mund të identifikojë grupin e kontratave me kushte rënduese duke matur një grup kontratash në vend të matjes së kontratave individuale. Njësia ekonomike do të njohë një humbje në fitim ose humbje për fluksin neto dalës të grupit të kontratave me kushte detyruese, për të cilat rezulton se vlera kontabël (neto) e detyrimit për grupin, të jetë sa flukset monetare të realizuara dhe marzhi i shërbimit i kontraktuar për grupin të jetë zero.

48 Një grup kontratash sigurimi bëhet me kushte rënduese (ose më detyruese) në matjen e mëpasshme, nëse shumat në vijim tejkalojnë vlerën kontabël (neto) të marzhit të shërbimit të kontraktuar:

(a) për ndryshime jo të favorshme në flukset monetare të realizuara të shpërndara tek grupi lidhur me shërbimin e ardhshëm, që vijnë nga ndryshimet në flukset monetare të ardhshme dhe rregullimi i rrezikut për rrezikun jo-financiar; dhe

(b) për një grup kontratash sigurimi me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, pakësimi në madhësinë e pjesës së njësisë ekonomike në vlerën e drejtë të zërave bazë.

Duke zbatuar paragrafët 44(c)(i), 45(b)(ii) dhe 45(c)(ii), njësia ekonomike do të njohë një humbje në rezultat në masën e atij tejkalimi.

49 Njësia ekonomike do të krijojë (ose rrisë) një përbërës humbje në detyrimin për mbulimin e mbetur për një grup me kushte detyruese duke përcaktuar humbjet e njohura në zbatim të paragrafëve 47–48. Përbërësi humbje përcakton shumat që janë paraqitur në rezultat si rimarrje të humbjeve nga grupi me kushte detyruese dhe që përjashtohen më pas nga përcaktimi i të ardhurës nga sigurimi.

50 Pasi njësia ekonomike ka njohur një humbje nga një grup i kontratave të sigurimit me kushte rënduese, ajo do të shpërndajë:

(a) ndryshimet e mëpasshme në flukset monetare të realizuara të detyrimit për mbulimin e mbetur të cilësuar në paragrafin 51 mbi baza sistematike mes:

(i) përbërësit humbje të detyrimit për mbulimin e mbetur; dhe

(ii) detyrimit për mbulimin e mbetur, duke përjashtuar përbërësin humbje.

(b) vetëm tek përbërësi humbje derisa ai përbërës të pakësohet në zero:

(i) çdo pakësim të mëpasshëm në flukset monetare të realizuara të shpërndara tek grupi lidhur me shërbimin e ardhshëm, që vjen nga ndryshimet në vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme dhe rregullimi i rrezikut për rrezikun jo-financiar; dhe

(ii) çdo rritje të mëpasshme në madhësinë e pjesës së njësisë ekonomike të vlerës së drejtë të zërave bazë.

Duke zbatuar paragrafët 44(c)(ii), 45(b)(iii) dhe 45(c)(iii), njësia ekonomike do të korrigjojë marzhin e kontraktuar të shërbimit vetëm për tejkalimin e rënies ndaj shumës së shpërndarë tek përbërësi humbje.

51 Ndryshimet e mëpasshme në flukset monetare të realizuara të detyrimit për mbulimin e mbetur për t'u shpërndarë në zbatim të paragrafit 50(a) janë:

(a) vlerësimet e vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme për kërkesat shtesë dhe shpenzimet e krijuara nga detyrimi për mbulimin e mbetur për shkak të ndodhjes së shpenzimeve të shërbimit të sigurimit;

(b) ndryshimet në korrigjimin për rrezikun jo-financiar të njohur në rezultat për shkak të lirimit nga rreziku; dhe

(c) të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit.

52 Shpërndarja sistematike e kërkuar nga paragrafi 50(a) do të sjellë që shumat totale të shpërndara në përbërësin humbje në përputhje me paragrafët 48–50 të bëhen zero në fund të periudhës së mbulimit të një grupi kontratash.

Metoda e shpërndarjes së primit

53 Njësia ekonomike mund të thjeshtojë matjen e një grupi kontratash sigurimi duke përdorur metodën e shpërndarjes së primit të paraqitur në paragrafët 55–59 nëse dhe vetëm nëse kur krijohet grupi:

(a) njësia ekonomike pret në mënyrë të arsyeshme që ky thjeshtëzim do të sjellë matjen e një detyrimi për pjesën e mbetur të mbulimit për grupin, i cili nuk do të ndryshojë shumë (ndryshim jo material) nga ai që do të rezultonte duke zbatuar kërkesat e paragrafëve 32–52; ose

(b) periudha e mbulimit e secilës kontratë në grup (përfshirë kontratën e sigurimit për shërbimin që vjen nga të gjitha primet brenda kufijve të kontratës të përcaktuar në datën e zbatimit të paragrafit 34) është një vit ose më pak.

54 Kriteri në paragrafin 53(a) nuk plotësohet nëse në datën e krijimit të grupit, njësia ekonomike pret të ketë ndryshime të rëndësishme në flukset e mjeteve monetare të realizuara të cilat do të ndikonin matjen e një detyrimi për mbulimin e mbetur gjatë periudhës para se të ndeshet kërkesa shtesë. Ndryshimi në flukset e mjeteve monetare të realizuara rritet për shembull:

(a) me madhësinë e flukseve të mjeteve monetare të ardhshme për çdo derivativ të përfshirë në kontratat; dhe

(b) me gjatësinë e periudhës së mbulimit të grupit të kontratave.

55 Kur përdor metodën e shpërndarjes së primit, njësia ekonomike do ta masë detyrimin për mbulimin e mbetur si vijon:

(a) në njohjen fillestare, vlera kontabël (neto) e detyrimit është:

(i) primi i marrë (nëse ka) në njohjen fillestare;

(ii) pakësuar për çdo fluks mjetesh monetare të blerjes së sigurimit në atë datë me përjashtim të rastit kur njësia ekonomike zgjedh të njohë pagesat si një shpenzim në zbatim të paragrafit 59(a); dhe

(iii) plus ose minus çdo shumë që vjen nga mosnjohja (çregjistrimi) në atë datë të:

1. çdo aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit duke zbatuar paragrafin 28C; dhe

2. çdo aktivi ose detyrimi tjetër të njohur më parë në flukset monetare të grupit të kontratave siç specifikohet në paragrafin B66A.

(b) në fund të çdo periudhe pasuese raportimi, vlera kontabël (neto) e detyrimit është vlera kontabël (neto) në fillim të periudhës së raportimit:

(i) plus primet e marra gjatë periudhës;

(ii) minus flukset e mjeteve monetare të blerjes së sigurimit; me përjashtim të rastit kur njësia ekonomike zgjedh të njohë pagesat si një shpenzim në zbatim të paragrafit 59(a);

(iii) plus çdo shumë të lidhur me amortizimin e flukseve të mjeteve monetare të blerjes së sigurimit të njohura si një shpenzim në periudhën raportuese; me përjashtim të rastit kur njësia ekonomike zgjedh të njohë flukset e mjeteve monetare të blerjes së sigurimit si një shpenzim në zbatim të paragrafit 59(a);

 © Fondacioni i SNRF-ve

(iv) plus çdo rregullim tek një përbërës financiar në zbatim të paragrafit 56;

(v) minus shumën e njohur si të ardhur nga sigurimi për shërbimet e dhëna në atë periudhë (shih paragrafin B126); dhe

(vi) minus çdo përbërës investim të paguar ose të transferuar tek detyrimi për kërkesat shtesë të pësuara.

56 Nëse kontratat e sigurimit në një grup kanë një përbërës të rëndësishëm financiar, njësia ekonomike do të rregullojë vlerën kontabël (neto) të detyrimit për mbulimin e mbetur për të reflektuar vlerën në kohë të parasë dhe efektin e rrezikut financiar duke përdorur normën e skontimit të specifikuar në paragrafin 36, siç kërkohet në njohjen fillestare. Nëse njësia ekonomike në datën e njohjes fillestare pret që koha ndërmjet datës së ofrimit të secilës pjesë të shërbimit dhe datës së primit korrespondues të jetë jo më shumë se një vit, ajo nuk ka nevojë që të rregullojë vlerën kontabël (neto) të detyrimit për mbulimin e mbetur për të reflektuar vlerën në kohë të parasë dhe efektin e rrezikut financiar.

57 Nëse në ndonjë moment gjatë periudhës së mbulimit, fakte dhe rrethana tregojnë se një grup kontratash sigurimi është detyrues, njësia ekonomike do të llogarisë diferencën mes:

(a) vlerës kontabël (neto) të detyrimit për mbulimin e mbetur të përcaktuar në zbatim të paragrafit 55; dhe

(b) flukseve të mjeteve monetare të realizuara që lidhen me mbulimin e mbetur të grupit, duke zbatuar paragrafët 33–37 dhe B36–B92. Megjithatë, nëse gjatë zbatimit të paragrafit 59(b), njësia ekonomike nuk rregullon detyrimin për kërkesat shtesë të pësuara për vlerën në kohë të parasë dhe efektin e rrezikut financiar, ajo nuk do të përfshijë në flukset e mjeteve monetare të realizuara, një rregullim të tillë.

58 Njësia ekonomike do të njohë një humbje në rezultatin e periudhës dhe një rritje në detyrimin për mbulimin e mbetur në madhësinë që flukset e mjeteve monetare të realizuara të përshkruara në paragrafin 57(b) tejkalojnë vlerën kontabël (neto) të përshkruar në paragrafin 57(a).

59 Gjatë zbatimit të metodës së shpërndarjes së primit, njësia ekonomike:

(a) mund të zgjedhë të njohë çdo fluks mjetesh monetare përmbushëse si shpenzim kur përballet me këto kosto, me kushtin që periudha e mbulimit e secilës kontratë në grup në njohjen fillestare të mos jetë më shumë se një vit.

(b) do të masë detyrimin për kërkesat shtesë të pësuara për grupin e kontratave të sigurimit me flukset e mjeteve monetare të realizuara,që lidhen me kërkesat shtesë të pësuara, duke zbatuar paragrafët 33–37 dhe B36–B92. Megjithatë, nëse flukset e ardhshme të mjeteve monetare pritet të paguhen ose merren brenda vitit nga data e pësimit të kërkesave shtesë njësia ekonomike nuk ka nevojë t'i rregulloje këto flukse për vlerën në kohë të parasë dhe efektin e rrezikut financiar.

Kontratat e risigurimit të mbajtura

60 Kërkesat në SNRF 17 modifikohen për kontratat e risigurimit të mbajtura, siç paraqiten në paragrafët 61–70A.

61 Njësia ekonomike do të ndajë portofolet e kontratave të risigurimit të mbajtura duke zbatuar paragrafët 14–24, me përjashtimin të referencave ndaj kontratave me kushte rënduese të cilat në këto paragrafë do të zëvendësohen me referencën për kontrata për të cilat ka një fitim neto në njohjen fillestare. Për disa kontrata risigurimi të mbajtura, zbatimi i paragrafëve 14–24 do të rezultojë në një grup që përmban vetëm një kontratë.

Njohja

62 Në vend të zbatimit të paragrafit 25, njësia ekonomike do të njohë një grup kontratash risigurimi të mbajtura nga më herët se sa:

(a) fillimi i periudhës së mbulimit të grupit të kontratave të risigurimit të mbajtura; dhe

(b) data që njësia ekonomike njeh një grup të kontratave të sigurimit bazë me kushte rënduese duke zbatuar paragrafin 25(c), nëse njësia ekonomike ka hyrë në kontratën përkatëse të risigurimit të mbajtur në grupin e kontratave të risigurimit të mbajtur në atë datë ose më parë.

62A Pavarësisht paragrafit 62(a), njësia ekonomike do ta vonojë njohjen e një grupi kontratash risigurimi të mbajtuara, që sjellin mbulim proporcional deri në datën që çdo kontratë bazë risigurimi është fillimisht njohur, nëse ajo datë është më vonë se fillimi i periudhës së mbulimit të grupit të kontratave të risigurimit të mbajtura.

Matja

63 Gjatë zbatimit të kërkesave të paragrafëve 32–36 për matjen e kontratave të risigurimit të mbajtura, në madhësinë që kontratat e përfshira gjithashtu maten sipas kërkesave të këtyre paragrafëve, njësia ekonomike do të përdorë supozime të qëndrueshme për vlerësimin e vlerës aktuale të flukseve të mjeteve monetare të ardhshme për grupin e kontratave të risigurimit të mbajtura dhe vlerësimin e vlerës aktuale të flukseve të mjeteve monetare të ardhshme për grupin (grupet) e kontratave të sigurimit të përfshira. Gjithashtu, njësia ekonomike do të përfshijë në vlerësimet e vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të mjeteve monetare për grupin e kontratave të risigurimit të mbajtura efektin e çdo rreziku nga mos performanca e emetuesit të kontratës së risigurimit, duke përfshirë efektet e garancisë dhe humbjeve nga mosmarrëveshjet.

64 Në vend të zbatimit të paragrafit 37, njësia ekonomike do të përcaktojë rregullimin për rrezikun jo-financiar në mënyrë që ai të paraqesë shumën e rrezikut që transferohet nga mbajtësi i grupit të kontratave të risigurimit tek emetuesi i këtyre kontratave.

65 Kërkesat e paragrafit e 38 që lidhen me përcaktimin e marzhit të kontraktuar të shërbimit në njohjen fillestare modifikohen për të pasqyruar faktin se për një grup të kontratave të risigurimit të mbajtura nuk ka fitim të pa përfituar por në fakt një kosto ose fitim neto nga blerja e risigurimit. Kështu, me përjashtim të rastit kur zbatohet paragrafi 65A, në njohjen fillestare njësia ekonomike do të njohë çdo kosto ose fitim neto nga blerja e grupit të kontratave të risigurimit të mbajtura si një marzh të kontraktuar shërbimi të matura me një shumë të barabartë me shumën e:

(a) flukset monetare të realizuara;

(b) shumën e çregjistruar në atë datë të ndonjë aktivi ose detyrimi të njohur më parë për flukset monetare të lidhura me grupin e kontratave të risigurimit të mbajtura;

(c) çdo fluks monetar që vjen në atë datë; dhe

(d) çdo të ardhur të njohur në fitim ose humbje duke zbatuar paragrafin 66A.

65A Nëse kostoja neto e blerjes së mbulimit të risigurimit lidhet me ngjarje të cilat kanë ndodhur para blerjes së grupit të kontratave të risigurimit të mbajtura, pavarësisht kërkesave të paragrafit B5, njësia ekonomike do të njohë kosto të tilla menjëherë si shpenzime në rezultatin e periudhës (fitim ose humbje).

66 Në vend të zbatimit të paragrafit 44, njësia ekonomike do të masë marzhin e shërbimit të kontraktuar në fund të periudhës raportuese për grupin e kontratave të risigurimit të mbajtura si vlera kontabël (neto) në fillim të periudhës raportuese e rregulluar për:

(a) efektin e çdo kontrate të re të shtuar në grup (shih paragrafin 28);

(b) interesin e maturuar mbi vlerën kontabël (neto) të marzhit të kontraktuar të shërbimit, të matur sipas normave të skontimit të cilësuara në paragrafin B72(b);

(ba) të ardhurën e njohur në fitimin ose humbjen e periudhës raportuese duke zbatuar paragrafin 66A;

(bb) anulimin e një përbërësi rikuperim humbjeje të njohur duke zbatuar paragrafin 66B (shih paragrafin B119F) në masën që këto anulime nuk ndryshojnë flukset monetare të realizuara të grupit të kontratave të risigurimit të mbajtura;

(c) ndryshimet në flukset monetare të realizuara, të matura me normat e skontimit të specifikuara në paragrafin B72(c), në masën që ndryshimi lidhet me shërbimin e ardhshëm, me përjashtim të rastit kur:

(i) ndryshimi vjen nga një ndryshim në flukset e mjeteve monetare të realizuara, të shpërndara tek një grup kontratash sigurimi të përfshira, të cilat nuk rregullojnë marzhin e kontraktuar të shërbimit për grupin e kontratave të sigurimit të përfshira; ose

(ii) ndryshimi vjen nga zbatimi i paragrafëve 57–58 (mbi kontratat me kushte rënduese), nëse njësia ekonomike mat një grup të kontratave të sigurimit të përfshira duke zbatuar metodën e shpërndarjes së primit.

(d) efektin e çdo diference nga këmbimi i monedhave në marzhin e kontraktuar të shërbimit; dhe

(e) shumën e njohur në rezultatin e periudhën për shkak të shërbimit të marrë gjatë periudhës, e përcaktuar nga shpërndarja e marzhit të kontraktuar të shërbimit të mbetur në fund të periudhës së raportimit (para çdo shpërndarjeje)përgjatë periudhës aktuale dhe të mbetur të mbulimit të grupit të kontratave të risigurimit të mbajtura, duke zbatuar paragrafin B119.

66A Njësia ekonomike do të rregullojë marzhin e kontraktuar të shërbimit të një grupi kontratash risigurimi të mbajtura dhe si pasojë të njohë të ardhurën, kur njësia ekonomike njeh një një humbje në njohjen fillestare

 © Fondacioni i SNRF-ve

të një grupi me kushte rënduese të kontratave të risigurimit të përfshira ose në shtimin në një grup të kontratave të risigurimit të përfshira e me kushte rënduese (shih paragrafët B119C–B119E).

66B Njësia ekonomike duhet të krijojë (ose rregullojë) një përbërës rikuperimi humbjeje të aktivit për mbulimin e mbetur të një grupi kontratash risigurimi të mbajtura që përshkruajnë rikuperimin e humbjeve të njohura duke zbatuar paragrafët 66(c)(i)–(ii) dhe 66A. Përbërësi rikuperim humbjeje përcakton shumat që paraqiten në fitim ose humbje si anulime të rikuperimeve të humbjeve nga kontratat e risigurimit të mbajtura dhe janë për pasojë të përjashtuara nga shpërndarja e primeve të paguara tek risiguruesi (shih paragrafin B119F).

67 Ndryshimet në flukset e mjeteve monetare të realizuara, që vijnë nga ndryshimet në rrezikun nga mos-performanca e emetuesit të kontratës së risigurimit të mbajtur nuk lidhen me shërbimin e ardhshëm dhe nuk do të rregullojnë marzhin e kontraktuar të shërbimit.

68 Kontratat e risigurimit të mbajtura nuk mund të jenë me kushte rënduese. Për pasojë, kërkesat e paragrafëve 47–52 nuk zbatohen.

Metoda e shpërndarjes së primit për kontratat e risigurimit të mbajtura

69 Njësia ekonomike mund të përdorë metodën e shpërndarjes së primit të paraqitur në paragrafët 55–56 dhe 59 (të përshtatur për të pasqyruar tiparet e kontratave të risigurimit të mbajtura që ndryshojnë nga kontratat e sigurimit të emetuara, për shembull gjenerimi i shpenzimeve ose pakësimi i shpenzimeve kundrejt të ardhurave) për të thjeshtuar matjen e një grupi kontratash risigurimi të mbajtura, nëse në datën e krijimit të grupit:

(a) njësia ekonomike pret në mënyrë të arsyeshme se matja që do të rezultojë nuk do të ndryshojë dukshëm (në mënyrë materiale) nga ajo që do të vinte si rezultat i zbatimit të kërkesave në paragrafët 63–68; ose

(b) periudha e mbulimit e secilës kontratë në grupin e kontratave të risigurimit të mbajtura (përfshirë mbulimin e sigurimit që vjen nga të gjitha primet brenda kufijve të kontratës të përcaktuar në atë datë duke zbatuar paragrafin 34) është një vit ose më pak.

70 Kushti në paragrafin 69(a) nuk plotësohet nëse në datën e krijimit të grupit, njësia ekonomike pret të ketë ndryshime të rëndësishme në flukset e mjeteve monetare të realizuara, të cilat do të ndikonin matjen e një aktivi për mbulimin e mbetur gjatë periudhës para se të ndeshet kërkesa shtesë. Ndryshimi në flukset e mjeteve monetare të realizuara rritet për shembull:

(a) me madhësinë e flukseve të mjeteve monetare të ardhshme për çdo derivativ të përfshirë në kontratat; dhe

(b) me gjatësinë e periudhës së mbulimit të grupit të kontratave të risigurimit të mbajtura.

70A Nëse njësia ekonomike mat një grup kontratash risigurimi të mbajtura duke zbatuar metodën e shpërndarjes së primit, njësia ekonomike do të zbatojë paragrafin 66A duke rregulluar vlerën kontabël (neto) të aktivit për mbulimin e mbetur në vend të rregullimit të marzhit të kontraktuar të shërbimit.

Kontratat e investimit me tipare të pjesëmarrjes së lirë

71 Një kontratë investimi me tipare të pjesëmarrjes së lirë nuk përfshin transferim të një rreziku të rëndësishëm sigurimi. Për pasojë, kërkesat në SNRF 17 për kontratat e sigurimit modifikohen për kontratat e investimit me tipare të pjesëmarrjes së lirë si vijon:

(a) data e njohjes fillestare (shih paragrafin 25 dhe 28) është data kur njësia ekonomike bëhet palë në kontratë.

(b) kufiri i kontratës (shih paragrafin 34) modifikohet në mënyrë të tillë që flukset e mjeteve monetare janë brenda kufijve të kontratës nëse ato vijnë nga një detyrim thelbësor i njësisë ekonomike për të lëvruar mjete monetare në një datë aktuale ose të ardhshme. Njësia ekonomike nuk ka detyrim thelbësor për të lëvruar mjete monetare nëse ajo ka mundësi praktike për të vendosur një çmim për premtimin për të lëvruar mjete monetare, i cili pasqyron shumën e premtuar të mjeteve monetare dhe rreziqet përkatëse.

(c) shpërndarja e marzhit të kontraktuar të shërbimit (shih paragrafët 44(e) dhe 45(e)) modifikohet në mënyrë të tillë që njësia ekonomike do të njohë marzhin e kontraktuar të shërbimit përgjatë jetës së grupit të kontratave në një mënyrë sistematike e cila pasqyron transferimin e shërbimeve të investimit sipas kontratës.

Modifikimi dhe çregjistrimi

Modifikimi i një kontrate sigurimi

72 Nëse modifikohen kushtet e një kontrate sigurimi, për shembull sipas një marrëveshjeje mes palëve në kontratë ose për shkak të një ndryshimi në kërkesat ligjore, njësia ekonomike do të çregjistrojë kontratën fillestare dhe do të njohë kontratën e modifikuar si një kontratë të re, duke zbatuar SNRF 17 ose një Standard tjetër të zbatueshëm nëse dhe vetëm nëse plotësohet ndonjë nga kushtet në pikat (a)–(c). Ushtrimi i një të drejte të përfshirë në kushtet e kontratës nuk është modifikim. Kushtet janë:

(a) nëse kushtet e modifikuara janë përfshirë në krijimin e kontratës:

(i) kontrata e modifikuar do të përjashtohej nga objekti i SNRF 17, në zbatim të paragrafëve 3–8A;

(ii) njësia ekonomike do të ndante përbërësit e ndryshëm nga kontrata bazë e sigurimit duke zbatuar paragrafët 10–13, që do të sillte një kontratë të ndryshme sigurimi për të cilën do të zbatohej SNRF 17;

(iii) kontrata e modifikuar do të kishte kufij kontrate të ndryshëm në mënyrë thelbësore, në zbatim të paragrafit 34; ose

(iv) kontrata e modifikuar do të përfshihej në një grup të ndryshëm kontratash në zbatim të paragrafëve 14–24.

(b) kontrata fillestare plotëson përkufizimin e një *kontrate sigurimi me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë*, por kontrata e modifikuar nuk plotëson më këtë përkufizimin ose e kundërta; ose

(c) njësia ekonomike ka zbatuar metodën e shpërndarjes së primit në paragrafët 53–59 ose paragrafët 69–70 tek kontrata fillestare, por si pasojë e modifikimeve kontrata nuk plotëson më kriteret e vlefshmërisë për këtë metodë, të paragrafit 53 ose paragrafit 69.

73 Nëse si rezultat i modifikimeve një kontratë nuk plotëson asnjë nga kushtet në paragrafin 72, njësia ekonomike do t'i trajtojë ndryshimet në flukset e mjeteve monetare të shkaktuara nga modifikimet si ndryshime në vlerësimet për flukset e mjeteve monetare të realizuara, duke zbatuar paragrafët 40–52.

Çregjistrimi

74 Njësia ekonomike do të çregjistrojë një kontratë sigurimi kur, dhe vetëm kur:

(a) ajo shuhet, d.m.th kur detyrimi i cilësuar në kontratë skadon ose shkarkohet apo fshihet; ose

(b) plotësohet ndonjë nga kushtet në paragrafin72.

75 Kur një kontratë sigurimi shuhet, njësia ekonomike nuk mbart më asnjë rrezik dhe prandaj nuk i kërkohet të transferojë ndonjë burim ekonomik për të plotësuar kontratën e sigurimit. Për shembull, kur njësia ekonomike blen ri sigurim ajo do të çregjistrojë kontratën (kontratat) e sigurimit bazë kur dhe vetëm kur kontrata (kontratat) e sigurimit bazë(fillestare) është shlyer.

76 Njësia ekonomike çregjistron një kontratë sigurimi nga një grup kontratash duke zbatuar kërkesat në vijim të SNRF 17:

(a) flukset e mjeteve monetare të realizuara,të shpërndara tek grupi rregullohen për të eliminuar vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme dhe rregullimin për rrezikun jo-financiar të lidhur me të drejtat dhe detyrimet që janë çregjistruar nga grupi, duke zbatuar paragrafët 40(a)(i) dhe 40(b);

(b) marzhi i shërbimit të kontraktuari grupit rregullohet për ndryshimin në flukset monetare të realizuara, të përshkruara në pikën (a), në madhësinë e kërkuar nga paragrafët 44(c) dhe 45(c), me përjashtim të rastit kur zbatohet paragrafi 77; dhe

(c) numri i njësive të mbuluara nga kontratat e sigurimit të shërbimit të pritshme të mbetura, rregullohet për të reflektuar njësitë e mbuluara të çregjistruara nga grupi dhe shuma e marzhit të kontraktuar të shërbimit të njohur në rezultatin e periudhës bazohet në atë numër të rregulluar, në zbatim të paragrafit B119.

77 Kur njësia ekonomike çregjistron një kontratë sigurimi për shkak se transferon kontratën tek një palë e tretë ose çregjistron një kontratë sigurimi dhe njeh një kontratë të re duke zbatuar paragrafin 72, njësia ekonomike në vend që të zbatojë paragrafin 76(b) do të:

 © Fondacioni i SNRF-ve

(a) të rregullojë marzhin e shërbimit të kontraktuar për grupin nga i cili është çregjistruar kontrata, në madhësinë e kërkuar nga paragrafët 44(c) dhe 45(c), për diferencën mes pikës (i) dhe pikës (ii) për kontratat e transferuara tek një palë e tretë ose pikës (iii) për kontratat e çregjistruara duke zbatuar paragrafin 72:

(i) ndryshimin në vlerën kontabël (neto) të grupit të kontratave të sigurimit që vijnë nga çregjistrimi i kontratës duke zbatuar paragrafin 76(a).

(ii) primin e ngarkuar nga pala e tretë.

(iii) primin që do të kishte ngarkuar njësia ekonomike nëse do të kishte hyrë në një kontratë me kushte ekuivalente si kontrata e re në datën e modifikimit të kontratës, e pakësuar për ndonjë prim shtesë të ngarkuar për modifikimin.

(b) të masë kontratën e re të njohur duke zbatuar paragrafin 72, duke supozuar se njësia ekonomike ka marrë primin e përshkruar në pikën (a)(iii) në datën e modifikimit.

Paraqitja në pasqyrën e pozicionit financiar

78 Njësia ekonomike do të paraqesë veçmas në pasqyrën e pozicionit financiar vlerën kontabël (neto) të portofoleve të:

(a) kontratave të sigurimit të emetuara që janë aktive;

(b) kontratave të sigurimit të emetuara që janë detyrime;

(c) kontratave të risigurimit të mbajtura që janë aktive; dhe

(d) kontratave të risigurimit të mbajtura që janë detyrime.

79 Njësia ekonomike do të përfshijë çdo aktiv nga flukset monetare të sigurimit të blerë të njohur duke zbatuar paragrafin 28B në vlerën kontabël (neto) të portofolave përkatëse të kontratave të sigurimit të emetuara dhe çdo aktiv apo detyrim nga flukset monetare të lidhura me portofolet e kontratave të risigurimit të mbajtura (shih paragrafin 65(b) në vlerën kontabël (neto) të portofolave të kontratave të risigurimit të mbajtura.

Njohja dhe paraqitja në pasqyrën (pasqyrat) e performancës financiare (paragrafët B120–B136)

80 Gjatë zbatimit të paragrafëve 41 dhe 42, njësia ekonomike do të zbërthejë shumat e njohura në pasqyrën (pasqyrat) e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (që këtej e në vijim do t'u referohemi shkurt si pasqyra (pasqyrat) e performancës financiare) në:

(a) një rezultat shërbimi sigurimi (paragrafët 83–86), që përfshin të ardhurat nga sigurimi dhe shpenzimet e shërbimit të sigurimit; dhe

(b) të ardhura ose shpenzime financiare nga sigurimi(paragrafët 87–92).

81 Nuk kërkohet që njësia ekonomike të zbërthejë ndryshimin në rregullimin për rrezikun jo-financiar mes rezultatit për shërbimin e sigurimit dhe të ardhurave apo shpenzimeve financiare nga sigurimi. Nëse njësia ekonomike nuk e bën një zbërthim të tillë, ajo do të përfshijë të gjithë ndryshimin në rregullimin për rrezikun jo-financiar si pjesë të rezultatit nga shërbimi i sigurimit.

82 Njësia ekonomike do të paraqesë të ardhurat apo shpenzimet nga kontratat e risigurimit të mbajtura veçmas nga shpenzimet apo të ardhurat nga kontratat e sigurimit të emetuara.

Rezultati nga shërbimi i sigurimit

83 Njësia ekonomike do të paraqesë në fitim ose humbje të ardhurat e sigurimit që vijnë nga grupet e kontratave të sigurimit të emetuara. Të ardhurat e sigurimit do të përfshijnë provizionin për shërbimet që vijnë nga grupi i kontratave të sigurimit me një shumë e cila pasqyron konsideratën që njësia ekonomike pret të marrë në këmbim të këtyre shërbimeve. Në paragrafët B120–B127specifikohet mënyra se si njësia ekonomike mat të ardhurat e sigurimit.

84 Një njësi ekonomike do të paraqesë në fitim ose humbje shpenzimet e shërbimit të sigurimit që vijnë nga një grup kontratash sigurimi të emetuara, duke përfshirë kërkesat shtesë të pësuara (me përjashtim të ripagesave për përbërësit investime), shpenzimet e tjera të shërbimit të sigurimit të ndodhura dhe shuma të tjera siç përshkruhet në paragrafin 103(b).

85 Të ardhurat e sigurimit dhe shpenzimet e shërbimit të sigurimit të paraqitura në fitim ose humbje nuk do të përfshijnë asnjë përbërës investimi. Njësia ekonomike nuk do të paraqesë informacion mbi primin në fitim ose humbje nëse ky informacion nuk është i pajtueshëm me paragrafin 83.

86 Njësia ekonomike mund të paraqesë të ardhurat apo shpenzimet nga një grup i kontratave të risigurimit të mbajtura (shih paragrafët 60–70A) si një shumë e vetme, me përjashtim të të ardhurave apo shpenzimeve financiare të sigurimit; ose njësia ekonomike mund të paraqesë veçmas shumat e rikuperuara nga risiguruesi dhe një shpërndarje të primeve të paguara të cilat së bashku japin një shumë të barabartë me atë shumë të vetme. Nëse njësia ekonomike paraqet veçmas shumat e rikuperuara nga risiguruesi dhe një shpërndarje të primeve të paguara, ajo do të:

(a) trajtojë flukset e mjeteve monetare të risigurimit që varen nga kërkesat shtesë mbi kontratat në fjalë si pjesë e kërkesave shtesë që priten të rimbursohen nga kontratat e risigurimit të mbajtura;

(b) trajtojë shumat që pret të marrë nga risiguruesi të cilat nuk varen nga kërkesat shtesë të kontratave në fjalë (për shembull disa lloje komisionesh dorëzimi) si një pakësim në primet për t'u paguar tek risiguruesi;

(ba) trajtojë shumat e njohura lidhur me rikuperimin e humbjeve duke zbatuar paragrafët 66(c)(i)–(ii) dhe 66A–66B si shuma të rikuperuara nga risiguruesi; dhe

(c) mos paraqesë shpërndarjen e primeve të paguara si një pakësim në të ardhurat.

Të ardhura ose shpenzime financiare nga sigurimi (shih paragrafët B128–B136)

87 Të ardhurat ose shpenzimet financiare nga sigurimi përfshijnë ndryshimin në vlerën kontabël (neto) të grupit të kontratave të sigurimit që vijnë nga:

(a) efekti i vlerës në kohë të parasë dhe ndryshimeve në vlerën në kohë të parasë; dhe

(b) efekti i rrezikut financiar dhe i ndryshimeve në rrezikun financiar; por

(c) duke përjashtuar ndryshime të tilla për grupet e kontratave të sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, të cilat do të rregullojnë marzhin e kontraktuar të shërbimit por nuk e bëjnë këtë kur zbatojnë paragrafët 45(b)(ii), 45(b)(iii), 45(c)(ii) ose 45(c)(iii). Ato përfshihen në shpenzimet e shërbimit të sigurimit.

87A Një njësi ekonomike do të zbatojë:

(a) paragrafin B117A për të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit që vijnë nga zbatimi i paragrafit B115 (zbutja e rrezikut); dhe

(b) paragrafët 88 dhe 89 për të gjitha të ardhurat ose shpenzimet e tjera financiare të sigurimit.

88 Kur zbatohet paragrafi 87A(b), me përjashtim të rastit kur zbatohet paragrafi 89, njësia ekonomike do të bëjë një zgjedhje të politikës kontabël midis:

(a) përfshirjes e të ardhurës apo shpenzimit financiar të sigurimit për periudhën në fitim ose humbje; ose

(b) zbërthimit së të ardhurës apo shpenzimit financiar të sigurimit për periudhën për të përfshirë në fitim ose humbje një shumë të përcaktuar nga shpërndarja sistematike e të ardhurës apo shpenzimit total financiar nga sigurimi përgjatë kohëzgjatjes së grupit të kontratave, duke zbatuar paragrafët B130–B133.

89 Kur zbatohet paragrafi 87A(b), për kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, për të cilat njësia ekonomike mban zërin bazë, ajo do të bëjë një zgjedhje të politikës kontabël midis:

(a) përfshirjes e të ardhurës apo shpenzimit financiar të sigurimit për periudhën në fitim ose humbje; ose

(b) zbërthimit së të ardhurës apo shpenzimit financiar të sigurimit për periudhën për të përfshirë në fitim ose humbje një shumë që eliminon mospërputhjet kontabël me të ardhurat apo shpenzimet e përfshira në fitim ose humbje mbi zërin bazë të mbajtur, duke zbatuar paragrafët B134–B136.

90 Nëse njësia ekonomike zgjedh politikën kontabël të paraqitur në paragrafin 88(b) ose në paragrafin 89(b), ajo do të përfshijë nga të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse diferencën mes të ardhurave apo shpenzimeve financiare të sigurimit të matura sipas kërkesave të atyre paragrafëve dhe të ardhurave apo shpenzimeve totale financiare të sigurimit për periudhën.

 © Fondacioni i SNRF-ve

91 **Nëse njësia ekonomike transferon një grup kontratash sigurimi ose çregjistron një kontratë sigurimi kur zbaton paragrafin 77:**

(a) **ajo do të riklasifikojë në fitim ose humbje si rregullim riklasifikimi (shih SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* çdo shumë të mbetur për grupin (ose kontratën) që më parë ishte njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, sepse njësia ekonomike kishte zgjedhur politikën kontabël të paraqitur në paragrafin 88(b).**

(b) **ajo nuk do të riklasifikojë në fitim ose humbje si rregullim riklasifikimi (shih SNRF 18) asnjë shumë të mbetur për grupin (ose kontratën) që më parë ishte njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, sepse njësia ekonomike kishte zgjedhur politikën kontabël të paraqitur në paragrafin 89(b).**

92 Paragrafi 30 kërkon që njësia ekonomike ta trajtojë një kontratë sigurimi si një zë monetar sipas SNK 21 me qëllim përkthimin e zërave në monedhë të huaj në monedhën funksionale të njësisë ekonomike. Njësia ekonomike përfshin diferencat nga këmbimi në ndryshimet e vlerës kontabël (neto)të grupeve të kontratave të sigurimit në pasqyrën e rezultatit, me përjashtim të rastit kur ato lidhen me ndryshimet në vlerën kontabël (neto) të grupeve të kontratave të sigurimit të përfshira në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse duke zbatuar paragrafin 90. Në këtë rast ato do të përfshihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

93 **Objektivi i dhënies së informacioneve shpjeguese është që njësia ekonomike të japë informacione shpjeguese në shënime, të cilat së bashku me informacionet e dhëna në pasqyrën e pozicionit financiar, në pasqyrën (pasqyrat) e performancës dhe në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare, japin një bazë për përdoruesit e pasqyrave financiare për të vlerësuar efektin që kontratat brenda objektit të SNRF 17 kanë në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare të njësisë ekonomike. Për të realizuar këtë objektiv, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues cilësor dhe sasior mbi të gjithë elementët në vijim:**

(a) **shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare për kontratat brenda objektit të SNRF 17 (shih paragrafët 97–116);**

(b) **gjykimet e rëndësishme dhe ndryshimet në këto gjykime, të bëra gjatë zbatimit të SNRF 17 (shih paragrafët 117–120); dhe**

(c) **natyrën dhe madhësinë e rreziqeve nga këto kontrata brenda objektit të SNRF 17 (shih paragrafët 121–132).**

94 Njësia ekonomike do të ketë parasysh nivelin e detajeve të nevojshme për të plotësuar objektivin e dhënies së informacionit shpjegues dhe faktin se sa rëndësi duhet t'i kushtojë secilës prej kërkesave të ndryshme. Nëse dhënia e informacioneve shpjeguese sipas kërkesave në paragrafët 97–132, është e pamjaftueshme për të plotësuar objektivin në paragrafin 93, njësia ekonomike do të japë informacion shtesë për të plotësuar këtë objektiv.

95 Ajo do të japë informacion shpjegues në total ose të shkëputur në mënyrë që informacioni i dobishëm të mos bëhet i pakuptueshëm as nga përfshirja e një sasie të madhe hollësirash të parëndësishme, as nga grupimi i zërave që kanë karakteristika të ndryshme të rëndësishme.

96 Paragrafët 41–43 të SNRF 18 paraqesin kërkesat lidhur me grupimin dhe ndarjen e informacionit. Disa shembuj të karakteristikave që mund të jenë të përshtatshme si bazë për ndarjen e informacionit të dhënë si informacion shpjegues për kontratat e sigurimit, janë:

(a) tipi i kontratës (për shembull, linjat kryesore të prodhimit);

(b) zona gjeografike (për shembull, vendi ose rajoni); ose

(c) segmenti i raportimit, siç përkufizohet në SNRF 8 *Segmente shfrytëzimi*.

Shpjegimi i shumave të njohura

97 Nga kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të paragrafëve 98–109A, vetëm ato të paraqitura në paragrafët 98–100, 102–103, 105–105B dhe 109A janë të zbatueshme për kontratat në të cilat përdoret metoda e shpërndarjes së primit. Nëse njësia ekonomike përdor metodën e shpërndarjes së primit ajo do të japë informacion shpjegues edhe:

(a) për secilin nga kriteret në paragrafët 53dhe 69 që ka plotësuar;

(b) nëse ka bërë një rregullim për vlerën në kohë të parasë dhe efektin e rrezikut financiar duke zbatuar paragrafët 56, 57(b) dhe 59(b); dhe

(c) për metodën që ka zgjedhur për të njohur flukset e mjeteve monetare nga blerja e sigurimit në zbatim të paragrafit 59(a).

98 Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues mbi rakordimet të cilat tregojnë sesi vlerat kontabël (neto) të kontratave brenda objektit të SNRF 17 kanë ndryshuar gjatë periudhës për shkak të flukseve të mjeteve monetare dhe të ardhurat e shpenzimet e njohura në pasqyrën (pasqyrat) e performancës financiare. Rakordimet do të jepen veçmas për kontratat e sigurimit të emetuara dhe kontratat e risigurimit të mbajtura. Njësia ekonomike do të zbatojë kërkesat e paragrafëve 100–109 për të pasqyruar tiparet e kontratave të risigurimit të mbajtura, të cilat dallojnë nga kontratat e sigurimit të emetuara; për shembull, gjenerimi i shpenzimeve ose pakësimi i një shpenzimi kundrejt një të ardhure.

99 Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues të mjaftueshëm mbi rakordimet për t'iu mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare identifikimin e ndryshimeve nga flukset e mjeteve monetare dhe shumat të cilat janë njohur në pasqyrën (pasqyrat) e performancës financiare. Për të plotësuar këtë kërkesë, njësia ekonomike do:

(a) të paraqesë në një tabelë rakordimet e përmendura në paragrafët 100–105B; dhe

(b) të paraqesë për secilin rakordim, vlerat kontabël (neto) në fillim dhe në fund të periudhës, të zbërthyera në një total për portofolet e kontratave që janë aktive dhe në një total për portofolet e kontratave që janë detyrime, të cilat barazojnë shumat e paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar duke zbatuar paragrafin 78.

100 Njësia ekonomike do të japë veçmas informacione shpjeguese mbi rakordimin e tepricave të çeljes dhe të mbylljes për:

(a) secilin nga detyrimet neto (ose aktivet) për përbërësin e mbetur të mbulimit, duke përjashtuar çdo përbërës humbjeje.

(b) çdo përbërës humbjeje (shih paragrafët 47–52 dhe 57–58).

(c) secilin nga detyrimet për kërkesat shtesë të pësuara. Për kontratat e sigurimit tek të cilat është zbatuar metoda e shpërndarjes së primit e përshkruar në paragrafët 53–59 ose 69–70A njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues veçmas për:

(i) vlerësimet mbi vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme; dhe

(ii) rregullimin për rrezikun jo-financiar;

101 Për kontratat e sigurimit tek të cilat është zbatuar metoda e shpërndarjes së primit e përshkruar në paragrafët 53–59 ose 69–70A, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues edhe mbi rakordimin e tepricave të çeljes dhe të mbylljes për secilin sa vijon:

(a) vlerësimet mbi vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme;

(b) rregullimin për rrezikun jo-financiar; dhe

(c) marzhin e shërbimit kontraktual.

102 Objektivi i rakordimit në paragrafët 100–101 është të ofrojë tipe të ndryshme informacioni rreth rezultatit të shërbimit të sigurimit.

103 Në rakordimet e kërkuara në paragrafin 100, nëse është e zbatueshme, njësia ekonomike do të japë veçmas informacion shtesë për secilën nga shumat në vijim të lidhura me shërbimet:

(a) të ardhurat nga sigurimi.

(b) shpenzimet e shërbimit të sigurimit, duke treguar veçmas:

(i) kërkesat shtesë të pësuara (përjashtuar përbërësit investime) dhe shpenzimet e tjera të shërbimit të sigurimit të pësuara;

(ii) amortizimin e flukseve të mjeteve monetare të blerjes së sigurimit;

(iii) ndryshimet që lidhen me shërbimin e shkuar, d.m.th ndryshimet në flukset e mjeteve monetare të realizuara të lidhura me detyrimin për kërkesat shtesë të pësuara; dhe

(iv) ndryshimet që lidhen më shërbimin e ardhshëm, dmth humbjet mbi grupet e kontratave me kushte rënduese dhe anulimet e humbjeve të tilla.

(c) Përbërësit e investimit të përjashtuar nga të ardhurat e sigurimit dhe shpenzimet e shërbimit të sigurimit (e kombinuar me rimbursimin e primeve, me përjashtim të rastit kur primet jepen si

 © Fondacioni i SNRF-ve

informacion shpjegues si pjesë e flukseve monetare në periudhën e cilësuar në paragrafin 105(a)(i)).

104 Në rakordimet e kërkuara në paragrafin 101, nëse është e zbatueshme, njësia ekonomike do të japë veçmas informacion shtesë për secilën nga shumat në vijim të lidhura me shërbimet:

(a) ndryshimet që lidhen me shërbimin e ardhshëm, duke zbatuar paragrafët B96–B118,duke treguar veçmas:

(i) ndryshimet në vlerësimet që rregullojnë marzhin e kontraktuar të shërbimit;

(ii) ndryshimet në vlerësimet që nuk rregullojnë marzhin e kontraktuar të shërbimit; d.m.th humbjet në grupet e kontratave me kushte rënduese dhe anulimet e humbjeve të tilla; dhe

(iii) efektet e kontratave të njohura fillimisht gjatë periudhës.

(b) ndryshimet e lidhura me shërbimin aktual, d.m.th:

(i) shumën e marzhit të kontraktuar të shërbimit të njohur në rezultat për të reflektuar transferimin e shërbimit;

(ii) ndryshimin në rregullimin për rrezikun jo-financiar i cili nuk lidhet me shërbimin e ardhshëm ose të shkuar; dhe

(iii) *rregullimet për eksperiencë* (shih paragrafët B97(c) dhe B113(a)), duke përjashtuar shumat e lidhura me rregullimin e rrezikut për rrezikun jo-financiar të përfshirë në pikën (ii).

(c) ndryshimet që lidhen me shërbimin e shkuar, dmth ndryshimet në flukset e mjeteve monetare të realizuara, të lidhura me kërkesat shtesë të pësuara (shih paragrafët B97(b) dhe B113(a)).

105 Për të plotësuar rakordimet në paragrafët 100–101, nëse është e zbatueshme, njësia ekonomike do të japë veçmas informacion shpjegues edhe për secilën nga shumat në vijim të palidhura me shërbimet e ofruara gjatë periudhës:

(a) flukset e mjeteve monetare gjatë periudhës, përfshirë:

(i) primet e marra për kontratat e sigurimit të emetuara(ose të paguara për kontratat e risigurimit të mbajtura);

(ii) flukset e mjeteve monetare të blerjes së sigurimit; dhe

(iii) kërkesat shtesë të pësuara e të paguara dhe shpenzimet e tjera të shërbimit të sigurimit të paguara për kontratat e sigurimit të emetuara (ose të rikuperuara nga kontratat e risigurimit të mbajtura), duke përjashtuar flukset e mjeteve monetare të blerjes së sigurimit.

(b) efekti i ndryshimeve në rrezikun nga mos performanca e emetuesit të kontratave të risigurimit të mbajtura;

(c) të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit; dhe

(d) çdo nënzë shtesë që mund të jetë i nevojshëm për të kuptuar ndryshimin në vlerën kontabël (neto) të kontratave të sigurimit.

105A Njësia ekonomike do të japë si informacion shpjegues një rakordim të tepricave në çelje dhe në mbyllje të aktiveve për flukset monetare të blerjes së sigurimit të njohura duke zbatuar paragrafin 28B. Njësia ekonomike do të grupojë informacionin për rakordim në një nivel që është në pajtim me rakordimin e kontratave të sigurimit, duke zbatuar paragrafin 98.

105B Njësia ekonomike do të japë informacion veçmas në rakordimin e kërkuar nga paragrafi 105A për çdo humbje nga zhvlerësimi dhe çdo anulim të humbjeve nga zhvlerësimi të njohura duke zbatuar paragrafin 28E–28F.

106 Për kontratat e sigurimit të emetuara, të ndryshme nga ato për të cilat zbatohet metoda e shpërndarjes së primit e përshkruar në paragrafët 53–59 , njësia ekonomike do të japë si informacion shpjegues një analizë të të ardhurave të sigurimit të njohura gjatë periudhës duke përfshirë:

(a) shumat që lidhen me ndryshimet në detyrimin për mbulimin e mbetur siç specifikohet në paragrafin B124, duke paraqitur veçmas:

(i) shpenzimet e shërbimit të sigurimit të ndodhura gjatë periudhës siç specifikohet në paragrafin B124(a);

(ii) ndryshimin në rregullimin për rrezikun jo-financiar, siç specifikohet në paragrafin B124(b);

(iii) shumën e marzhit të kontraktuar të shërbimit të njohur në fitim ose humbje (rezultatin e periudhës) për shkak të transferimit të kontratës së sigurimit të shërbimit gjatë periudhës, siç specifikohet në paragrafin B124(c); dhe

(iv) shumat e tjera, nëse ka, për shembull rregullimet për eksperiencë për primet e marra të ndryshme nga ato që lidhen me shërbimin e ardhshëm, siç specifikohet në paragrafin B124(d).

(b) shpërndarja e pjesës së primeve që lidhen me rikuperimin e flukseve monetare të blerjes së sigurimit (shih paragrafin B125).

107 Për kontratat e sigurimit të ndryshme nga ato për të cilat është zbatuar metoda e shpërndarjes së primit e përshkruar në paragrafët 53–59 ose 69–70A, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues mbi efektin në pasqyrën e pozicionit financiar veçmas për kontratat e sigurimit të emetuara dhe kontratat e risigurimit të mbajtura të cilat janë njohur fillimisht gjatë periudhës, duke treguar efektin e tyre në njohjen fillestare në:

(a) vlerësimet e vlerës aktuale të daljeve të ardhshme të mjeteve monetare, duke treguar veçmas shumën e flukseve monetare të blerjes së sigurimit;

(b) vlerësimet mbi vlerën aktuale të flukseve hyrëse monetare të ardhshme;

(c) rregullimin për rrezikun jo-financiar; dhe

(d) marzhin e kontraktuar të shërbimit.

108 Njësia ekonomike do të paraqesë veçmas, në dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 107, shumat që vijnë nga:

(a) kontratat e blera nga njësi ekonomike të tjera gjatë transferimit të kontratave të sigurimit ose kombinimit të bizneseve; dhe

(b) grupet e kontratave që janë me kushte rënduese.

109 Për kontratat e sigurimit të ndryshme nga ato për të cilat është zbatuar metoda e shpërndarjes së primit e përshkruar në paragrafët 53–59 ose 69–70A, njësia ekonomike do të japë informacion se kur pret të njohë marzhin e kontraktuar të shërbimit të mbetur në fund të periudhës raportuese në fitim ose humbje, nga ana sasiore, me hapësira kohore të përshtatshme. Ky informacion duhet të jepet veçmas për kontratat e sigurimit të emetuara dhe kontratat e risigurimit të mbajtura.

109A Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues sasior me hapësira kohore të përshtatshme, kur pret të mos njohë (çregjistrojë) një aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit duke zbatuar paragrafin 28C.

Të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit

110 Njësia ekonomike do të japë informacion dhe do të shpjegojë shumën totale të të ardhurave ose shpenzimeve financiare të sigurimit gjatë periudhës raportuese. Veçanërisht, njësia ekonomike do të shpjegojë lidhjen mes të ardhurave ose shpenzimeve financiare të sigurimit me kthimin nga investimi në aktivet e veta, për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave të saj financiare të bëjnë vlerësimin e burimit të të ardhurave ose shpenzimeve financiare të njohura në fitim ose humbje dhe në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

111 Për kontratat me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, njësia ekonomike do të përshkruajë përbërjen e zërave bazë(të nënkuptuar) dhe do të japë informacion shpjegues për vlerën e tyre të drejtë.

112 Për kontratat me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, nëse njësia ekonomike zgjedh të mos rregullojë marzhin e kontraktuar të shërbimit për disa nga ndryshimet në flukset monetare të realizuara, duke zbatuar paragrafin B115, ajo do të japë informacion shpjegues mbi efektin e kësaj zgjedhjeje në rregullimin e marzhit të kontraktuar të shërbimit gjatë periudhës aktuale.

113 Për kontratat me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, nëse njësia ekonomike ndryshon bazën e zbërthimit të të ardhurave ose shpenzimeve financiare të sigurimit mes fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, duke zbatuar paragrafin B135, ajo do të japë informacion shpjegues në periudhën në të cilën ka ndodhur ndryshimi në metodë për:

(a) arsyen pse njësia duhet të ndryshonte bazën e zbërthimit;

(b) shumën e çdo rregullimi për secilin nënzë të ndikuar të pasqyrave financiare; dhe

 © Fondacioni i SNRF-ve

(c) vlerën kontabël (neto) të grupit të kontratave të sigurimit për të cilat u zbatua ndryshimi në atë datë.

Shumat e përkohshme

114 Njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese, të cilat u mundësojnë përdoruesve të pasqyrave financiare të identifikojnë efektin e grupeve të kontratave të sigurimit të matura në datën e tranzicionit, duke zbatuar metodën e modifikuar retrospektive (shih paragrafët C6–C19A) ose metodën e vlerës së drejtë (shih paragrafët C20–C24B) në marzhin e kontraktuar të shërbimit dhe të ardhurat nga sigurimi në periudhat pasuese. Prandaj njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për rakordimin mbi marzhin e kontraktuar të shërbimit duke zbatuar paragrafin 101(c) dhe për shumën e të ardhurës nga sigurimi duke zbatuar paragrafin 103(a), veçmas për:

(a) kontratat e sigurimit që ekzistojnë në datën e tranzicionit dhe për të cilat njësia ekonomike ka zbatuar metodën e modifikuar retrospektive;

(b) kontratat e sigurimit që ekzistojnë në datën e tranzicionit dhe për të cilat njësia ekonomike ka zbatuar metodën e vlerës së drejtë; dhe

(c) gjithë kontratat e tjera të sigurimit.

115 Për të gjitha periudhat në të cilat dhënia e informacioneve shpjeguese është bërë duke zbatuar paragrafët 114(a) ose114(b),njësia ekonomike do të shpjegojë sesi e ka përcaktuar matjen e kontratave të sigurimit në datën e tranzicionit për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë natyrën dhe rëndësinë e metodave dhe gjykimeve të përdorura në përcaktimin e shumave të tranzicionit (përkohshme).

116 Njësia ekonomike që zgjedh të zbërthejë të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit mes fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, zbaton paragrafët C18(b), C19(b), C24(b) dhe C24(c) për të përcaktuar diferencën e akumuluar mes të ardhurave ose shpenzimeve financiare të sigurimit, që do të ishin njohur në fitim ose humbje dhe totalit të të ardhurës ose shpenzimit financiar të sigurimit në datën e tranzicionit për grupet e kontratave të sigurimit për të cilat zbatohet zbërthimi. Njësia ekonomike do të japë si informacion shpjegues një rakordim të tepricave të çeljes dhe të mbylljes të shumave të akumuluara të përfshira në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse për aktivet financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse të lidhura me grupet e kontratave të sigurimit, për të gjitha periudhat në të cilat ekzistojnë shumat e përcaktuara në zbatim të këtyre paragrafëve. Rakordimi do të përfshijë për shembull fitimet ose humbjet e njohura në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse gjatë periudhës dhe fitimet ose humbjet e njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në periudhat e mëparshme të riklasifikuara në fitim ose humbje.

Gjykime të rëndësishme kur zbatohet SNRF 17

117 Njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese mbi gjykimet e rëndësishme dhe ndryshimet në gjykime të bëra gjatë zbatimit të SNRF 17. Në mënyrë specifike, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues mbi të dhënat fillestare, supozimet dhe teknikat e përdorura të vlerësimit, duke përfshirë:

(a) metodat e përdorura për matjen e kontratave të sigurimit brenda objektit të SNRF 17 dhe proceset e vlerësimit të të dhënave fillestare të këtyre metodave. Njësia ekonomike do të japë edhe informacione sasiore mbi këto të dhëna fillestare, me përjashtim të rastit kur kjo nuk është praktike.

(b) çdo ndryshim në metodat dhe proceset për vlerësimin e të dhënave fillestare të përdorura për të matur kontratat, arsyet për secilin ndryshim dhe tipin e kontratave të ndikuara.

(c) metodën e përdorur, në madhësinë e mbetur pa mbuluar në pikën (a):

(i) për të dalluar ndryshimet në vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme që vijnë nga ushtrimi i lirisë së gjykimit nga ndryshimet e tjera në vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme për kontratat pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë (shih paragrafin B98);

(ii) për të përcaktuar rregullimin për rrezikun jo-financiar, përfshirë nëse ndryshimet në rregullimin për rrezikun jo-financiar janë zbërthyer në përbërësin e shërbimit të sigurimit dhe përbërësin financiar të sigurimit ose nëse janë paraqitur të plotë në rezultatin e shërbimit të sigurimit;

(iii) për të përcaktuar normat e skontimit;

(iv) për të përcaktuar përbërësit investim; dhe

(v) për të përcaktuar peshën relative të përfitimeve të ofruara nga mbulimi i sigurimit dhe shërbimi i kthimit të investimit, ose nga mbulimi i i sigurimit dhe shërbimi i lidhur me investimin (shih paragrafët B119–B119B).

118 Nëse duke zbatuar paragrafin 88(b) ose paragrafin 89(b), njësia ekonomike zgjedh të zbërthejë të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit në shuma të paraqitura në fitim ose humbje dhe në shuma të paraqitura në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, njësia ekonomike do të japë si informacion një shpjegim të metodave të përdorura për të përcaktuar të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit të njohura në fitim ose humbje.

119 Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues mbi shkallën e besimit të përdorur për të përcaktuar rregullimin për rrezikun jo-financiar. Nëse njësia ekonomike përdor një teknikë të ndryshme nga teknika e shkallës së besimit për përcaktimin e rregullimit për rrezikun jo-financiar, ajo do të japë informacion shpjegues për teknikën e përdorur dhe shkallën e besimit që i korrespondon rezultateve të asaj teknike.

120 Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues mbi kurbën e interesave (ose vargun e kurbave te interesave) të përdorur për të skontuar flukset e mjeteve monetare e cila nuk ndryshon në varësi të kthimeve nga zërat bazë, duke zbatuar paragrafin 36. Nëse një njësi ekonomike e jep këtë informacion shpjegues në formën e shumës gjithsej për një grupim të kontratave të sigurimit, ajo do ta japë këtë informacion në formën e mesatareve të ponderuara ose si diapazone relativisht të ngushta.

Natyra dhe madhësia e rreziqeve që vijnë nga kontratat brenda objektit të SNRF 17

121 Njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave të saj financiare, vlerësimin e natyrës, shumës, kohës dhe pasigurisë së flukseve monetare të ardhshme që vijnë nga kontratat brenda objektit të SNRF 17. Paragrafët 122–132 përmbajnë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese që zakonisht do të jenë të nevojshme për të plotësuar këtë kërkesë.

122 Këto dhënie informacionesh shpjeguese fokusohen në rreziqet e sigurimit dhe financiare që vijnë nga kontratat e sigurimit dhe mënyrën sesi ato janë menaxhuar. Zakonisht rreziqet financiare përfshijnë rrezikun e kredisë, rrezikun e likuiditetit dhe rrezikun e tregut, por nuk kufizohen me ta.

123 Nëse informacioni i paraqitur rreth ekspozimit të njësisë ekonomike ndaj rrezikut në fund të periudhës raportuese nuk është përfaqësues i ekspozimit të saj ndaj rrezikut gjatë periudhës, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues mbi këtë fakt, arsyen pse ekspozimi në fund të periudhës nuk është përfaqësues dhe informacion tjetër që është përfaqësues i ekspozimit të saj ndaj rrezikut gjatë periudhës.

124 Për secilin tip rreziku që vjen nga kontratat brenda objektit të SNRF 17, njësia ekonomike do të japë si shpjegim:

(a) ekspozimet ndaj rreziqeve dhe sesi vijnë ato;

(b) objektivat, politikat dhe proceset e njësisë ekonomike për menaxhimin e rreziqeve dhe metodat e përdorura për të matur rreziqet; dhe

(c) çdo ndryshim në pikat (a) dhe (b) nga periudha e mëparshme.

125 Për secilin tip rreziku që vjen nga kontratat brenda objektit të SNRF 17, njësia ekonomike do të japë si shpjegim:

(a) informacion përmbledhës sasior lidhur me ekspozimin e saj ndaj rrezikut në fund të periudhës raportuese. Kjo dhënie informacionesh shpjeguese do të bazohet në informacionin e siguruar nga brenda njësisë ekonomike nga personeli drejtues kryesor.

(b) informacionet e kërkuara nga paragrafët 127–132, për aq sa nuk është dhënë kur zbatohet pika (a) e këtij paragrafi.

126 Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues mbi efektin e kuadrit rregullator në të cilin ajo vepron; për shembull, kërkesat për kapitalin minimal ose garancitë e kërkuara për normat e interesit. Nëse njësia ekonomike zbaton paragrafin 20 kur përcakton grupet e kontratave të sigurimit për të cilat zbaton kërkesat për njohjen dhe matjen të SNRF 17, ajo do të japë informacione shpjeguese mbi këtë fakt.

Të gjitha tipet e rreziqeve—përqëndrimi i rrezikut

127 Njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese mbi përqendrimin e rrezikut që vjen nga kontratat brenda objektit të SNRF 17, përfshirë një përshkrim sesi njësia përcakton përqendrimin dhe një përshkrim të karakteristikave të përbashkëta që identifikon secilin përqendrim (për shembull tipi i ngjarjes së siguruar, industria, zona gjeografike, ose monedha). Përqendrimet e rrezikut financiar mund të vijnë, për shembull

 © Fondacioni i SNRF-ve

nga garancitë e normave të interesit që hyjnë në fuqi në të njëjtin nivel për një numër të madh kontratash. Përqendrimet e rrezikut financiar mund të vijnë edhe nga përqendrimet e rrezikut jo-financiar; për shembull, nëse një njësi ekonomike ofron mbrojtjen e përgjegjësisë për produktet për shoqëritë farmaceutike dhe ka gjithashtu investime në këto shoqëri.

Rreziqet e sigurimit dhe të tregut—analiza e ndjeshmërisë

128 Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues rreth ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve në variablat e rrezikut që vijnë nga kontratat brenda objektit të SNRF 17. Për të plotësuar këtë kërkesë, njësia ekonomike duhet të japë si informacion shpjegues:

(a) një analizë të ndjeshmërisë, e cila tregon sesi fitimi ose humbja dhe kapitali i vet do të ndikoheshin nga ndryshimet në variablat e rrezikut që ishin të mundshme në mënyrë të arsyeshme në fund të periudhës së raportimit:

(i) për rrezikun e sigurimit—që tregon efektin për kontratat e sigurimit të emetuara para dhe pas zbutjes së rrezikut nga kontratat e risigurimit të mbajtura; dhe

(ii) për çdo tip të rrezikut të tregut—në një mënyrë që shpjegon lidhjen mes ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve në variablat e rrezikut që vijnë nga kontratat e sigurimit dhe të atyre që vijnë nga aktivet financiare të mbajtura nga njësia ekonomike.

(b) metodat dhe supozimet e përdorura në përgatitjen e analizës së ndjeshmërisë; dhe

(c) ndryshimet në metodat dhe hipotezat e përdorura në përgatitjen e analizës së ndjeshmërisë kundrejt periudhës së shkuar dhe arsyet për këto ndryshime.

129 Nëse njësia ekonomike përgatit një analizë të ndjeshmërisë e cila tregon sesi ndikohen shumat e ndryshme nga ato të cilësuara në paragrafin 128(a) nga ndryshimet në variablat e rrezikut dhe e përdor këtë analizë ndjeshmërie për të menaxhuar rreziqet që vijnë nga kontratat brenda objektit të SNRF 17, njësia ekonomike mund ta përdorë këtë analizë ndjeshmërie në vend të analizës të cilësuar në paragrafin 128(a). Njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese edhe për:

(a) një shpjegim të metodës së përdorur në përgatitjen e një analize të tillë ndjeshmërie dhe të parametrave dhe supozimeve kryesorë të bëra për informacionin e dhënë; dhe

(b) një shpjegim të objektivit të metodës së përdorur dhe të ndonjë kufizimi që mund të rezultojë në informacionin e dhënë.

Rreziku i sigurimit—zhvillimi i kërkesave shtesë

130 Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për kërkesat shtesë aktuale të krahasuara me vlerësimet e mëparshme të shumave të paskontuara të kërkesave shtesë (d.m.th zhvillimi i kërkesave shtesë). Dhënia e informacioneve shpjeguese rreth zhvillimit të kërkesave shtesë duhet të fillojë në periudhën kur doli kërkesa materiale më e hershme, për të cilat ka ende pasiguri rreth shumës dhe kohës së pagesave për kërkesat në fund të periudhës raportuese; por nuk kërkohet që dhënia e informacioneve shpjeguese të fillojë përtej 10 viteve nga fundi i periudhës raportuese. Njësia ekonomike nuk ka nevojë të japë informacion shpjegues për zhvillimin e kërkesave shtesë për të cilat pasiguria rreth shumës dhe kohës së pagesave për kërkesat zakonisht zgjidhet brenda një viti. Njësia ekonomike do të rakordojë dhënien e informacioneve shpjeguese rreth zhvillimit të kërkesave shtesë me totalin e vlerës kontabël (neto)të grupeve të kontratave të sigurimit, për të cilat zbaton paragrafin 100(c) për këtë dhënie informacioni.

Rreziku i kredisë—informacione të tjera

131 Për rrezikun e kredisë që vjen nga kontratat brenda objektit të SNRF 17, njësia ekonomike do të japë shpjegime për:

(a) shumën që përfaqëson më mirë ekspozimin e saj maksimal ndaj rrezikut të kredisë në fund të periudhës raportuese, veçmas për kontratat e sigurimit dhe kontratat e risigurimit të mbajtura; dhe

(b) informacionin rreth cilësisë së kredisë së kontratave të risigurimit të mbajtura që janë aktive.

Rreziku i likuiditetit—informacione të tjera

132 Për rrezikun e likuiditetit që vjen nga kontratat brenda objektit të SNRF 17, njësia ekonomike do të japë si informacion:

(a) një shpjegim sesi ajo menaxhon rrezikun e likuiditetit.

(b) analiza maturimi të veçanta për portofolet e kontratave të sigurimit të emetuara që janë detyrime dhe portofolet e kontratave të risigurimit të mbajtura që janë detyrime dhe që tregojnë të paktën flukset monetare neto të portofoleve për secilin nga pesë vitet e para pas datës së raportimit dhe në total përtej pesë viteve të para. Nuk kërkohet që njësia ekonomike të përfshijë në këto analiza detyrimet për mbulimin e mbetur të matur duke zbatuar paragrafët 55–59 dhe paragrafët 69–70A. Analizat mund të jenë në formën e:

(i) një analize të flukseve monetare neto të mbetura, të kontraktuara dhe të paskontuara duke vlerësuar kohën e tyre; ose

(ii) një analize të vlerësimeve për vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme duke vlerësuar kohën e tyre.

(c) shumave që janë të pagueshme menjëherë, duke shpjeguar lidhjen mes shumave të tilla dhe vlerës kontabël (neto) të portofolave përkatëse të kontratave, nëse për dhënien e informacioneve nuk është zbatuar pika (b) e këtij paragrafi.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Shtojca A
Termat e përkufizuara

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF 17 Kontratat e sigurimit.

marzhi i shërbimit i kontraktuar

Një përbërës i vlerës kontabël (neto) të aktivit ose të detyrimit për një **grup kontratash sigurimi** i cili paraqet fitimin e parealizuar që njësia ekonomike do të njohë kur të ofrojë **shërbimet e kontratës së sigurimit** sipas **kontratave të sigurimit** në grup.

periudha e mbulimit

Periudha gjatë së cilës njësia ekonomike ofron **shërbimet e kontratës së sigurimit.** Kjo periudhë përfshin **shërbimet e kontratës së sigurimit** që lidhet me të gjitha primet brenda kufijve të **kontratës së sigurimit.**

rregullimi për eksperiencën

Diferenca midis:

(a) për primet e marra (dhe çdo fluks monetar të lidhur si **flukset monetare të blerjes së sigurimit** dhe taksat e primit të sigurimit)—vlerësimit në fillim të periudhës i shumave të pritshme gjatë periudhës dhe flukseve monetare aktuale të periudhës; ose

(b) për shpenzimet e shërbimit të sigurimit (duke përjashtuar shpenzimet e blerjes së sigurimit)—vlerësimit në fillim të periudhës i shumave të pritshme për t'u përballur gjatë periudhës dhe shumave aktuale të ndodhura gjatë periudhës.

rreziku financiar

Rreziku i një ndryshimi të mundshëm të ardhshëm në një ose më shumë norma interesi të caktuara, çmimin e instrumentit financiar, çmimin e mallit, kursin e këmbimit, indeksit të çmimeve, klasifikim kredie ose indeks kredie ose variabla të tjerë, po qe se në rastin e një variabli jo-financiar ky variabël nuk është specifik për një palë të kontratës.

flukset monetare të realizuara

Një vlerësim i qartë, pa shtrembërime dhe i ponderuar për probabilitetin (d.m.th vlerën e pritur) të vlerës aktuale të daljeve të mjeteve monetare të ardhshme minus vlerën aktuale të hyrjeve të ardhshme në mjete monetare që vijnë ndërsa njësia ekonomike përmbush **kontratat e sigurimit**, përfshirë një **rregullim për rrezikun jo-financiar**.

grupi i kontratave të sigurimit

Një grup **kontratash sigurimi** që vijnë nga ndarja e një **portofoli kontratash sigurimi** në të paktën disa kontrata të emetuara brenda një periudhe jo më të gjatë se një vit dhe që në njohjen fillestare:

(a) janë me kushte rënduese, nëse ka;

(b) nuk kanë shumë mundësi që të bëhen me kushte rënduese më pas, nëse ka; ose

(c) nuk përfshihen në pikën (a) ose (b), nëse ndodh.

flukset e mjeteve monetare të blerjes së sigurimit

Flukset monetare që vijnë nga kostot e shitjes, nënshkrimit dhe fillimit të një **grupi kontratash sigurimi** (të emetuara ose që pritet të emetohen) që janë të ngarkueshme drejtpërdrejt tek **portofoli i kontratave të sigurimit** të cilit i përket grupi. Flukse të tilla monetare përfshijnë flukset që nuk janë të ngarkueshme drejtpërdrejt tek kontratat individuale ose **grupet e kontratave të sigurimit** brenda portofolit.

kontratë sigurimi

Kontratë sipas të cilës një palë (siguruesi) pranon **rrezik sigurimi** të rëndësishëm nga një palë tjetër (**mbajtësi i policës së sigurimit**) duke rënë dakord që të kompensojë **mbajtësin e policës së sigurimit** nëse një ngjarje e caktuar e pasigurt e ardhshme (**ngjarja e siguruar**) ndikon negativisht **mbajtësin e policës së sigurimit**.

shërbime të kontratës së sigurimit

Shërbimet në vijim, që njësia ekonomike i ofron tek një **policë mbajtës** i një **kontrate sigurimi**:

(a) mbulim për një **ngjarje të siguruar** (mbulimi i sigurimit);

(b) për **kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë**, gjenerimi i një kthimi nga investimi për policë mbajtësin nëse kjo është e zbatueshme (shërbim kthim investimi); dhe

(c) për **kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë**, menaxhimi i zërave bazë (të përfshirë) për llogari të **policë mbajtësit** (shërbime të lidhura me investimin).

kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë

Një **kontratë sigurimi** për të cilën në krijim:

(a) kushtet e kontratës specifikojnë se **policë mbajtësi** merr pjesë në ndarjen e një grupi të identifikuar qartë **zërash bazë**;

(b) njësia ekonomike pret që të paguajë tek **policë mbajtësi** një shumë të barabartë me një pjesë të rëndësishme të vlerës së drejtë të kthimeve nga **zërat bazë**; dhe

(c) njësia ekonomike pret që një pjesë e rëndësishme e ndonjë ndryshimi në shumat që duhet të paguhen tek **policë mbajtësi** të ndryshojnë me ndryshimin në vlerën e drejtë të **zërave bazë**.

kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë

Një **kontratë sigurimi** që nuk është **kontratë sigurimi me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë**.

rreziku i sigurimit

Rrezik i ndryshëm nga **rreziku financiar**, i transferuar nga mbajtësi i një kontrate tek emetuesi.

ngjarja e siguruar

Një ngjarje e pasigurt e ardhshme që mbulohet nga një **kontratë sigurimi** dhe që krijon **rrezik sigurimi**.

përbërësi investim

Shumat që njësia ekonomike, sipas një **kontrate sigurimi** detyrohet t'i kthejë një **policë mbajtësi** në çdo rast, pavarësisht nëse **ngjarja e siguruar** ndodh

kontratat e investimit me tipare të pjesëmarrjes së lirë

Një instrument financiar që ofron një investues i caktuar me të drejta kontraktuale për të marrë shuma shtesë, si një shtesë ndaj një shume që nuk varet nga dëshira e emetuesit:

(a) që pritet të jenë një pjesë e rëndësishme e përfitimeve kontraktuale gjithsej;

(b) koha ose shuma e të cilave janë sipas kontratës të lira në zgjedhjen e emetuesit; dhe

(c) të cilat sipas kontratës bazohen në:

(i) performancën e një grupi të caktuar kontratash ose e një tipi të caktuar kontratash;

(ii) kthimet e realizuara dhe/ose të parealizuara të investimeve në një grup të caktuar aktivesh të mbajtura nga emetuesi; ose

(iii) fitimin ose humbjen e njësisë ekonomike ose fondit që emeton kontratën.

detyrimet për kërkesat shtesë të pësuara

Detyrimi i njësisë ekonomike për të:

(a) hetuar dhe paguar kërkesat shtesë të vlefshme për **ngjarjet e siguruara**, të cilat kanë ndodhur tashmë, duke përfshirë ngjarjet që kanë ndodhur por për të cilat kërkesat shtesë nuk janë raportuar ende, si dhe shpenzimet e tjera të sigurimit të ndodhura; dhe

(b) shumat e paguara që nuk janë përfshirë në pikën (a) dhe që lidhen me:

(i) **shërbimet e kontratës së sigurimit**, që janë ofruar tashmë; ose

(ii) çdo **përbërës investimi** ose ndonjë shumë tjetër që nuk lidhet me ofrimin e **shërbimeve të kontratës së sigurimit** dhe që nuk përfshihen në **detyrimin për mbulimin e mbetur.**

detyrimet për mbulimin e mbetur

Detyrimi i njësisë ekonomike për të:

(a) hetuar dhe paguar kërkesat shtesë të vlefshme sipas **kontratave të sigurimit** ekzistuese për **ngjarjet e siguruara** që nuk kanë ndodhur ende (d.m.th detyrimi që lidhet me pjesën e mbetur të periudhës së sigurimit); dhe

(b) paguajë shumat sipas **kontratave të sigurimit** ekzistuese që nuk janë përfshirë në pikën (a) dhe që lidhen me:

(i) **shërbimet e kontratës së sigurimit** ende të pa ofruara (d.m.th.

 © Fondacioni i SNRF-ve

detyrime që lidhen me ofrimin në të ardhmen të **shërbimeve të sigurimit të kontratës);** ose

(ii) çdo **përbërës investimi** ose ndonjë shumë tjetër që nuk lidhet me ofrimin e **shërbimeve të kontratës së sigurimit** dhe që nuk janë përfshirë në **detyrimin për kërkesat shtesë të pësuara**.

mbajtësi i policës së sigurimit — Një palë që ka një të drejtë për t'u kompensuar sipas një **kontrate sigurimi** nëse ndodh një **ngjarje e siguruar**.

portofol i kontratave të sigurimit — **Kontrata sigurimi** të cilat janë objekt i rreziqeve të ngjashme dhe që menaxhohen së bashku.

kontratë risigurimi — Një **kontratë sigurimi** e emetuar nga një njësi ekonomike (risiguruesi) për të kompensuar një njësi tjetër ekonomike për kërkesat shtesë që vijnë nga një ose më shumë **kontrata sigurimi** të emetuara nga kjo njësi ekonomike tjetër (kontratat bazë).

rregullimi për rrezikun jo-financiar — Kompensimi që një njësi ekonomike kërkon për mbartjen e pasigurisë lidhur me shumën dhe kohën e flukseve të mjeteve monetare që vijnë nga rreziku jo-financiar ndërsa njësia ekonomike përmbush **kontratat e sigurimit**.

zërat bazë — Zërat që përcaktojnë disa nga shumat e pagueshme tek një **policë mbajtës**. **Zërat bazë** mund të përfshijnë cilindo zë; për shembull, një referim ndaj një portofoli aktivesh, aktivet neto të njësisë ekonomike, ose një nëngrup të caktuar të aktiveve neto të njësisë ekonomike.

Shtojca B
Udhëzim për zbatim

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF 17 Kontratat e sigurimit.

B1 Kjo shtojcë shërben si udhëzues për sa vijon:

(a) përkufizimin e një kontrate sigurimi (shih paragrafët B2–B30);

(b) ndarjen e përbërësve nga një kontratë sigurimi (shih paragrafët B31–B35);

(ba) çdo aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit (shih paragrafin B35A–B35D);

(c) matja (shih paragrafët B36–B119F);

(d) të ardhurat nga sigurimi (shih paragrafët B120–B127);

(e) të ardhurat ose shpenzimet financiare nga sigurimi (shih paragrafët B128–B136); dhe

(f) pasqyrat financiare të ndërmjetme (shih paragrafin B137).

Përkufizimi i një kontrate sigurimi (Shtojca A)

B2 Ky seksion jep udhëzime për përkufizimin e një kontrate sigurimi siç specifikohet në Shtojcën A. Ai trajton çështjet në vijim:

(a) ngjarjet e pasigurta të ardhshme (shih paragrafët B3–B5);

(b) pagesat në natyrë (shih paragrafin B6);

(c) dallimin mes rrezikut të sigurimit dhe rreziqeve të tjera (shih paragrafët B7–B16);

(d) rrezikun e rëndësishëm të sigurimit (shih paragrafët B17–B23);

(e) ndryshimet në nivelin e rrezikut të sigurimit(shih paragrafët B24–B25); dhe

(f) shembuj të kontratave të sigurimit (shih paragrafët B26–B30).

Ngjarja e ardhshme e pasigurt

B3 Pasiguria (ose rreziku) është thelbi i një kontrate sigurimi. Prandaj të paktën një nga çështjet e mëposhtme është e pasigurt në kohën e krijimit të një kontrate sigurimi:

(a) probabiliteti që të ndodhë një ngjarje e siguruar;

(b) kur do të ndodhë një ngjarje e siguruar; ose

(c) sa do të duhet të paguajë njësia ekonomike nëse ndodh ngjarja e siguruar.

B4 Në disa kontrata sigurimi, ngjarja e siguruar është zbulimi i një humbjeje gjatë kohës së kontratës, edhe nëse humbja vjen nga një ngjarje që ka ndodhur para fillimit të kontratës. Në kontrata sigurimi të tjera, ngjarja e siguruar është një ngjarje që ndodh gjatë kohës së kontratës, edhe nëse humbja që vjen zbulohet pas fundit të afatit të kontratës.

B5 Disa kontrata sigurimi mbulojnë ngjarje që kanë ndodhur tashmë, por efekti financiar i të cilave është ende i pasigurt. Një shembull është një kontratë sigurimi e cila ofron mbulim sigurimi ndaj zhvillimeve të pafavorshme të një ngjarjeje që tashmë ka ndodhur. Në kontrata të tilla, ngjarja e siguruar është përcaktimi i kostos së fundit të këtyre kërkesave shtesë.

Pagesat në natyrë

B6 Disa kontrata sigurimi kërkojnë ose lejojnë që pagesat të bëhen në natyrë. Në të tilla raste, njësia ekonomike ofron mallra apo shërbime tek policë mbajtësi për të shlyer detyrimin e njësisë ekonomike për të kompensuar policë mbajtësin për ngjarjet e siguruara. Shembull është rasti i një njësie ekonomike që zëvendëson një artikull të vjedhur në vend që ta rimbursojë policë mbajtësin për shumën e humbjes së pësuar. Një shembull tjetër është kur njësia ekonomike përdor spitalet dhe stafin mjekësor të saj për të dhënë shërbimet mjekësore të mbuluara nga kontratat e sigurimit. Kontrata të tilla janë kontrata sigurimi edhe pse kërkesat shtesë janë shlyer në natyrë. Edhe kontratat e shërbimit me tarifë fikse që plotësojnë kushtet e specifikuara në paragrafin 8 janë kontrata sigurimi, por kur zbaton paragrafin 8, njësia ekonomike

 © Fondacioni i SNRF-ve

mund të zgjedhë t'i trajtojë ato ose duke zbatuar SNRF 17 ose SNRF 15 *Të ardhurat nga kontratat me klientët*.

Dallimi midis rrezikut të sigurimit dhe rreziqeve të tjera

B7 Përkufizimi i një kontrate sigurimi kërkon që një palë të pranojë rreziqe sigurimi të rëndësishme ndaj një pale tjetër. SNRF 17 përkufizon rrezikun e sigurimit si 'rrezik i ndryshëm nga rreziku financiar, i transferuar nga mbajtësi i një kontrate tek emetuesi'. Një kontratë që ekspozon emetuesin ndaj rrezikut financiar pa rrezik të rëndësishëm sigurimi, nuk është një kontratë sigurimi.

B8 Përkufizimi i rrezikut financiar në Shtojcën A përfshin një listë të variablave financiarë dhe jo-financiarë. Kjo listë përfshin variabla jo-financiarë të cilët nuk janë specifikë për një palë të kontratës, të tillë si një indeks i humbjeve nga tërmeti në një rajon të caktuar, ose një indeks i temperaturës në një qytet të caktuar. Rreziku financiar përjashton rrezikun nga variablat jo-financiarë, që janë specifikë për një palë të një kontrate, të tilla si ndodhja ose mos ndodhja e një zjarri, që dëmton ose shkatërron një aktiv të asaj pale. Për më tepër, rreziku i ndryshimeve në vlerën e drejtë të një aktivi jo-financiar nuk është një rrezik financiar, nëse vlera e drejtë pasqyron ndryshimet në çmimet e tregut për aktive të tilla (d.m.th një variabël financiar) dhe kushtin e një aktivi specifik jo-financiar të mbajtur nga një palë në një kontratë (d.m.th një variabël jo-financiar). Për shembull, nëse një garanci e vlerës së mbetur të një makine të caktuar në të cilën policë mbajtësi që ka një interes të siguueshëm, ekspozon garantuesin ndaj rrezikut të ndryshimit të kushteve fizike të makinës, ky rrezik është një rrezik sigurimi dhe jo rrezik financiar.

B9 Disa kontrata e ekspozojnë emetuesin ndaj rrezikut financiar, përveç rrezikut të rëndësishëm të sigurimit. Për shembull, shumë kontrata sigurimi jete garantojnë një normë minimale kthimi për mbajtësit e policës së sigurimit, duke krijuar rrezik financiar dhe premtojnë në të njëjtën kohë përfitime në rast vdekje, të cilat mund të tejkalojnë ndjeshëm tepricën e llogarisë së policë mbajtësit, duke krijuar rrezik sigurimi në formën e rrezikut nga mortaliteti. Kontrata të tilla janë kontrata sigurimi.

B10 Sipas disa kontratave, një ngjarje e siguruar synon pagesën e një shume të lidhur me një indeks çmimi. Kontrata të tilla janë kontrata sigurimi,, nëse pagesa që është e kushtëzuar me ngjarjen e siguruar mund të jetë e rëndësishme. Për shembull, një pagesë vjetore nga siguruesi për sigurimin e jetës, e lidhur me një indeks të kostos së jetesës, transferon rrezik sigurimi sepse pagesa synohet nga një ngjarje e pasigurt në të ardhmen—mbijetesa e përfituesit të policës së sigurimit të jetës. Lidhja me indeksin e çmimit është një derivativ, por gjithashtu transferon një rrezik sigurimi sepse numri i pagesave për të cilat zbatohet indeksi varet nga mbijetesa e përfituesit të një shume të përvitshme. Nëse transferimi që rezulton i rrezikut të sigurimit është i rëndësishëm, derivativi plotëson përkufizimin e një kontrate sigurimi, rast në të cilin ai nuk ka nevojë të veçohet nga kontrata bazë (shih paragrafin 11(a)).

B11 Rreziku i sigurimit është rreziku që njësia ekonomike pranon nga policë mbajtësi. Kjo do të thotë se njësia ekonomike duhet të pranojë, nga policë mbajtësi, një rrezik ndaj të cilit policë mbajtësi është tashmë i ekspozuar. Çdo rrezik i ri i krijuar nga kontrata për njësinë ekonomike ose policë mbajtësin nuk është rrezik sigurimi.

B12 Përkufizimi i një kontrate sigurimi i referohet një efekti negativ mbi policë mbajtësin. Përkufizimi nuk e kufizon pagesën nga njësia ekonomike në një shumë të barabartë me efektin financiar të ngjarjes negative. Për shembull, përkufizimi përfshin mbulimin 'i ri për të vjetrin' të sigurimit që i paguan policë mbajtësit një shumë e cila lejon zëvendësimin e një aktivi të përdorur dhe të dëmtuar me një të ri. Në mënyrë të ngjashme, përkufizimi nuk kufizon pagesën sipas një kontrate të sigurimit të jetës, në humbjen financiare të pësuar nga personat në ngarkim të të larguarit nga jeta, dhe as nuk përjashton kontratat që specifikojnë pagimin e shumave të parapërcaktuara për të caktuar sasinë e humbjes së shkaktuar nga vdekja ose një aksident.

B13 Disa kontrata kërkojnë një pagesë nëse ndodh një ngjarje e pasigurt e caktuar, por nuk kërkojnë një efekt negativ mbi policë mbajtësin si një parakusht për pagesën. Një kontratë e tillë nuk është kontratë sigurimi edhe nëse mbajtësi e përdor kontratën për të zbutur një ekspozim bazë ndaj rrezikut. Për shembull, nëse mbajtësi përdor një derivativ për të mbrojtur një variabël bazë financiar ose jo-financiar, i cili është i lidhur me flukset e mjeteve monetare nga një aktiv i njësisë ekonomike, derivativi nuk është një kontratë sigurimi sepse pagesa nuk kushtëzohet nga fakti që mbajtësi ndikohet negativisht nga një pakësim i flukseve të mjeteve monetare nga aktivi. Përkufizimi i një kontrate sigurimi i referohet një ngjarjeje të pasigurt në të ardhmen, për të cilën një efekt negativ mbi policë mbajtësin është një parakusht kontraktual për pagesën. Parakushti kontraktual nuk kërkon që njësia ekonomike të hetojë nëse ngjarja vërtet ka shkaktuar një efekt negativ, por i lejon njësisë ekonomike të refuzojë pagesën nëse ajo nuk është e bindur se ngjarja ka shkaktuar një efekt negativ.

B14 Rreziku i gabimit ose vazhdimësisë (d.m.th. rreziku që policë mbajtësi do të anulojë kontratën më herët ose më vonë sesa emetuesi kishte parashikuar kur kishte caktuar çmimin e kontratës) nuk është një rrezik sigurimi, sepse ndryshimi që vjen në pagesë ndaj policë mbajtësit nuk kushtëzohet nga një ngjarje e

pasigurt e ardhshme që ndikon negativisht policë mbajtësin. Në mënyrë të ngjashme rreziku i shtrenjtimit (d.m.th. rreziku i rritjes së papritur në kostot administrative të lidhura me shërbimin e një kontrate dhe jo në kostot lidhur me ngjarjet e siguruara) nuk është rrezik sigurimi, sepse një rritje e papritur në shpenzime të tilla nuk ndikon negativisht policë mbajtësin.

B15 Prandaj një kontratë që e ekspozon njësinë ekonomike ndaj rrezikut të gabimit, rrezikut të vazhdimësisë ose rrezikut të shtrenjtimit, nuk është një kontratë sigurimi me përjashtim të rastit kur ajo e ekspozon njësinë ekonomike ndaj rrezikut të sigurimit. Por nëse njësia ekonomike e zbut këtë rrezik duke përdorur një kontratë të dytë për transferimin e një pjese të këtij rreziku jo-sigurimi tek një palë tjetër, kontrata e dytë e ekspozon palën tjetër ndaj rrezikut të sigurimit.

B16 Njësia ekonomike mund të pranojë rrezik të rëndësishëm sigurimi nga policë mbajtësi vetëm nëse ajo është një njësi ekonomike e veçantë nga policë mbajtësi. Në rastin e një njësie ekonomike të përbashkët, i përbashkëti pranon rrezik nga çdo policë mbajtës dhe e grumbullon këtë rrezik. Megjithëse policë mbajtësit mbartin rrezikun e grumbulluar së bashku sepse ata mbajnë interesin e mbetur në njësinë ekonomike, njësia ekonomike e përbashkët është një njësi e veçantë e cila ka pranuar rrezikun.

Rreziku i rëndësishëm i sigurimit

B17 Një kontratë është kontratë sigurimi vetëm nëse ajo transferon rrezik të rëndësishëm sigurimi. Paragrafët B7–B16 trajtojnë rrezikun e sigurimit. Paragrafët B18–B23 trajtojnë vlerësimin e faktit nëse rreziku i sigurimit është i rëndësishëm.

B18 Rreziku i sigurimit është i rëndësishëm nëse dhe vetëm nëse një ngjarje e siguruar mund të shkaktojë që një emetues të paguajë shuma shtesë të cilat janë të rëndësishme në ndonjë situatë të veçantë, me përjashtim të situatave që nuk kanë thelb tregtar (d.m.th. nuk ka efekt të dukshëm në ekonominë e transaksionit). Nëse një ngjarje e siguruar do të nënkuptonte se shuma shtesë të rëndësishme do të ishin të pagueshme në çdo situatë që ka përmbajtje tregtare, kushti në fjalinë e mësipërme mund të plotësohet edhe nëse ngjarja e siguruar ka shumë pak gjasa të ndodhë, ose edhe nëse vlera aktuale e pritshme (d.m.th. probabiliteti i ponderuar) e flukseve të mjeteve monetare të kushtëzuara, është një pjesë e vogël e vlerës aktuale të pritshme të të gjitha flukseve të mbetura kontraktuale nga kontrata e sigurimit.

B19 Gjithashtu një kontratë transferon rrezik sigurimi të rëndësishëm vetëm nëse situata ka thelb tregtar në të cilin emetuesi ka një mundësi humbjeje bazuar në vlerën aktuale. Megjithatë edhe nëse një kontratë risigurimi nuk ekspozon emetuesin ndaj mundësisë së një humbjeje të rëndësishme, kjo kontratë konsiderohet se transferon rrezik sigurimi të rëndësishëm nëse transferon tek risiguruesi në thelb të gjithë rrezikun e sigurimit që lidhet me pjesët e risiguruara të kontratave bazë të sigurimit.

B20 Shumat shtesë të përshkruara në paragrafin B18 përcaktohen bazuar në vlerën e drejtë. Nëse një kontratë sigurimi kërkon pagesën kur ndodh një ngjarje me afat të pasigurt dhe nëse pagesa nuk është rregulluar për vlerën në kohë të parasë, mund të ketë situata në të cilat rritet vlera aktuale e pagesës, edhe pse vlera e saj nominale është e fiksuar. Një shembull është sigurimi që ofron një përfitim fiks në rast vdekje të policë mbajtësit, pa datë skadence për mbulimin (shpesh e referuar si sigurim për gjithë jetën kundrejt një shume fikse). Është e sigurt se policë mbajtësi do të vdesë, por nuk është e sigurt data se kur do të ndodhë. Pagesat mund të bëhen kur një policë mbajtës individual vdes më herët sesa pritet. Duke qenë se pagesat nuk janë rregulluar për vlerën në kohë të parasë, mund të ekzistojë një rrezik i rëndësishëm sigurimi e dhe pse nuk ka një humbje të përgjithshme në portofolin e kontratave. Në mënyrë të ngjashme kushtet kontraktuale që vonojnë rimbursimin në kohë të policë mbajtësit mund të eliminojnë rrezikun e rëndësishëm të sigurimit. Njësia ekonomike do të përdorë normat e skontimit të kërkuara në paragrafin 36 për të përcaktuar vlerën aktuale të shumave shtesë.

B21 Shumat shtesë të përshkruara në paragrafin B18 i referohen vlerës aktuale të shumave që tejkalojnë ato që mund të jenë të pagueshme, nëse nuk do të ndodhte ngjarja e siguruar(duke përjashtuar situatat që nuk kanë përmbajtje tregtare). Këto shuma shtesë përfshijnë kostot e trajtimit dhe të vlerësimit të kërkesave shtesë, por përjashtojnë:

(a) humbjen e aftësisë për t`i ngarkuar policë mbajtësit për shërbimet e ardhshme. Për shembull, në një kontratë sigurimi jete, të lidhur me investime, vdekja e policë mbajtësit do të thotë se njësia ekonomike nuk mund të vazhdojë të kryejë shërbimet e menaxhimit të investimit dhe të grumbullimit të një komisioni për të bërë këtë. Megjithatë, kjo humbje ekonomike për njësinë ekonomike nuk pasqyron rrezikun e sigurimit, njëlloj sikur një menaxher i fondeve të përbashkëta nuk ndërmerr rrezik sigurimi lidhur me vdekjen e mundshme të një klienti. Për pasojë humbja e mundshme e komisioneve të ardhshme të menaxhimit të investimeve nuk është e rëndësishme në vlerësimin se sa shumë rrezik sigurimi transferohet nga një kontratë.

(b) heqjen dorë, me vdekjen, nga detyrimet që mund të ishin bërë në anulim ose dorëzim. Për shkak se kontrata solli krijimin e këtyre detyrimeve, heqja dorë nga këto detyrime nuk kompenson

 © Fondacioni i SNRF-ve

policë mbajtësin për një rrezik para-ekzistues. Për pasojë ato nuk janë të rëndësishme në vlerësimin sesa rrezik sigurimi transferohet nga një kontratë.

(c) një pagesë e kushtëzuar në një ngjarje e cila nuk i shkakton një humbje të rëndësishme mbajtësit të kontratës. Për shembull, shqyrtojmë një kontratë, e cila kërkon që emetuesi të paguajë 1 milion NJM[1] nëse një aktiv pëson një dëmtim fizik duke i shkaktuar mbajtësit një humbje të parëndësishme ekonomike prej 1NJM. Në këtë kontratë mbajtësi transferon rrezikun e parëndësishëm nga humbja e 1NJM tek emetuesi. Në të njëjtën kohë, kontrata krijon rrezik jo-sigurimi, që emetuesi do të duhet të paguajë 999,999 NJM nëse ndodh ngjarja e specifikuar. Duke qenë se nuk ka situata ku ngjarja e siguruar shkakton një humbje të rëndësishme tek mbajtësi i kontratës, emetuesi nuk pranon rrezik të rëndësishëm sigurimi nga mbajtësi dhe kjo kontratë nuk është një kontratë sigurimi.

(d) rikuperime të mundshme të ri sigurimit. Njësia ekonomike i trajton këto veçmas.

B22 Njësia ekonomike do të vlerësojë rëndësinë e rrezikut të sigurimit kontratë pas kontrate. Prandaj rreziku i sigurimit mund të jetë i rëndësishëm edhe nëse ka një probabilitet minimal të humbjeve të rëndësishme për një portofol ose grup kontratash.

B23 Nga paragrafët B18–B22 vijon se nëse një kontratë paguan një përfitim për vdekje, që tejkalon shumën e pagueshme në mbijetesë, kontrata është një kontratë sigurimi me përjashtim të rastit kur përfitimi shtesë për vdekjen është i parëndësishëm (i gjykuar duke i'u referuar kontratës specifike dhe jo një portofoli të tërë kontratash). Siç vihet në dukje në paragrafin B21(b), me vdekjen, heqja dorë nga anulimi ose dorëzimi i detyrimit nuk përfshihet në këtë vlerësim, nëse kjo heqje dorë nuk kompenson policë mbajtësin për një rrezik para-ekzistues. Në mënyrë të ngjashme një kontratë e përvitshme që paguan shuma të rregullta për jetën e mbetur të policë mbajtësit është një kontratë sigurimi, me përjashtim të rastit kur pagesat e bashkuara të kushtëzuara për sigurimin e jetës janë të parëndësishme.

Ndryshimet në nivelin e rrezikut të sigurimit

B24 Për disa kontrata, transferimi i rrezikut të sigurimit tek emetuesi ndodh pas një periudhe kohe. Për shembull, shqyrtojmë një kontratë që siguron një kthim të caktuar nga investimi dhe përfshin një opsion për policë mbajtësin për të përdorur të ardhurat e investimit në maturim, për të blerë një kontratë sigurimi të përvitshme jete të kushtëzuar me të njëjtat norma që njësia ekonomike ngarkon përfituesit e rinj të një shumë të përvitshme në kohën që policë mbajtësi ushtron opsionin. Një kontratë e tillë nuk transferon rrezik sigurimi tek emetuesi derisa të ushtrohet opsioni, për shkak se njësia ekonomike është e lirë të çmojë të përvitshmen mbi një bazë që pasqyron rrezikun e sigurimit që do të transferohet tek njësia në atë kohë. Për pasojë flukset monetare që do të ndodhin me ushtrimin e opsionit do të jenë jashtë kufijve të kontratës dhe para ushtrimit nuk ka flukse monetare sigurimi brenda kufijve të kontratës. Megjithatë nëse kontrata specifikon normat vjetore (ose një bazë tjetër e ndryshme nga normat e tregut për vendosjen e normave vjetore), kontrata transferon rrezik të rëndësishëm tek emetuesi sepse ky i fundit është i ekspozuar ndaj rrezikut që normat vjetore do të jenë jo të favorshme për të nëse policë mbajtësi ushtron opsionin. Në këtë rast flukset monetare që do të ndodhin kur të ushtrohet opsioni janë brenda kufijve të kontratës.

B25 Kontrata që plotëson përkufizimin e një kontrate sigurimi mbetet një kontratë sigurimi derisa të shuhen të gjitha të drejtat dhe detyrimet (d.m.th shkarkohen, anulohen ose skadojnë), me përjashtim të rastit kur kontrata çregjistrohet duke zbatuar paragrafët 74–77, për shkak të një modifikimi kontrate.

Shembuj të kontratave të sigurimit

B26 Në vijim jepen shembuj kontratash që janë kontrata sigurimi, në rast se transferimi i rrezikut të sigurimit është i rëndësishëm:

(a) sigurimi ndaj vjedhjes ose dëmtimit të pronës.

(b) sigurimi ndaj detyrimit për produktin, detyrimit profesional, detyrimit civil ose shpenzimeve ligjore.

(c) sigurimi i jetës dhe skemat e parapagimit të funeralit (megjithëse vdekja është e sigurt, nuk është e sigurt se kur ajo do të ndodhë, ose për disa tipe sigurimi jete, nëse vdekja do të ndodhë brenda periudhës së mbuluar nga sigurimi).

(d) pagesat vjetore të lidhura me sigurimin e jetës dhe pensionet, d.m.th. kontratat që sigurojnë kompensim për ngjarjen e ardhshme të pasigurt—mbijetesën e përfituesit ose pensionistit—për të ndihmuar përfituesin ose pensionistin në mbajtjen e një standardi të caktuar jetese, i cili në kushte

[1] NJM nënkupton njësi monetare.

të tjera do të ndikohej negativisht nga mbijetesa e tij. (Detyrimet e punëdhënësit që vijnë nga skemat e përfitimeve të punonjësve dhe detyrimet për përfitim të pensioneve të raportuara sipas skemave të përfitimeve të përcaktuara të pensioneve janë jashtë objektit të SNRF 17, duke zbatuar paragrafin 7(b)).

(e) sigurimi ndaj paaftësisë dhe kostove mjekësore.

(f) obligacione sigurie, obligacione besnikërie, obligacione performance dhe obligacione oferte, d.m.th kontrata që kompensojnë mbajtësin nëse pala tjetër dështon në kryerjen e detyrimit kontraktual; për shembull një detyrim për të ndërtuar një ndërtesë.

(g) garancitë e produkteve. Garancitë e produkteve të lëshuara nga një palë tjetër për mallra të shitura nga një prodhues, ndërmjetës ose shitës me pakicë, janë brenda objektit të SNRF 17. Megjithatë garancitë e produkteve të lëshuara drejtpërdrejt nga një prodhues, ndërmjetës ose shitës me pakicë janë jashtë objektit të SRNF 17 duke zbatuar paragrafin 7(a) dhe janë në fakt brenda objektit të SNRF 15 ose SNK 37 *Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara*.

(h) sigurimi i titujve (d.m.th sigurimi ndaj zbulimit të defekteve në tituj te tokës ose ndërtesave, të cilat nuk ishin të dukshme kur u nënshkrua kontrata e sigurimit). Në këtë rast ngjarje e siguruar është zbulimi i një defekti në titull, jo defekti në vetvete.

(i) sigurimi në udhëtim (kompensimi në mjete monetare ose në natyrë i policë mbajtësit për humbjet e pësuara në avancë ose gjatë udhëtimit).

(j) obligacionet e katastrofës, të cilat ofrojnë pagesa të zvogëluara të kryegjësë, interesit ose të dyjave, nëse një ngjarje e caktuar ndikon negativisht emetuesin e obligacionit (me përjashtim të rastit kur ngjarja e caktuar nuk krijon rrezik sigurimi të rëndësishëm; për shembull, nëse ngjarja është një ndryshim në një normë interesi ose në një normë të kurseve të këmbimit).

(k) kontratat e sigurimit swaps dhe kontrata të tjera që kërkojnë një pagesë bazuar në ndryshimet në variablat klimaterikë, gjeologjikë ose variabla të tjerë fizikë, të cilat janë specifikë për një palë në kontratë.

B27 Në vijim jepen shembuj të zërave që nuk janë kontrata sigurimi:

(a) kontratat e investimit të cilat kanë formën ligjore të një kontrate sigurimi por që nuk transferojnë rreziqe të rëndësishme sigurimit tek emetuesi. Për shembull kontratat e sigurimit të jetës në të cilat njësia ekonomike mbart rreziqe jo të rëndësishme vdekshmërie ose sëmundshmërie nuk janë kontrata sigurimi; kontrata të tilla janë instrumenta financiarë ose kontrata shërbimi—shih paragrafin B28. Kontratat e investimit me tipare të pjesëmarrjes së lirë nuk plotësojnë përkufizimin e një kontrate sigurimi; megjithatë ato janë brenda objektit të SNRF 17 nëse janë emetuar nga një njësi ekonomike që emeton edhe kontratat e sigurimit, duke zbatuar paragrafin 3(c).

(b) kontratat që kanë formën ligjore të sigurimit, por kthejnë të gjitha rreziqet e rëndësishme të sigurimit tek policë mbajtësi përmes mekanizmave jo-të anulueshëm dhe detyrues që rregullojnë pagesat e ardhshme nga policë mbajtësi tek emetuesi si rezultat i drejtpërdrejtë i humbjeve të siguruara. Për shembull disa kontrata risigurimi financiare ose disa grupe kontratash kthejnë të gjithë rrezikun e rëndësishëm të sigurimit tek policë mbajtësi; kontrata të tilla janë zakonisht instrumenta financiarë ose kontrata shërbimi (shih paragrafin B28).

(c) vetë-sigurimi (d.m.th mbajtja e një rreziku që mund të ishte mbuluar nga sigurimi). Në të tilla situata, nuk ka një kontratë sigurimi pasi nuk ka një marrëveshje me një palë tjetër. Prandaj nëse një njësi ekonomike emeton një kontratë sigurimi për mëmën e vet, një filial ose një nën-filial nuk kemi një kontratë sigurimi në pasqyrat financiare të konsoliduara, sepse nuk ka kontratë me një palë tjetër. Megjithatë, në pasqyrat financiare individuale të emetuesit ose të mbajtësit ka një kontratë sigurimi.

(d) kontratat (të tilla si kontratat e lojërave të fatit) që kërkojnë një pagesë nëse ndodh një ngjarje e pasigurt e caktuar, por nuk kërkojnë që ngjarja të ndikojë negativisht policë mbajtësin si një parakusht për pagesën. Megjithatë kjo nuk përjashton nga përkufizimi i një kontrate sigurimi, kontratat që specifikojnë një pagesë të paracaktuar për të përcaktuar në mënyrë sasiore humbjen e shkaktuar nga një ngjarje e caktuar e tillë si, vdekja ose një aksident (shih paragrafin B12).

(e) derivativët që ekspozojnë një palë ndaj rrezikut financiar por jo ndaj rrezikut të sigurimit, sepse ata kërkojnë që pala të bëjë (ose t'u japë atyre të drejtën për të marrë) pagesa bazuar vetëm në ndryshimet në një ose më shumë tregues si, norma interesi të caktuara, çmimi i instrumenteve financiarë, çmimi i mallrave, norma e kurseve të këmbimit, indeksi i çmimeve ose normave, klasifikimi i kredisë ose indeksi i kredisë apo tregues të tjerë, nëse në rastin e një treguesi jo-financiar ky variabël nuk është specifik për një palë të kontratës.

 © Fondacioni i SNRF-ve

(f) garancitë e lidhura me kredinë që kërkojnë pagesa edhe nëse mbajtësi nuk ka pësuar një humbje nga mos bërja e pagesave në kohën e duhur nga ana e debitorit; kontrata të tilla trajtohen duke zbatuar SNRF 9 *Instrumentet financiarë* (shih paragrafin B29).

(g) kontrata që kërkojnë një pagesë bazuar në ndryshimet në variablat klimaterikë, gjeologjikë ose variabla të tjerë fizikë, të cilët nuk janë specifikë për një palë në kontratë (zakonisht të përshkruara si derivativë të motit).

(h) obligacionet që ofrojnë pagesa të pakësuara të principalit, interesit ose të dyjave, bazuar në një variabël klimaterik, gjeologjik ose variabël tjetër fizik, i cili nuk është specifik për një palë të kontratës (zakonisht të referuar si obligacione për katastrofa).

B28 Njësia ekonomike do të zbatojë Standardet e tjera të zbatueshme, të tillë si SNRF 9 dhe SNRF 15 për kontratat e përshkruara në paragrafin B27.

B29 Garancitë e lidhura me kreditë dhe kontratat e sigurimit të kredisë të trajtuara në paragrafin B27(f) mund të kenë forma ligjore të ndryshme, të tilla si një garanci, disa lloje letër kredie, një kontratë kredie derivative e mospagimit ose një kontratë sigurimi. Këto kontrata janë kontrata sigurimi nëse ato kërkojnë që emetuesi të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që pëson për shkak se një debitor i caktuar nuk bën pagesat tek policë mbajtësi kur ato kërkohen në përputhje me termat fillestare ose të modifikuara të një instrumenti borxhi. Por kontrata të tilla sigurimi përjashtohen nga objekti i SNRF 17 përveç rastit kur emetuesi ka shprehur më parë në mënyrë të qartë se ai i sheh kontratat si kontrata sigurimi dhe ka përdorur trajtimin kontabël të zbatueshëm për kontratat e sigurimit (shih paragrafin 7(e)).

B30 Garancitë e lidhura me kreditë dhe kontratat e sigurimit të kredisë që kërkojnë pagesën edhe nëse policë mbajtësi nuk ka pësuar humbje për shkak se debitori nuk bën pagesat kur ato kërkohen, janë jashtë objektit të SNRF 17, sepse ato nuk transferojnë rrezik të rëndësishëm sigurimi. Kontrata të tilla përfshijnë ato që kërkojnë pagesën:

(a) pavarësisht nëse pala tjetër mban instrumentin bazë të borxhit; ose

(b) bazuar në ndryshimin e klasifikimit të kredisë ose indeksit të kredisë dhe për shkak se një debitor i caktuar nuk arrin të bëjë pagesat kur ato kërkohen.

Ndarja e përbërësve nga një kontratë sigurimi (paragrafët 10–13)

Përbërës investimi(paragrafi 11(b))

B31 Paragrafi 11(b) kërkon që njësia ekonomike të veçojë një përbërës investimi të dallueshëm nga kontrata e sigurimit bazë. Një përbërës investimi është i dallueshëm nëse dhe vetëm nëse, plotësohen njëkohësisht të dy kushtet vijuese:

(a) përbërësi investim dhe përbërësi sigurim nuk janë shumë të ndërlidhur.

(b) një kontratë me kushte ekuivalente shitet ose mund të shitet veçmas në të njëjtin treg ose në të njëjtin juridiksion, ose nga njësitë ekonomike që emetojnë kontratat e sigurimit ose nga palët e tjera. Kur bën këtë përcaktim, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe disponibël. Nuk kërkohet që njësia ekonomike të bëjë një kërkim shterues për të identifikuar nëse një përbërës investimi shitet veçmas.

B32 Një përbërës investimi dhe një përbërës sigurimi janë shumë të ndërlidhur nëse dhe vetëm nëse:

(a) njësia ekonomike nuk është në gjendje të masë një përbërës pas marrë në konsideratë edhe tjetrin. Prandaj nëse vlera e një përbërësi ndryshon sipas vlerës së tjetrit, njësia ekonomike do të zbatojë SNRF 17 për të trajtuar investimin e kombinuar dhe përbërësin sigurim; ose

(b) policë mbajtësi nuk është në gjendje të përfitojë nga një përbërës derisa bëhet i pranishëm edhe përbërësi tjetër. Prandaj nëse kalimi ose maturimi i një përbërësi të kontratës shkakton kalimin ose maturimin e tjetrit, njësia ekonomike do të zbatojë SNRF 17 për të trajtuar investimin e kombinuar dhe përbërësin sigurim.

Premtimet për të transferuar mallra ose shërbime të dallueshme të ndryshme nga shërbimet e kontratës së sigurimit (paragrafi 12)

B33 Paragrafi 12 kërkon që njësia ekonomike të veçojë nga kontrata e sigurimit premtimin për të transferuar mallra ose shërbime të dallueshme të ndryshme nga shërbimet e kontratës së sigurimit tek një policë mbajtës Me qëllim veçimin, njësia ekonomike nuk do të marrë në konsideratë aktivitetet që ajo duhet të

ndërmarrë për të përmbushur kontratën me përjashtim të rastit kur njësia ekonomike transferon një mall ose shërbim të ndryshëm nga shërbimet e kontratës së sigurimit tek policë mbajtësi ndërsa ndodhin këto aktivitete. Për shembull, njësia ekonomike mund të duhet të kryejë detyra të ndryshme administrative për të lidhur një kontratë. Realizimi i këtyre detyrave nuk transferon një shërbim tek policë mbajtësi, ndërsa kryhen detyrat.

B34 Një mall ose një shërbim i ndryshëm nga një shërbim i kontratës së sigurimit i premtuar tek një policë mbajtës është i dallueshëm nëse policë mbajtësi mund të përfitojë ose nga vetë malli apo shërbimi ose së bashku me burimet e tjera të gatshme për t'u përdorur nga policë mbajtësi. Burime të gatshme për t'u përdorur janë mallrat apo shërbimet të cilat janë shitur veçmas (nga njësia ekonomike ose njësi të tjera) ose burime, të cilat policë mbajtësi tashmë i ka marrë (nga njësia ekonomike ose nga transaksione apo ngjarje të tjera).

B35 Një mall apo shërbim i ndryshëm nga një shërbim kontrate sigurimi i premtuar tek një policë mbajtës nuk është i dallueshëm nëse:

(a) flukset monetare dhe rreziqet e lidhura me mallin ose shërbimin janë shumë të ndërlidhura me flukset monetare dhe rreziqet e lidhura me përbërësit sigurim në kontratë; dhe

(b) njësia ekonomike ofron një shërbim të rëndësishëm në integrimin e mallit ose shërbimit me përbërësit sigurim.

Flukset e mjeteve monetare të blerjes së sigurimit(shih paragrafin 28A–28F)

B35A Për të zbatuar paragrafin 28A, njësia ekonomike do të përdorë një metodë sistematike dhe racionale për të shpërndarë:

(a) flukset monetare të blerjes së sigurimit të ngarkueshme drejtpërdrejtë tek një grup kontratash sigurimi:

(i) ndaj atij grupi; dhe

(ii) ndaj grupeve që do të përfshijnë kontratat e sigurimit, të cilat priten të dalin nga rinovimi i kontratave të sigurimit në atë grup.

(b) flukset monetare të blerjes së sigurimit të ngarkueshme drejtpërdrejtë tek një portofol i kontratave të sigurimit, të ndryshme nga ato në pikën (a), tek grupet e kontratave në portofol.

B35B Në fund të çdo periudhe raportuese, njësia ekonomike do të rishikojë shumat e shpërndara siç specifikohet në paragrafin B35A për të pasqyruar çdo ndryshim në supozimet që përcaktojnë të dhënat bazë (inputet) të metodës së shpërndarjes të përdorur. Njësia ekonomike nuk do të ndryshojë shumat e shpërndara tek një grup i kontratave të sigurimit pasi të gjitha kontratat të jenë shtuar në grup (shih paragrafin B35C).

B35C Njësia ekonomike mund të shtojë kontrata sigurimi në një grup kontratash sigurimi përgjatë më shumë se një periudhe raportimi (shih paragrafin 28). Në të tilla rrethana, njësia ekonomike do të çregjistrojë (mos njohë) pjesën e aktivit për flukset monetare të blerjes së sigurimit që lidhet me kontratat e sigurimit të shtuara në grup në atë periudhë dhe do të vazhdojë të njohë një aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit në masën që aktivi lidhet me kontratat e sigurimit që priten të shtohen në grup në një periudhë raportuese të ardhshme.

B35D Për të zbatuar paragrafin 28E:

(a) njësia ekonomike do të njohë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje dhe do të pakësojë vlerën kontabël (neto) të një aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit në mënyrë që vlera kontabël (neto) e aktivit nuk tejkalon flukset monetare neto të pritshme të grupit përkatës të kontratave të sigurimit, të përcaktuar duke zbatuar paragrafin 32(a).

(b) kur njësia ekonomike shpërndan flukset monetare të blerjes së sigurimit tek grupet e kontratave të sigurimit duke zbatuar paragrafin B35A(a)(ii), njësia ekonomike do të njohë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje dhe do të pakësojë vlerën kontabël (neto) të aktiveve përkatëse për flukset monetare të blerjes së sigurimit në masën që:

(i) njësia ekonomike pret që këto flukse monetare të blerjes së sigurimit të tejkalojnë flukset hyrëse monetare për rinovimet e pritshme të përcaktuara duke zbatuar paragrafin 32(a); dhe

(ii) teprica e përcaktuar duke zbatuar pikën (b)(i) nuk është njohur ende si një humbje nga zhvlerësimi duke zbatuar pikën (a).

 © Fondacioni i SNRF-ve

Matja (paragrafët 29–71)

Vlerësimet e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare(paragrafët 33–35)

B36 Ky seksion trajton:

(a) përdorimin e paanshëm të të gjithë informacionit të arsyeshëm dhe mbështetës në dispozicion pa kosto apo përpjekje të papërshtatshme (shih paragrafët B37–B41);

(b) variablat e tregut dhe jo-të tregut (shih paragrafët B42–B53);

(c) përdorimin e vlerësimeve aktuale (shih paragrafët B54–B60); dhe

(d) flukset monetare brenda kufijve të kontratës (shih paragrafët B61–B71).

Përdorimi i paanshëm i të gjithë informacionit të arsyeshëm dhe mbështetës në dispozicion pa kosto apo përpjekje të papërshtatshme(paragrafi 33(a))

B37 Objektivi i vlerësimit të flukseve monetare të ardhshme është që të përcaktohet vlera e pritshme ose mesatarja e ponderuar për probabilitetin e një game të gjerë rezultatesh të mundshme, duke marrë në konsideratë të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe mbështetës në dispozicion në datën e raportimit pa kosto apo përpjekje të papërshtatshme. Informacioni i arsyeshëm dhe mbështetës në dispozicion në datën e raportimit pa kosto apo përpjekje të papërshtatshme, përfshin informacionin rreth ngjarjeve të shkuara dhe kushteve aktuale, si dhe parashikime për kushtet e ardhshme (shih paragrafin B41). Informacioni që është në dispozicion nga sistemi i informacionit të vetë njësisë ekonomike konsiderohet të jetë në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme.

B38 Pikënisja për vlerësimin e flukseve monetare është një grup situatash që pasqyron gamën e gjerë të rezultateve të mundshme. Secila prej situatave specifikon shumën dhe kohën e flukseve monetare për një rezultat të caktuar, si dhe vlerëson probabilitetin e ndodhjes së atij rezultati. Flukset e mjeteve monetare nga secila situatë skontohen dhe ponderohen me probabilitetin e vlerësuar të atij rezultati për të nxjerrë vlerën aktuale të pritshme. Për pasojë, objektivi nuk është që të zhvillohet rezultati më i mundshëm apo rezultati më i mundshëm-sesa-jo-i mundshëm, për flukse mjetesh monetare të ardhshme.

B39 Kur merret në shqyrtim gama e gjerë e rezultateve të mundshme, objektivi është që të përfshihet i gjithë informacioni i arsyeshëm dhe mbështetës në dispozicion pa kosto apo përpjekje të papërshtatshme, sesa të identifikohen të gjitha situatat e mundshme. Në praktikë, zhvillimi i situatave të qarta është i panevojshëm nëse vlerësimi që rezulton kur përcaktohet mesatarja është në përputhje me objektivin e matjes duke marrë parasysh të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe mbështetës në dispozicion pa kosto apo përpjekje të papërshtatshme. Për shembull, nëse njësia ekonomike vlerëson se shpërndarja probabilitare e rezultateve është kryesisht në përputhje me shpërndarjen probabilitare që mund të përcaktohet plotësisht me një numër të vogël parametrash, është e mjaftueshme që të vlerësohet ky numër i vogël parametrash. Në mënyrë të ngjashme, në disa raste, modelimi relativisht i thjeshtë mund të japë një përgjigje brenda një zone të pranueshme saktësie, pa pasur nevojë për shumë simulime të detajuara. Por në disa raste, flukset monetare mund të influencohen nga faktorë bazë të ndërlikuar dhe mund t'u përgjigjen ndryshimeve në kushtet ekonomike në mënyrë jo-lineare. Kjo mund të ndodhë, për shembull, kur flukset monetare pasqyrojnë një seri opsionesh të ndërlidhura që janë të shprehura qartë ose të nënkuptuara. Në të tilla raste, për të plotësuar objektivin e matjes ka shumë gjasa që të jenë të nevojshme modele vlerësimi më të sofistikuar.

B40 Situatat e zhvilluara do të përfshijnë vlerësime të paanshme të probabilitetit të humbjeve katastrofike sipas kontratave ekzistuese. Këto situata nuk përfshijnë kërkesat shtesë sipas kontratave të ardhshme të mundshme.

B41 Njësia ekonomike do të vlerësojë probabilitetin dhe shumat e pagesave të ardhshme sipas kontratave ekzistuese mbi bazën e informacionit të marrë duke përfshirë:

(a) informacion rreth kërkesave shtesë tashmë të raportuara nga policë mbajtësi.

(b) informacion tjetër rreth karakteristikave të njohura ose të vlerësuara të kontratave të sigurimit.

(c) të dhëna historike rreth eksperiencës së vetë njësisë ekonomike, të shoqëruar kur është e nevojshme me të dhëna historike nga burime të tjera. Të dhënat historike rregullohen për të pasqyruara kushtet aktuale nëse për shembull:

(i) ndryshojnë karakteristikat e popullatës së siguruar (ose do të ndryshojnë, për shembull për shkak të një zgjedhjeje me efekt negativ) nga ato të popullatës që ka qenë përdorur si bazë për të dhënat historike;

(ii) ka tregues se nuk do të vazhdojë kjo prirje historike, se do të krijohen prirje të reja ose se ndryshimet ekonomike, demografike apo të tjera mund të ndikojnë flukset monetare që vijnë nga kontratat ekzistuese të sigurimit; ose

(iii) ka pasur ndryshime në zërat si procedurat e nënshkrimit dhe procedurat e menaxhimit të kërkesave shtesë të cilat mund të ndikojnë rëndësinë e të dhënave historike në kontratat e sigurimit.

(d) informacion mbi çmimet aktuale, nëse ka, për kontratat e risigurimit dhe instrumenta financiarë të tjerë (nëse ka) që mbulojnë rreziqe të ngjashme, të tilla si obligacione për katastrofa dhe instrumenta derivativë të lidhur me motin, si dhe çmimet më të fundit të tregut për transferimin e kontratave të sigurimit. Ky informacion do të rregullohet për të pasqyruar diferencën mes flukseve monetare që vijnë nga këto kontrata risigurimi ose instrumenta financiarë të tjerë dhe flukseve monetare që do të vinin ndërsa njësia ekonomike përmbush kontratat bazë me policë mbajtësin.

Variablat e tregut dhe jo-të tregut

B42 SNRF 17 identifikon dy tipe variablash:

(a) variabla të tregut—variabla të cilët mund të vrojtohen në treg ose të nxirren drejtpërdrejt prej tij (për shembull, çmimet e letrave me vlerë të tregtueshme dhe normat e interesit); dhe

(b) variablat jo-të tregut—të gjithë variablat e tjerë (për shembull, frekuenca dhe ashpërsia e kërkesave shtesë të sigurimit dhe vdekshmëria).

B43 Zakonisht, variablat e tregut sjellin rrezik financiar(për shembull normat e interesit të vrojtueshme) dhe variablat jo-të tregut sjellin rrezik jo-financiar (për shembull, niveli i vdekshmërisë). Megjithatë jo gjithmonë ndodh kështu. Për shembull, mund të ketë supozime të cilat lidhen me rreziqet financiare për të cilat variablat nuk mund të vrojtohen ose të nxirren drejtpërdrejt nga tregu (për shembull, normat e interesit që nuk mund të vrojtohen ose nxirren drejtpërdrejt nga tregjet).

Variablat e tregut (paragrafi33(b))

B44 Vlerësimet e variablave të tregut do të jenë në përputhje me çmimet në tregjet e mbikëqyrura në datën e matjes. Njësia ekonomike do të maksimizojë përdorimin e inputeve të verifikueshme dhe nuk do të zëvendësojë vlerësimet e saj për të dhënat e vrojtueshme në treg me përjashtim të sa përshkruhet në paragrafin 79 të SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*. Në pajtim me SNRF 13, nëse variablat duhet të nxirren (për shembull sepse nuk ekzistojnë variabla në tregjet e mbikëqyrura) ato do të jenë për sa është e mundur në përputhje me variablat në tregjet e mbikëqyrura.

B45 Çmimet e tregut përziejnë një gamë këndvështrimesh rreth rezultateve të mundshme të ardhshme dhe pasqyrojnë gjithashtu preferencat për rrezikun të pjesëmarrësve në treg. Për pasojë ata nuk janë një parashikim në një pikë të vetme i rezultateve të ardhshme. Nëse rezultati aktual ndryshon nga çmimi i mëparshëm në treg, kjo nuk do të thotë se çmimi i tregut ishte i 'gabuar'.

B46 Një zbatim i rëndësishëm i variablave të tregut është nocioni i rikrijimit njëlloj të aktivit ose i rikrijimit njëlloj të portofolit të aktiveve. Një aktiv i rikrijuar njëlloj është ai aktiv flukset monetare të të cilit përputhen *ekzaktësisht* në të gjitha situatat, me flukset monetare të kontraktuara të një grupi kontratash sigurimi në shumë, kohë dhe pasiguri. Në disa raste, një aktiv i rikrijuar njëlloj mund të ekzistojë për disa prej flukseve monetare që vijnë nga një grup i kontratave të sigurimit. Vlera e drejtë e atij aktivi pasqyron vlerën aktuale të pritshme të flukseve monetare nga aktivi si edhe rrezikun e lidhur me ato flukse monetare. Nëse, një portofol i rikrijuar njëlloj ekziston për disa prej flukseve monetare që vijnë nga një grup i kontratave të sigurimit, njësia ekonomike mund të përdorë vlerën e drejtë të atyre aktiveve për të matur fluksin monetar të realizuar përkatëse në vend të vlerësimit të qartë të flukseve monetare dhe normës së skontimit.

B47 SNRF 17 nuk kërkon që njësia ekonomike të përdorë teknikën e rikrijimit njëlloj të portofolit. Megjithatë nëse një aktiv ose portofol i rikrijuar njëlloj ekziston për disa prej flukseve monetare që vijnë nga kontratat e sigurimit dhe njësia ekonomike zgjedh të përdorë një teknikë tjetër, njësia ekonomike mund të jetë e qetë sepse teknika e rikrijimit njëlloj të portofolit ka pak gjasa që të rezultojë në një matje të ndryshme materiale për ato flukse monetare.

B48 Teknikat e ndryshme nga teknika e rikrijimit njëlloj të portofolit, të tilla si teknikat e modelimit stokastik (parashikues), mund të jenë më të vështira ose më të lehta për t'u zbatuar nëse ka ndër varësi të rëndësishme mes flukseve monetare që ndryshojnë bazuar në kthimet nga aktivet dhe flukseve të tjera monetare. Nevojitet gjykimi, për të përcaktuar teknikën që plotëson më mirë objektivin e qëndrueshmërisë me variablat e tregjeve të mbikëqyrura në rrethana specifike. Veçanërisht teknika e përdorur duhet të sjellë

 © Fondacioni i SNRF-ve

matjen e çdo opsioni dhe garancie të përfshirë në kontratat e sigurimit,në përputhje me çmimet në tregjet e mbikëqyrura (nëse ka) për opsione dhe garanci të tilla.

Variablat jo-të tregut

B49 Vlerësimet e variablave jo-të tregut do të pasqyrojnë të gjithë evidencën e arsyeshme dhe mbështetëse në dispozicion pa kosto apo përpjekje të papërshtatshme, të brendshme dhe të jashtme.

B50 Të dhënat e jashtme jo-të tregut (për shembull, statistikat kombëtare të vdekshmërisë) mund të kenë më shumë ose më pak rëndësi se të dhënat e brendshme (për shembull, statistikat mbi vdekshmërinë të zhvilluar nga vetë njësia), në varësi të rrethanave. Për shembull, njësia ekonomike që emeton kontrata të sigurimit të jetës nuk do të mbështetet vetëm në statistikat kombëtare të vdekshmërisë, por do të marrë në konsideratë dhe gjithë informacionin e arsyeshëm dhe mbështetës në dispozicion nga burime të brendshme dhe të jashtme pa kosto apo përpjekje të papërshtatshme, kur zhvillon vlerësime të paanshme rreth probabilitetit të situatave të vdekshmërisë për kontratat e saj të sigurimit. Gjatë zhvillimit të këtyre probabiliteteve, njësia ekonomike do t'i japë më shumë rëndësi informacionit më bindës. Për shembull:

(a) statistikat e brendshme mbi vdekshmërinë mund të jenë më bindëse sesa të dhënat kombëtare mbi vdekshmërinë nëse të dhënat kombëtare janë nxjerrë nga një popullatë e gjerë që nuk është përfaqësuese e popullatës së siguruar. Kjo sepse, për shembull, karakteristikat demografike të popullatës së siguruar mund të ndryshojnë shumë nga ato të popullatës kombëtare, që do të thotë se një njësi ekonomike do të ketë nevojë t'i japë më shumë rëndësi të dhënave të brendshme dhe më pak rëndësi statistikave kombëtare.

(b) anasjelltas, nëse statistikat e brendshme janë nxjerrë nga një popullatë e vogël me karakteristika që besohet se janë të ngjashme me ato të popullatës kombëtare, si dhe statistikat kombëtare janë aktuale, njësia ekonomike do t'i japë më shumë rëndësi statistikave kombëtare.

B51 Probabilitetet e vlerësuara për variablat jo-të tregut nuk do të jenë në kontradiktë me variablat e tregjeve të mbikëqyrura. Për shembull, probabilitetet e vlerësuara për situatat lidhur me normat e ardhshme të inflacionit do të jenë në përputhje, sa më shumë që të jetë e mundur, me probabilitetet e nënkuptuara të normave të interesit të tregut.

B52 Në disa raste njësia ekonomike mund të dalë në konkluzionin se variablat e tregut ndryshojnë pavarësisht nga variablat jo-të tregut. Në këtë rast, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë situatat që pasqyrojnë gamën e rezultateve për variablat jo-të tregut, ku secila situatë përdor të njëjtat vlera të vrojtuara të variablave të tregut.

B53 Në raste të tjera, variablat e tregut dhe jo-të tregut mund të jenë të lidhur. Për shembull, evidenca mund të tregojë se normat e kalimit (një variabël jo-tregu) janë të lidhura me normat e interesit (një variabël tregu). Në mënyrë të ngjashme, evidenca mund të tregojë se nivelet e kërkesave shtesë për sigurimin e shtëpisë ose makinës janë të lidhura me ciklin ekonomik dhe për pasojë me normat e interesit dhe shumat e shpenzimeve. Njësia ekonomike do të sigurohet që probabilitetet e situatave dhe rregullimet për rreziqet jo-financiare të lidhura me variablat e tregut, të jenë në përputhje me çmimet në tregun e mbikëqyrur që varen në ato variabla tregu.

Përdorimi i vlerësimeve aktuale (paragrafi 33(c))

B54 Kur vlerëson secilën situatë të flukseve monetare dhe probabilitetin e saj, njësia ekonomike duhet të përdorë të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe mbështetës në dispozicion pa kosto apo përpjekje të papërshtatshme. Njësia ekonomike do të rishikojë vlerësimet që ajo ka bërë në fund të periudhës së mëparshme të raportimit dhe duhet t'i përditësojë ato. Kur bën këtë, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë nëse:

(a) vlerësimet e përditësuara janë një paraqitje besnike e kushteve në fund të periudhës raportuese.

(b) ndryshimet në vlerësime janë një paraqitje besnike e ndryshimeve në kushtet gjatë periudhës. Për shembull, supozojmë se në fillim të periudhës vlerësimet ishin në njërin nga skajet e gamës së arsyeshme. Nëse kushtet nuk kanë ndryshuar, zhvendosja e vlerësimeve në skajin tjetër në fund të periudhës nuk do të ishte një paraqitje besnike e asaj që ka ndodhur gjatë periudhës. Nëse vlerësimet më të fundit të njësisë ekonomike janë të ndryshme nga vlerësimet e saj të mëparshme, por kushtet nuk kanë ndryshuar, ajo do të vlerësojë nëse janë të justifikuara probabilitetet e reja të caktuara ndaj secilës situatë. Kur përditësohen vlerësimet e këtyre probabiliteteve, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë evidencën që mbështeste vlerësimet e saj të mëparshme por edhe të gjithë evidencën e re në dispozicion, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës më bindëse.

B55 Probabiliteti që i caktohet secilës situatë do të pasqyrojë kushtet në fund të periudhës raportuese. Për pasojë, duke zbatuar SNK 10 *Ngjarjet pas periudhës së raportimit*, një ngjarje që ndodh pas fundit të periudhës raportuese dhe zgjidh një pasiguri që ekzistonte në fund të periudhës raportuese nuk ofron evidencë për kushtet që ekzistonin në atë datë. Për shembull, në fund të periudhës raportuese vlerësohet me probabilitet 20 për qind se një stuhi e fuqishme do të godasë gjatë gjashtë muajve të mbetur të një kontrate sigurimi. Pas mbylljes së periudhës raportuese por përpara se të jenë miratuar për publikim pasqyrat financiare, stuhia e fuqishme godet. Realizimi i flukseve monetare sipas asaj kontrate nuk do të pasqyrojë stuhinë që, tashmë, dihet se ka ndodhur. Por, flukset monetare të përfshira në matje përfshijnë probabilitetin 20 për qind të vlerësuar në fund të periudhës raportuese (me dhënie informacione shpjeguese duke zbatuar SNK 10 që një ngjarje jo-rregulluese ka ndodhur pas fundit të periudhës raportuese).

B56 Vlerësimet aktuale të flukseve monetare të pritshme nuk janë domosdoshmërisht identike me eksperiencën më të fundit aktuale. Për shembull, supozohet se eksperienca e vdekshmërisë në periudhën raportuese ishte 20 për qind më keq sesa eksperienca e mëparshme dhe eksperienca e pritshme e mëparshme e vdekshmërisë. Faktorë të ndryshëm mund të kenë shkaktuar ndryshimin e papritur në eksperiencë, përfshirë:

(a) ndryshime afatgjata në vdekshmërinë;

(b) ndryshime në karakteristikat e popullatës së siguruar (për shembull, ndryshimet në nënshkrim ose shpërndarje, ose kalimin selektiv nga policë mbajtësit me shëndet jo të zakonshëm);

(c) luhatjet e rastit; ose

(d) shkaqe të identifikueshme jo-të përsëritura.

B57 Njësia ekonomike do të hetojë arsyet për ndryshimet në eksperiencë dhe do të bëjë vlerësime të reja të flukseve monetare dhe probabiliteteve nën dritën e eksperiencës më të fundit, eksperiencës më të hershme dhe informacioneve të tjera. Për shembull, në paragrafin B56, zakonisht rezultati do të ishte që vlera aktuale e pritshme për përfitimet e lidhura me vdekjen ndryshon por jo aq shumë sa 20 për qind. Në shembullin në paragrafin B56, nëse norma e vdekshmërisë vazhdon të jetë ndjeshëm më lart se vlerësimet e mëparshme për arsye që pritet të vazhdojnë, vlerësimi për probabilitetin që i caktohet situatave me vdekshmëri të lartë do të rritet.

B58 Vlerësimet e variablave jo-të tregut do të përfshijnë informacion rreth nivelit aktual të ngjarjeve të siguruara dhe informacione rreth prirjeve. Për shembull, në shumë vende normat e vdekshmërisë kanë rënë në mënyrë të qëndrueshme përgjatë periudhave afatgjata. Përcaktimi i realizimit të flukseve monetare pasqyron probabilitetet që do t'i caktohen secilit skenar prirjeje të mundshëm, duke marrë në konsideratë të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe mbështetës në dispozicion pa kosto apo përpjekje të papërshtatshme.

B59 Në mënyrë të ngjashme, nëse flukset monetare të caktuara ndaj një grupi kontratash sigurimi janë të ndjeshme ndaj inflacionit, përcaktimi i realizimit të flukseve monetare do të pasqyrojë vlerësimet aktuale të normave të ardhshme të mundshme të inflacionit. Për shkak se normat e inflacionit ka mundësi të jenë të lidhura me normat e interesit, matja e realizimit të flukseve monetare do të pasqyrojë probabilitetet për secilin skenar inflacioni në një mënyrë që të jetë në pajtim me probabilitetet e nënkuptuara nga normat e interesit të tregut të përdorura në vlerësimin e normës së skontimit (shih paragrafin B51).

B60 Kur vlerëson flukset monetare, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë pritshmërinë aktuale për ngjarjet e ardhshme që mund të ndikojnë këto flukse monetare. Njësia ekonomike do të zhvillojë skenarë fluksesh monetare që pasqyrojnë këto ngjarje të ardhshme si dhe vlerësime të paanshme të probabilitetit për secilin skenar. Megjithatë njësia ekonomike nuk do të marrë në konsideratë pritshmëritë aktuale të ndryshimeve të ardhshme në legjislacion të cilat do të ndryshojnë ose shkarkojnë detyrimin aktual ose krijojnë detyrime të reja sipas kontratave ekzistuese të sigurimit,derisa ndryshimi në legjislacion të ketë hyrë në fuqi gjerësisht.

Flukset e mjeteve monetare brenda kufijve të kontratës (shih paragrafi 34)

B61 Vlerësimet e flukseve monetare në një skenar do të përfshijnë të gjitha flukset monetare brenda kufijve të një kontrate ekzistuese dhe jo flukse të tjera monetare. Njësia ekonomike do të zbatojë paragrafin 2 kur përcakton kufijtë e një kontrate ekzistuese.

B62 Shumë kontrata sigurimi kanë tipare të cilat i mundësojnë policë mbajtësit të ndërmarrë veprime që ndryshojnë shumën, kohën, natyrën ose pasigurinë e shumave që ata do të marrin. Tipare të tilla përfshijnë rinovim opsionesh, dorëzim opsionesh, konvertim opsionesh dhe opsione për të ndalur pagimin e primeve ndërsa merren ende përfitimet sipas kontratës. Matja e një grupi kontratash sigurimi do të pasqyrojë, bazuar në vlerën e pritshme, vlerësimet aktuale të njësisë ekonomike për mënyrën si policë mbajtësit e grupit do të ushtrojnë opsionet në dispozicion dhe rregullimi për rrezikun jo-financiar do të pasqyrojë vlerësimet aktuale të njësisë ekonomike për mënyrën sesi sjellja aktuale e policë mbajtësve mund të ndryshojë nga sjellja e pritshme. Kjo kërkesë për të përcaktuar vlerën e pritur zbatohet pavarësisht nga numri i kontratave në grup;

 © Fondacioni i SNRF-ve

për shembull, ai zbatohet edhe nëse grupi përmban vetëm një kontratë. Prandaj, matja e një grupi kontratash sigurimi nuk duhet të supozojë me probabilitet 100 për qind se policë mbajtësit do të:

(a) dorëzojnë kontratat e tyre, nëse ka mundësi që disa policë mbajtës nuk do ta bëjnë këtë; ose

(b) vazhdojnë kontratat e tyre, nëse ka mundësi që disa policë mbajtës nuk do ta bëjnë këtë.

B63 Nëse emetuesit të një kontrate sigurimi kërkohet nga kontrata që të rinovojë ose vazhdojë ndryshe kontratën, ai do të zbatojë paragrafin 34 për të vlerësuar nëse primet dhe flukset monetare të lidhura që vijnë nga kontrata e rinovuar janë brenda objektit të kontratës fillestare.

B64 Paragrafi 34 i referohet aftësisë praktike të njësisë ekonomike për të vendosur një çmim në një datë të ardhshme (data e rinovimit), që pasqyron plotësisht rreziqet në kontratë nga ajo datë. Njësia ekonomike e ka atë aftësi praktike në mungesë të pengesave që e ndalojnë njësinë ekonomike të vendosë të njëjtin çmim që do të vendoste për një kontratë të re, me të njëjtat karakteristika si kontrata ekzistuese e emetuar në atë datë ose nëse mund të ndryshonte përfitimet për të qenë në përputhje me çmimin që do të vendoste. Në mënyrë të ngjashme, njësia ekonomike ka aftësi praktike për të vendosur një çmim kur ajo mund të rivendosë çmimin e një kontrate ekzistuese në mënyrë që çmimi të pasqyrojë ndryshimet e përgjithshme në rreziqet e një portofoli kontratash sigurimi,edhe nëse çmimi i vendosur për secilin policë mbajtës individual nuk pasqyron ndryshimin në rrezik për atë policë mbajtës specifik. Kur njësia ekonomike vlerëson nëse ka aftësinë praktike për të vendosur një çmim që pasqyron plotësisht rreziqet në kontratë ose portofol, ajo do të marrë në konsideratë të gjitha rreziqet që duhet të ketë parasysh kur nënshkruan kontrata ekuivalente në datën e rinovimit për shërbimin e mbetur. Njësia ekonomike do të rivlerësojë kufijtë e një kontrate sigurimi për të përfshirë efektin e ndryshimeve në rrethanat e të drejtave dhe detyrimeve themelore të saj, kur përcakton vlerësimet e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare në fund të periudhës raportuese.

B65 Flukset e mjeteve monetare brenda kufijve të një kontrate sigurimi janë ato që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e kontratës, përfshirë flukset monetare për të cilat njësia ekonomike mund të vendosë lirisht mbi shumën ose kohën. Flukset e mjeteve monetare brenda kufijve të kontratës përfshijnë:

(a) primet (duke përfshirë rregullimet për primet dhe primet me këste) nga policë mbajtësi dhe çdo fluks monetar shtesë që vjen nga këto prime.

(b) pagesat tek (ose për llogari të) një policë mbajtës, duke përfshirë kërkesat shtesë që janë raportuar tashmë por nuk janë paguar ende (d.m.th kërkesa shtesë të raportuara), kërkesa shtesë të pësuara për ngjarje që kanë ndodhur, por për të cilat kërkesa shtesë nuk është raportuar ende dhe të gjitha kërkesat shtesë të ardhshme për të cilat njësia ekonomike ka një detyrim themelor (shih paragrafin 34).

(c) pagesa tek (ose për llogari të) një policë mbajtës që ndryshojnë në varësi të kthimeve nga zërat bazë.

(d) pagesa tek (ose për llogari të) një policë mbajtës që vijnë nga derivativët, për shembull opsionet dhe garancitë e përfshira në kontratë në masën që ato opsione dhe garanci nuk ndahen nga kontrata e sigurimit (shih paragrafin 11(a)).

(e) një shpërndarje e flukseve të mjeteve monetare të blerjes së sigurimit që i takojnë portofolit të cilit i përket kontratat.

(f) kostot e menaxhimit të kërkesave shtesë (d.m.th kostot që do të ndeshë njësia ekonomike ndërsa heton, përpunon dhe zgjidh kërkesat shtesë sipas kontratave të sigurimit ekzistuese, përfshirë komisionet ligjore dhe të rregullimit të humbjeve si dhe kostot e brendshme të hetimit të kërkesave shtesë dhe përpunimit të pagesave për kërkesat shtesë).

(g) kostot që njësia ekonomike do të ndeshë duke ofruar përfitimet kontraktuale të paguara në natyrë.

(h) kostot e administrimit të politikave dhe mirëmbajtjes, të tilla si kostot e faturimit të primit dhe menaxhimit të ndryshimeve të politikave (për shembull, konvertimet dhe riparaqitjet). Kosto të tilla përfshijnë edhe komisionet e rindodhjes që pritet t'u paguhen ndërmjetësve në rast se një policë mbajtës i caktuar vazhdon të paguajë primet brenda kufijve të kontratës së sigurimit.

(i) taksat e bazuara në transaksione (të tilla si taksat e primit, tatimi mbi vlerën e shtuar dhe taksat mbi mallrat dhe shërbimet) dhe ndalesa të tjera (të tilla si ndalesa mbi shërbimin e zjarrit dhe vlerësimet e fondit të garancive), që vijnë drejtpërdrejt nga kontratat ekzistuese të sigurimit ose që mund t'u takojnë atyre mbi një bazë të arsyeshme dhe të qëndrueshme.

(j) pagesat nga siguruesi në cilësinë e një mbajtësi të besueshëm për të përmbushur detyrimet tatimore të ndeshura nga policë mbajtësi dhe arkëtimet korresponduese.

(k) hyrjet e mundshme të mjeteve monetare nga rikuperimet (të tilla si një rikuperim dhe zëvendësim) e kërkesave shtesë të ardhshme të mbuluara nga kontratat ekzistuese të sigurimit dhe

flukset hyrëse monetare të mundshme nga rikuperimet mbi kërkesat shtesë të shkuara, në masën që ato nuk kualifikohen për njohje si aktive të veçanta.

(ka) kostot që do të pësojë njësia ekonomike kur:

(i) realizon aktivitetin investues, në masën që njësia ekonomike e realizon atë aktivitet për të rritur përfitimet nga mbulimi i sigurimit për policë mbajtësit. Aktivitetet investuese rrisin përfitimet për mbulimin e sigurimit nëse njësia ekonomike i realizon ato aktivitete duke pritur që të gjenerojë një kthim investimi për të cilin policë mbajtësit do të përfitojnë nëse ndodh ngjarja e siguruar.

(ii) ofron shërbime kthim investimi tek policë mbajtësit e kontratave të sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së lirë (shih paragrafin B119B).

(iii) ofron shërbime të lidhura me investimin tek policë mbajtësit e kontratave të sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së lirë.

(l) një shpërndarje e shpenzimeve të përgjithshme fikse dhe variabël (të tilla si kosto e kontabilitetit, e burimeve njerëzore, e teknologjisë së informacionit dhe mbështetjes teknike, e amortizimit të ndërtesave, e qirasë dhe e mirëmbajtjes) të ngarkueshme drejtpërdrejt në përmbushjen e kontratave të sigurimit. Shpenzime të përgjithshme të tilla shpërndahen tek grupet e kontratave duke përdorur metoda që janë sistematike, racionale dhe që aplikohen vazhdimisht tek të gjitha kostot e tjera me karakteristika të njëjta.

(m) kosto të tjera të cilat posaçërisht i ngarkohen policë mbajtësit sipas kushteve të kontratës.

B66 Flukset e mjeteve monetare në vijim nuk do të përfshihen kur vlerësohen flukset monetare që do të vijnë, ndërsa njësia ekonomike përmbush një kontratë sigurimi ekzistuese:

(a) kthimet nga investimi. Investimet njihen, maten dhe paraqiten veçmas.

(b) flukset e mjeteve monetare (pagesa ose arkëtime), që vijnë nga kontratat e risigurimit të mbajtuara. Kontratat e risigurimit të mbajtura njihen, maten dhe paraqiten veçmas.

(c) flukset monetare që mund të vijnë nga kontratat e sigurimit të ardhshme, d.m.th flukset monetare jashtë kufijve të kontratave ekzistuese (shih paragrafët 34–35).

(d) flukset monetare që lidhen me kostot që nuk mund t'i ngarkohen drejtpërdrejt portofolit të kontratave të sigurimit, të tilla si disa kosto të zhvillimit të produktit dhe të trajnimit. Kosto të tilla njihen në fitim ose humbje kur ato kryhen.

(e) flukset monetare që vijnë nga shumat jo-normale të punës ose burimeve të tjera të humbura të cilat përdoren për të përmbushur kontratën. Kosto të tilla njihen në fitim ose humbje kur ato kryhen.

(f) pagesat dhe arkëtimet e tatimit mbi të ardhurat që siguruesi nuk paguan apo arkëton në mirëbesim (në cilësinë e mbajtësit në besueshmëri) ose që nuk janë të ngarkueshme në mënyrë specifike tek policë mbajtësi sipas kushteve të kontratës.

(g) flukset monetare mes përbërësve të ndryshëm të njësisë ekonomike raportuese, të tillë si fondet e policë mbajtësve dhe fondet e aksion mbajtësve (aksionarëve), nëse këto flukse monetare nuk ndryshojnë shumën që do t'u paguhet policë mbajtësve.

(h) flukset monetare që vijnë nga përbërësit e veçantë nga kontratat e sigurimit dhe të trajtuar duke përdorur Standardet e tjera të zbatueshme (shih paragrafët 10–13).

B66A Para njohjes së një grupi kontratash sigurimi, njësisë ekonomike mund t'i kërkohet të njohë një aktiv ose detyrim për flukset monetare të lidhura me grupin e kontratave të sigurimit të ndryshme nga flukset monetare të blerjes së sigurimit ose për shkak të ndodhjes së fluksit monetar, ose për shkak të kërkesave të një SNRF-je tjetër. Flukset monetare lidhen me grupin e kontratave të sigurimit nëse ato do të ishin përfshirë në flukset monetare të realizuara në datën e njohjes fillestare të grupit dhe nëse do të ishin paguar ose arkëtuar pas asaj date. Për të zbatuar paragrafin 38(c)(ii) njësia ekonomike do të çregjistrojë (mos njohë) një aktiv ose detyrim të tillë në masën që aktivi apo detyrimi nuk do të njihet veçmas nga grupi i kontratave te sigurimit nëse fluksi monetar ose zbatimi i SNRF-së ka ndodhur në datën e njohjes fillestare të grupit të kontratave të sigurimit.

Kontratat me flukse monetare që ndikojnë ose ndikohen nga flukset monetare të policë mbajtësve të kontratave të tjera

B67 Disa kontrata sigurimi ndikojnë flukset monetare të policë mbajtësve të kontratave të tjera duke kërkuar që:

 © Fondacioni i SNRF-ve

(a) policë mbajtësi të ndajë me policë mbajtësit e kontratave të tjera kthimet nga një grup i caktuar dhe i njëjtë i zërave bazë; dhe

(b) ose:

(i) policë mbajtësi të mbartë një pakësim në pjesën e tij të kthimeve mbi zërat bazë për shkak të pagesave tek policë mbajtësit e kontratave të tjera që ndajnë atë grup, përfshirë pagesat që vijnë sipas garancive të bëra tek policë mbajtësit e këtyre kontratave të tjera; ose

(ii) policë mbajtësit e kontratave të tjera të mbartin një pakësim në kthimet e tyre nga zërat bazë për shkak të pagesave tek policë mbajtësi, përfshirë pagesat që vijnë nga garancitë e bëra tek policë mbajtësi.

B68 Ndonjëherë, kontrata të tilla do të ndikojnë flukset monetare të policë mbajtësve në kontratat e tjera të grupit. Realizimi i flukseve monetare të secilit grup pasqyron madhësinë në të cilën kontratat në grup bëjnë që njësia ekonomike të ndikohet nga flukset monetare të pritshme, si për policë mbajtësit në grup edhe për policë mbajtësit e një grupi tjetër. Prandaj realizimi e flukseve të mjeteve monetare për një grup:

(a) përfshin pagesat që vijnë nga kushtet e kontratave ekzistuese tek policë mbajtësit e kontratave në grupet e tjera, pavarësisht nëse këto kontrata pritet që t'u bëhen policë mbajtësve aktualë ose të ardhshëm; dhe

(b) përjashton pagesat tek policë mbajtësit në grup që, duke zbatuar pikën (a), janë përfshirë në realizimin e flukseve monetare të një grupi tjetër.

B69 Për shembull, duke qenë se pagesat tek policë mbajtësit e një grupi janë pakësuar nga ndarja e kthimeve mbi zërat bazë nga 350NJM në 250NJM për shkak të pagesave të një shume të garantuar tek policë mbajtësit e një grupi tjetër, flukset monetare të realizuara të grupit të parë do të përfshijnë pagesat prej 100NJM (d.m.th do të ishte 350NJM) dhe flukset monetare të realizuara të grupit të dytë do të përjashtonin 100 NJM të shumës së garantuar.

B70 Mund të përdoren qasje praktike të ndryshme për të përcaktuar flukset monetare të realizuara të grupeve që ndikojnë ose që ndikohen nga flukset monetare tek policë mbajtësit e kontratave në grupet e tjera. Në disa raste, njësia ekonomike mund të jetë në gjendje të identifikojë ndryshimin në zërat bazë dhe ndryshimin pasojë në flukset monetare vetëm në një nivel totalizimi më të lartë se grupi. Në të tilla raste, njësia ekonomike do të shpërndajë efektin e ndryshimit në zërat bazë tek secili grup mbi baza sistematike dhe racionale.

B71 Edhe pasi të jenë ofruar të gjithë shërbimet e kontratës së sigurimit të kontratave në një grup, flukset monetare të realizuara mund të përfshijnë ende pagesa të pritshme për t'u bërë tek policë mbajtësit aktualë në grupet e tjera ose tek policë mbajtës të ardhshëm. Nuk kërkohet që njësia ekonomike të vazhdojë të shpërndajë flukse të tilla monetare të realizuara tek grupe specifike, por në vend të kësaj mund të njohë dhe masë një detyrim për të tilla flukse monetare të realizuara që vijnë nga të gjitha grupet.

Normat e skontimit (paragrafi 36)

B72 Kur zbaton SNRF 17, njësia ekonomike do të përdorë normat e skontimit në vijim:

(a) për të matur flukset monetare përmbushëse—normat aktuale të skontimit duke zbatuar paragrafin 36;

(b) për të përcaktuar interesin rritës mbi marzhin e kontraktuar të shërbimit në zbatim të paragrafit 44(b) për kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë—normat e skontimit të përcaktuara në datën e njohjes fillestare të një grupi kontratash, duke zbatuar paragrafin 36 mbi flukset monetare nominale që nuk ndryshojnë bazuar në kthimet nga ndonjë zë bazë;

(c) për të matur ndryshimet në marzhin e kontraktuar të shërbimit në zbatim të paragrafëve B96(a)–B96(b) dhe B96(d) për kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë—normat e skontimit duke zbatuar paragrafin 36, të përcaktuara në njohjen fillestare;

(d) për grupet e kontratave që zbatojnë metodën e shpërndarjes së primit dhe që kanë një përbërës të rëndësishëm financiar, për të rregulluar vlerën kontabël (neto)të detyrimit për mbulimin e mbetur në zbatim të paragrafit 56—normat e skontimit sipas kërkesave të paragrafit 36 të përcaktuara në njohjen fillestare;

(e) nëse njësia ekonomike zgjedh të zbërthejë të ardhurat apo shpenzimet financiare nga sigurimi mes fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (shih paragrafin 88), për të përcaktuar shumën e të ardhurës apo shpenzimit financiar nga sigurimi për t'u përfshirë në fitim ose humbje:

(i) për grupet e kontratave të sigurimit për të cilat ndryshimet në supozimet që lidhen me rrezikun financiar nuk kanë një efekt të rëndësishëm në shumat e paguara tek policë mbajtësit,duke zbatuar paragrafin B131—normat e skontimit të përcaktuara në datën e njohjes fillestare të një grupi kontratash, duke zbatuar paragrafin 36 për flukset monetare nominale, që do nuk do të ndryshojnë bazuar në kthimet e ndonjë zëri bazë;

(ii) për grupet e kontratave të sigurimit për të cilat ndryshimet në supozimet që lidhen me rrezikun financiar kanë një efekt të rëndësishëm në shumat e paguara tek policë mbajtësit, duke zbatuar paragrafin B132(a)(i)—normat e skontimit që shpërndajnë të ardhurën apo shpenzimin financiar të pritshëm, të rishikuar dhe të mbetur, për gjatë kohëzgjatjes së mbetur të grupit të kontratave me një normë konstante; dhe

(iii) për grupe kontratash që zbatojnë metodën e shpërndarjes së primit sipas paragrafëve 59(b) dhe B133—normat e skontimit të përcaktuara në datën e kërkesës shtesë të pësuar, duke zbatuar paragrafin 36 për flukset monetare nominale që nuk ndryshojnë bazuar në kthimet e ndonjë zëri bazë.

B73 Për të përcaktuar normat e skontimit në datën e njohjes fillestare të një grupi kontratash të përshkruara në paragrafët B72(b)–B72(e), njësia ekonomike mund të përdorë normat e skontimit sipas mesatares së ponderuar gjatë periudhës që janë emetuar kontratat në grup, që sipas paragrafit 22 nuk mund të kapërcejë vitin.

B74 Vlerësimet e normave të skontimit do të jenë të qëndrueshme me të gjitha vlerësimet e tjera të përdorura për matjen e kontratave të sigurimit,për të shmangur dublimin në llogaritje ose harresën; për shembull:

(a) flukset monetare që nuk ndryshojnë bazuar në kthimet e ndonjë zëri bazë do të skontohen me norma që nuk pasqyrojnë këtë ndryshim;

(b) flukset e mjeteve monetare që ndryshojnë bazuar në kthimet e ndonjë zëri bazë financiar do të:

(i) skontohen duke përdorur normat që pasqyrojnë atë ndryshim; ose

(ii) rregullohen për efektin e atij ndryshimi dhe skontohen me një normë që pasqyron rregullimin e bërë.

(c) flukset e mjeteve monetare nominale (d.m.th ato që përfshijnë efektin e inflacionit) do të skontohen me një normë që përfshin efektin e inflacionit; dhe

(d) flukset reale të mjeteve monetare (d.m.th ato që përjashtojnë efektin e inflacionit) do të skontohen me një normë që përjashton efektin e inflacionit.

B75 Paragrafi B74(b) kërkon që flukset monetare të ndryshueshme nga kthimet e zërave bazë, të skontohen duke përdorur normat që pasqyrojnë këtë ndryshim ose të rregullohen për efektin e këtij ndryshimi dhe të skontohen me një normë që pasqyron rregullimin e bërë. Ndryshimi është një faktor i rëndësishëm pavarësisht nëse ai vjen për shkak të kushteve kontraktuale apo sepse njësia ekonomike ushtron vullnetin e saj dhe pavarësisht nëse njësia ekonomike mban zërat bazë.

B76 Flukset e mjeteve monetare që ndryshojnë nga kthimet e zërave bazë me kthime variabël, por që janë subjekt i një garancie për një minimum kthimi, nuk ndryshojnë vetëm bazuar në kthimet e zërave bazë edhe kur shuma e garantuar është më e ulët sesa kthimi i pritshëm nga zërat bazë. Por, njësia ekonomike do të rregullojë normën që pasqyron ndryshimin në kthimet nga zërat bazë për efektin e garancisë edhe nëse shuma e garantuar është më e ulët sesa kthimi i pritur nga zërat bazë.

B77 SNRF 17 nuk kërkon që njësia ekonomike të ndajë flukset monetare të vlerësuara në ato që ndryshojnë bazuar në kthimet e zërave bazë dhe flukset që nuk ndryshojnë Nëse njësia ekonomike nuk ndan flukset monetare të vlerësuara në këtë mënyrë, njësia ekonomike do të zbatojë normat e skontimit të përshtatshme për flukset monetare të vlerësuara në tërësi; për shembull, duke përdorur teknikat e modeleve parashikuese (stokastike) ose teknikat e matjes me rrezik-neutral.

B78 Normat e skontimit do të përfshijnë vetëm faktorët e rëndësishëm, d.m.th faktorët që vijnë nga vlera në kohë e parasë, karakteristikat e flukseve monetare dhe karakteristikat e likuiditetit të kontratave të sigurimit. Norma skontimi të tilla mund të mos jenë të vrojtueshme drejtpërdrejt në treg. Megjithatë nëse normat në tregjet e mbikëqyrura për një instrument me të njëjtat karakteristikave nuk janë disponibël, ose normat në tregjet e mbikëqyrura për instrumenta të ngjashëm janë në dispozicion por nuk identifikojnë veçmas faktorët që dallojnë instrumentin nga kontratat e sigurimit, njësia ekonomike do të vlerësojë normat e përshtatshme. SNRF 17 nuk kërkon përdorimin e ndonjë teknike të caktuar vlerësimi për të përcaktuar normat e skontimit. Kur zbaton një teknikë vlerësimi, njësia ekonomike do të:

(a) maksimizojë përdorimin e inputeve të verifikueshme (shih paragrafin B44) dhe të pasqyrojë të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe mbështetës mbi variablat jo-të tregut, në dispozicion pa

 © Fondacioni i SNRF-ve

kosto apo përpjekje të papërshtatshme të brendshëm dhe të jashtëm (shih paragrafin B49). Veçanërisht, normat e skontimit të përdorura nuk duhet të bien në kontradiktë me ndonjë të dhënë në dispozicion dhe të rëndësishme nga tregu, si dhe ndonjë variabël jo-i tregut nuk duhet të jetë në kontradiktë me variablat e tregjeve të mbikëqyrura.

(b) pasqyrojë kushtet aktuale të tregut nga perspektiva e një pjesëmarrësi në treg.

(c) ushtrojë gjykim në vlerësimin e shkallës së ngjashmërisë mes tipareve të kontratave të sigurimit të matura dhe tipareve të instrumentit për të cilin disponohen çmimet në tregjet e mbikëqyrura dhe të rregullojë këto çmime për të pasqyruar ndryshimin mes tyre.

B79 Për flukset e mjeteve monetare të kontratave të sigurimit të cilat nuk ndryshojnë sipas kthimeve në zërat bazë, norma e skontimit pasqyron kurbën e rendimentit të monedhës përkatëse për instrumentet që ekspozojnë mbajtësin ndaj një rreziku të papërfillshëm ose zero, të rregulluar për të pasqyruar karakteristikat e likuiditetit të grupit të kontratave të sigurimit. Ky rregullim do të pasqyrojë diferencën mes karakteristikave të likuiditetit të grupit të kontratave të sigurimit dhe karakteristikave të likuiditetit të aktiveve të përdorura për të përcaktuar kurbën e rendimentit. Kurba e rendimentit pasqyron aktivet e tregtuara në tregje aktive, të cilat mbajtësi zakonisht mund t'i shesë menjëherë, në çdo kohë pa pësuar kosto të rëndësishme. Ndërsa sipas disa kontratave të sigurimit një njësi ekonomike nuk mund të detyrohet të bëjë pagesa më herët se ndodhja e ngjarjeve të siguruara, ose datat e cilësuara në kontrata.

B80 Prandaj, për flukset e mjeteve monetare të kontratave të sigurimit që nuk ndryshojnë sipas kthimeve të zërave bazë, njësia ekonomike mund të përcaktojë normat e skontimit duke rregulluar kurbën e rendimentit pa rrezik likuiditeti për të pasqyruar diferencat mes karakteristikave të instrumenteve financiarë, që janë në bazë të normave të vrojtuara në treg dhe karakteristikave të likuiditetit të kontratave të sigurimit (qasje nga poshtë-lart).

B81 Si alternativë, njësia ekonomike mund të përcaktojë normat e duhura të skontimit për kontratat e sigurimit bazuar në një kurbë rendimenti e cila pasqyron normat aktuale të tregut për kthimin e nënkuptuar në një matje të vlerës së drejtë të një portofoli aktivesh si referencë (qasje nga lart-poshtë). Njësia ekonomike do të rregullojë këtë kurbë rendimenti për të eliminuar çdo faktor që nuk është i rëndësishëm për kontratat e sigurimit, por nuk kërkohet që ajo të rregullojë kurbën e rendimentit për diferencat në karakteristikat e likuiditetit të kontratave të sigurimit dhe portofolit të referencës.

B82 Kur vlerësohet kurba e rendimentit e përshkruar në paragrafin B81:

(a) nëse ka çmime të vrojtueshme (të publikuara) në tregjet aktive për aktivet në portofolin e referencës, njësia ekonomike do të përdorë ato çmime (në përputhje me paragrafin 69 të SNRF 13).

(b) nëse tregu nuk është aktiv, njësia ekonomike do të rregullojë çmimet e tregjeve të mbikëqyrura për aktive të ngjashme për t'i bërë ato të krahasueshme me çmimet e tregut për aktivet që po maten (në përputhje me paragrafin 83 të SNRF 13).

(c) nëse nuk ka treg për aktivet në portofolin referencë, njësia ekonomike do të zbatojë një teknikë vlerësimi. Për aktive të tilla (në përputhje me paragrafin 89 të SNRF 13) njësia ekonomike do të:

(i) zhvillojë inpute të paverifikueshme duke përdorur informacionin më të mirë në dispozicion sipas rrethanave. Inpute të tilla mund të përfshijnë të dhënat e vetë njësisë ekonomike dhe në kontekstin e SNRF 17, njësia ekonomike mund t'u japë më shumë rëndësi vlerësimeve afatgjata sesa ndryshimeve afatshkurtra; dhe

(ii) rregullojë këto të dhëna për të marrë parasysh të gjithë informacionin, që disponohet në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me supozimet e pjesëmarrësve të tregut.

B83 Gjatë rregullimit të kurbës së rendimentit, njësia ekonomike do të rregullojë normat e tregut të vrojtuara në transaksionet më të fundit në instrumenta me karakteristika të ngjashme për lëvizjet në faktorët e tregut që nga data e transaksionit dhe do të rregullojnë normat e vrojtuara në treg për të pasqyruar shkallën e ndryshimeve mes instrumentit të matur dhe instrumentit për të cilin janë të vrojtueshme çmimet e transaksionit. Për flukset e mjeteve monetare të kontratave të sigurimit që nuk variojnë sipas kthimeve të aktiveve në portofolin e referencës, rregullime të tilla përfshijnë:

(a) rregullim për diferencën mes shumës, kohës dhe pasigurisë së flukseve monetare të aktiveve në portofol dhe shumës, kohës dhe pasigurisë së flukseve monetare të kontratave të sigurimit; dhe

(b) përjashtimin e primeve për rrezikun e tregut për rrezikun e kredisë, që janë të rëndësishëm vetëm për aktivet e përfshira në portofolin e referencës.

B84 Në parim për flukset monetare të kontratave të sigurimit që nuk ndryshojnë sipas kthimeve të aktiveve në portofolin e referencës, duhet të ketë një kurbë të vetme rendimenti pa-rrezik likuiditeti, e cila eliminon të gjitha pasiguritë rreth shumës dhe kohës së flukseve monetare. Megjithatë në praktikë qasja nga lart-poshtë dhe qasja nga poshtë-lart mund të rezultojnë në kurba rendimenti të ndryshme edhe për të njëjtën monedhë.

Kjo për shkak të kufizimeve të pranishme në vlerësimin e rregullimeve të bëra sipas secilës qasje dhe mungesës së mundshme të një rregullimi për karakteristikat e likuiditetit në qasjen nga lart-poshtë. Nuk kërkohet që njësia ekonomike të rakordojë normën e skontimit të përcaktuar sipas qasjes së zgjedhur me normën e skontimit që do të përcaktohej sipas qasjes tjetër.

B85 SNRF 17 nuk specifikon kufizime për portofolin e referencës të aktiveve, që përdoret kur zbatohet paragrafi B81. Megjithatë më pak rregullime do të duhen për të eliminuar faktorët që nuk janë të rëndësishëm për kontratat e sigurimit, kur portofoli i referencës së aktiveve ka karakteristika të ngjashme. Për shembull, nëse flukset e mjeteve monetare nga kontratat e sigurimit nuk do të ndryshojnë sipas kthimeve në zërat bazë, më pak rregullime do të kërkohen nëse njësia ekonomike përdorte instrumentet e borxhit si pikënisje kundrejt instrumenteve të kapitalit. Për instrumentet e borxhit, objektivi do të jetë eliminimi nga rendimenti total i obligacionit i efektit të rrezikut të kredisë dhe faktorëve të tjera, të cilët nuk janë të rëndësishëm për kontratat e sigurimit. Një mënyrë për të vlerësuar efektin e rrezikut të kredisë është përdorimi si pikë referimi i çmimit të tregut të një derivativi kredie.

Rregullim për rrezikun jo-financiar (paragrafi 37)

B86 Rregullimi për rrezikun jo-financiar lidhet me rrezikun që vjen nga kontratat e sigurimit i cili ndryshon nga rreziku financiar. Rreziku financiar përfshihet në vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme ose normën e skontimit të përdorur për të rregulluar flukset monetare. Rreziqet e mbuluara nga rregullimi për rrezikun jo-financiar janë rreziku i sigurimit dhe rreziqe të tjera jo-financiare, të tilla si rreziku i kalimit të afatit dhe rreziku i shpenzimit (shih paragrafin B14).

B87 Rregullimi për rrezikun jo-financiar për kontratat e sigurimit mat kompensimin që njësia ekonomike do të kërkojë për ta bërë njësinë ekonomike indiferente mes:

(a) përmbushjes së një detyrimi që ka një gamë rezultatesh të mundshme si pasojë e rrezikut jo-financiar; dhe

(b) përmbushjes së një detyrimi që do të gjenerojë flukse monetare fikse, me të njëjtën vlerë aktuale të pritshme si kontratat e sigurimit.

Për shembull, rregullimi për rrezikun jo-financiar do të masë kompensimin që do të kërkojë njësia ekonomike për ta bërë atë indiferente mes përmbushjes së një detyrimi që—për shkak të rrezikut jo-financiar—ka 50 për qind mundësi të jetë 90NJM dhe 50 për qind mundësi të jetë 110NJM si dhe përmbushjes së një detyrimi që është fiks për 100 NJM. Si rezultat, rregullimi për rrezikun jo-financiar jep informacion tek përdoruesit e pasqyrave financiare rreth shumës që ngarkon njësia ekonomike për pasigurinë e ardhur nga rreziku jo-financiar për shumën dhe kohën e flukseve monetare.

B88 Duke qenë se rregullimi për rrezikun jo-financiar pasqyron kompensimin që do të kërkojë njësia ekonomike për mbartjen e rrezikut jo-financiar që vjen nga pasiguria e shumës dhe kohës së flukseve monetare, ai pasqyron edhe:

(a) shkallën e diversifikimit të përfitimeve që njësia ekonomike përfshin kur përcakton kompensimin që kërkon për mbartjen e atij rreziku; dhe

(b) rezultatet e favorshme dhe jo-të favorshme, në mënyrë që të pasqyrojë shkallën e kundërshtisë ndaj rrezikut të njësisë ekonomike.

B89 Qëllimi i rregullimit për rrezikun jo-financiar është që të matet efekti i pasigurisë në flukset monetare që vijnë nga kontratat e sigurimit, i ndryshëm nga pasiguria që vjen nga rreziku financiar. Për pasojë rregullimi për rrezikun jo-financiar do të pasqyrojë të gjitha rreziqet jo-financiare të lidhura me kontratat e sigurimit. Ai nuk do të përfshijë rreziqe që nuk vijnë nga kontratat financiare, të tilla si rreziku i përgjithshëm operacional.

B90 Rregullimi për rrezikun jo-financiar do të përfshihet në matje në mënyrë të qartë. Rregullimi për rrezikun jo-financiar është i ndarë si koncept nga vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme dhe normat e skontimit që rregullojnë këto flukse. Njësia ekonomike nuk do të dublojë në llogaritje rregullimin për rrezikun jo-financiar, për shembull duke përfshirë rregullim për rrezikun jo-financiar, kur përcakton vlerësimet për flukset monetare të ardhshme ose për normat e skontimit. Normat e skontimit të dhëna si informacion shpjegues në përputhje me paragrafin 120, nuk duhet të përfshijnë ndonjë rregullim të cilësuar për rrezikun jo-financiar.

B91 SNRF 17 nuk specifikon teknika (t) vlerësimi për t'u përdorur në përcaktimin e rregullimit për rrezikun jo-financiar. Por për të pasqyruar kompensimin që njësia ekonomike do të kërkonte për mbartjen e rrezikut jo-financiar, rregullimi duhet të ketë karakteristikat në vijim:

(a) rreziqet me frekuencë të ulët dhe dëm të lartë do të kërkojnë rregullime më të mëdha të rrezikut jo-financiar sesa rreziqet me frekuencë të lartë dhe dëm të ulët;

 © Fondacioni i SNRF-ve

(b) për rreziqe të ngjashme, kontratat me kohëzgjatje të madhe do të kërkojnë rregullime më të mëdha për rrezikun jo-financiar sesa kontratat me kohëzgjatje më të vogël;

(c) rreziqet me shpërndarje probabilitare më të gjerë do të kërkojnë rregullime më të mëdha të rrezikut jo-financiar sesa rreziqet me shpërndarje më të ngushtë;

(d) sa më pak dihet rreth vlerësimit aktual dhe prirjes së tij, aq më i madh do të jetë rregullimi për rrezikun jo-financiar; dhe

(e) rregullimet për rrezikun jo-financiar do të bien në madhësinë që eksperienca e re pakëson pasigurinë rreth kohës dhe shumës së flukseve monetare dhe e kundërta.

B92 Njësia ekonomike do të përdorë gjykimin kur përcakton teknikën e duhur të vlerësimit për rregullimin për rrezikun jo-financiar. Kur zbatohet ky gjykim, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë nëse teknika ofron dhënie informacionesh shpjeguese koncize dhe informuese në mënyrë që përdoruesit e pasqyrave financiare të mund të krahasojnë performancën e njësisë ekonomike me performancën e njësive të tjera. Paragrafi 119 kërkon që njësia ekonomike, e cila përdor një teknikë të ndryshme nga teknika e shkallës së besimit për përcaktimin e rregullimit për rrezikun jo-financiar, duhet të japë informacion shpjegues për teknikën e përdorur dhe shkallën e besimit që i korrespondon rezultateve të asaj teknike.

Njohja fillestare e transferimit të kontratave të sigurimit dhe kombinimet e biznesit (paragrafi 39)

B93 Nëse njësia ekonomike blen kontrata sigurimi të emetuara ose kontrata risigurimi të mbajtura në një transferim kontratash sigurimi që nuk formojnë një biznes, ose në një kombinim biznesi brenda objektit të SNRF 3, njësia ekonomike do të zbatojë paragrafët 14–24 për të identifikuar grupet e kontratave të blera, njëlloj sikur të kishte lidhur kontratat në datën e transaksionit.

B94 Njësia ekonomike do të përdorë konsideratën e marrë ose të paguar për kontratat si një vlerësim për primet e marra. Konsiderata e marrë ose e paguar për kontratat përjashton konsideratën e marrë ose të paguar për ndonjë aktiv apo detyrim tjetër të blerë në të njëjtin transaksion. Në një kombinim biznesi brenda objektit të SNRF 3, konsiderata e marrë ose e paguar është vlera e drejtë e kontratës në atë datë. Në përcaktimin e kësaj vlere të drejtë, njësia ekonomike nuk do të zbatojë paragrafin 47 të SNRF 13 (që lidhet me tiparet e kërkuara).

B95 Me përjashtim të rastit kur zbatohet metoda e shpërndarjes së primit për detyrimin e mbulimit të mbetur e paragrafëve 55–59 dhe 69–70A, në njohjen fillestare marzhi i kontraktuar i shërbimit llogaritet duke zbatuar paragrafin 38 për kontratat e sigurimit të blera, të emetuara dhe paragrafin 65 për kontratat e risigurimit të blera, të mbajtuara duke përdorur konsideratën e marrë ose të paguar për kontratat si një vlerësim për primet e marra ose të paguara në datën e njohjes fillestare.

B95A Nëse kontratat e blera të sigurimit janë me kushte rënduese, në zbatim të paragrafit 47, njësia ekonomike do të njohë tejkalimet e flukseve monetare të realizuara ndaj konsideratës së paguar ose të marrë si pjesë të emrit të mirë ose të fitimit nga një blerje me okazion për kontratat e blera në një kombinim biznesi brenda objektit të SNRF 3, ose si një humbje në rezultatin e periudhës (fitim ose humbje) për kontratat e blera në një transferim. Njësia ekonomike do të krijojë një përbërës humbjeje për detyrimin e mbulimit të mbetur për atë tejkalim, si dhe në zbatim të paragrafëve 49–52 do të shpërndajë tek ai përbërës humbjeje ndryshimet e mëpasshme në flukset monetare të realizuara.

B95B Për çdo grup kontratash risigurimi të mbajtuara për të cilat zbatohen paragrafët 66A–66B, njësia ekonomike do të përcaktojë përbërësin rikuperim humbjeje të aktivit për mbulimin e mbetur në datën e transaksionit duke shumëzuar:

(a) përbërësin humbje të detyrimit për mbulimin e mbetur të kontratave të sigurimit të përfshira në datën e transaksionit; dhe

(b) përqindjen e kërkesave shtesë mbi kontratat e sigurimit të përfshira që njësia ekonomike pret të rikuperojë nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura në datën e e transaksionit.

B95C Njësia ekonomike do të njohë shumën e përbërësit rikuperim humbjeje të përcaktuar në zbatim të paragrafit B95B si pjesë e emrit të mirë ose e fitimit nga blerja me okazion e kontratave të risigurimit të mbajtura të blera në një kombinim biznesi brenda objektit të SNRF 3 ose si një e ardhur në rezultatin e periudhës (fitim ose humbje) për kontratat e blera në transferim.

B95D Duke zbatuar paragrafët 14–22, në datën e transaksionit, njësia ekonomike mund të përfshijë në një grup me kushte rënduese të kontratave të sigurimit, si kontratat e sigurimit me kushte rënduese të mbuluara nga një grup i kontratave të risigurimit të mbajtura ashtu edhe kontratat me kushte rënduese jo të mbuluara nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura. Në raste të tilla, për të zbatuar paragrafin B95B njësia ekonomike do të përdorë një bazë shpërndarjeje sistematike dhe racionale për të përcaktuar pjesën e

përbërësit humbje të grupit të kontratave të sigurimit, që lidhen me kontratat e sigurimit të mbuluara nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura.

Aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit

B95E Nëse njësia ekonomike blen kontrata sigurimi të emetuara në një transferim të kontratave të sigurimit që nuk formojnë një biznes ose në një kombinim biznesi brenda objektit të SNRF 3, njësia ekonomike do të njohë një aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit me vlerën e drejtë në datën e transaksionit të të drejtave për të marrë:

(a) kontrata të ardhshme të sigurimit që janë rinovime të kontratave të sigurimit të njohura në datën e transaksionit; dhe

(b) kontrata të ardhshme sigurimi, të ndryshme nga ato në pikën (a), pas datës së transaksionit pa paguar përsëri flukset monetare të blerjes së sigurimit që blerësi ka paguar tashmë dhe që janë të ngarkueshme drejtpërdrejt tek portofoli përkatës i kontratave të sigurimit.

B95F Në datën e transaksionit, shuma e çdo aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit nuk do të përfshihet në matjen e grupit të blerë të kontratave të sigurimit duke zbatuar paragrafët B93–B95A.

Ndryshimet në vlerën kontabël (neto) të marzhit të kontraktuar të shërbimit për kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë(paragrafi 44)

B96 Për kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, paragrafi 44(c) kërkon rregullimin e marzhit të kontraktuar të shërbimit të një grupi kontratash sigurimi për ndryshimet në flukset monetare të realizuara që lidhen me shërbimin e ardhshëm. Këto ndryshime përfshijnë:

(a) rregullime për eksperiencën që vijnë nga primet e marra gjatë periudhës të lidhura me shërbimin e ardhshëm dhe flukset monetare përkatëse, të tilla si flukset monetare të blerjes së sigurimit dhe taksat e bazuara në prim, të matura me normën e skontimit të specifikuar në paragrafin B72(c).

(b) ndryshimet në vlerësimet e vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të detyrimit për mbulimin e mbetur, me përjashtim të atyre të përshkruara në paragrafin B97(a), të matur me normat e skontimit të specifikuara në paragrafin B72(c).

(c) diferencat mes çdo përbërësi investim që pritet të bëhet i pagueshëm gjatë periudhës dhe përbërësit aktual investim që bëhet i pagueshëm gjatë periudhës. Këto diferenca përcaktohen duke krahasuar (i) përbërësin aktual të investimit që bëhet i pagueshëm gjatë periudhës me (ii) pagesën gjatë periudhës që pritej të ishte në fillim të periudhës plus çdo të ardhur ose shpenzim financiar të sigurimit të lidhur me atë pagesë të pritshme para se të bëhet e detyrueshme për t'u paguar.

(ca) diferencat mes çdo huaje ndaj policë mbajtësit që pritet të bëhet e ripagueshme gjatë periudhës dhe huasë aktuale ndaj policë mbajtësit që bëhet e ripagueshme gjatë periudhës. Këto diferenca përcaktohen duke krahasuar (i) huanë aktuale ndaj një policë mbajtësi që bëhet e ripagueshme gjatë periudhës me (ii) ripagesën gjatë periudhës që pritej të ishte në fillim të periudhës plus çdo të ardhur ose shpenzim financiar të sigurimit të lidhur me atë ripagesë të pritshme para se të bëhet e detyrueshme për t'u ripaguar.

(d) ndryshimet në rregullimin për rrezikun jo-financiar që lidhen me shërbimin e ardhshëm. Nuk kërkohet që njësia ekonomike të zbërthejë ndryshimin në rregullimin e rrezikut për rrezikun jo-financiar mes (i) një ndryshimi të lidhur me rrezikun jo-financiar dhe (ii) efektit në kohë të parasë dhe ndryshimeve në vlerën në kohë të parasë. Nëse njësia ekonomike bën zbërthime të tilla, ajo duhet të rregullojë marzhin e kontraktuar të shërbimit për ndryshimin e lidhur me rrezikun jo-financiar, të matur me normat e skontimit të specifikuara në paragrafin B27(c).

B97 Njësia ekonomike nuk do ta rregullojë marzhin e kontraktuar të shërbimit për një grup kontratash sigurimi pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë për ndryshimet vijuese në flukset monetare të realizuara, sepse ato nuk lidhin me shërbimin e ardhshëm:

(a) efektin në vlerën në kohë të parasë dhe ndryshimet në vlerën në kohë të parasë si dhe efektin e rrezikut financiar dhe ndryshimeve në rrezikun financiar. Këto ndryshime përfshijnë:

(i) efektin, nëse ka, të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuara;

(ii) efektin, nëse zbërthehet, të rregullimit të rrezikut për rrezikun jo-financiar; dhe

(iii) efektin e ndryshimit në normën e skontimit.

 © Fondacioni i SNRF-ve

(b) ndryshimet në vlerësimet e flukseve monetare të realizuara të detyrimit për kërkesat shtesë të pësuara.

(c) rregullimet për eksperiencën, me përjashtim të atyre të përshkruara në paragrafin B96(a).

B98 Kushtet e disa kontratave të sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë,i japin njësisë ekonomike të drejtën (vullnetin) për të vendosur mbi flukset e mjeteve monetare që do t'i paguhen policë mbajtësit. Një ndryshim në këto flukse monetare të kontrolluara nga njësia, shihet si i lidhur me shërbimin e ardhshëm dhe për pasojë rregullon marzhin e kontraktuar të shërbimit. Për të përcaktuar sesi të identifikohet një ndryshim në këto flukse monetare të kontrolluara nga njësia ekonomike, kjo e fundit do të specifikojë në krijimin e e kontratës bazën mbi të cilën pret të përcaktojë angazhimin e saj në kontratë; për shembull, bazuar në një normë interesi fikse ose në kthimet që ndryshojnë bazuar në kthimet e aktiveve të caktuara.

B99 Njësia ekonomike do të përdorë atë specifikim për të dalluar mes efektit të ndryshimeve në supozimet që lidhen merr rrezikun financiar të atij angazhimi (që nuk rregullon marzhin e kontraktuar të shërbimit))dhe efektin e ndryshimeve sipas vullnetit të njësisë tek ai angazhim (i cili rregullon marzhin e kontraktuar të shërbimit).

B100 Nëse njësia ekonomike nuk mund të specifikojë në krijimin e kontratës pjesën që sheh si angazhim sipas kontratës dhe pjesën që sheh si në vullnetin e saj, ajo do ta shohë angazhimin si një kthim të qartë në vlerësimin e flukseve monetare të realizuara në krijimin e kontratës të përditësuar për të pasqyruar supozimet aktuale që lidhen me rrezikun financiar.

Ndryshimet në vlerën kontabël (neto) të marzhit të kontraktuar të shërbimit për kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë (paragrafi 45)

B101 Kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë janë kontrata sigurimi, të cilat në thelb janë kontrata shërbimi të lidhura me investimin sipas të cilave njësia ekonomike premton një kthim nga investimi bazuar në zërat bazë. Por, ato përkufizohen si kontrata sigurimi për të cilat:

(a) kushtet kontraktuale specifikojnë se policë mbajtësit marrin pjesë në ndarjen e një grupi zërash bazë të identifikueshëm qartë (shih paragrafët B105–B106);

(b) njësia ekonomike pret që të paguajë tek policë mbajtësi një shumë të barabartë me një pjesë të rëndësishme të vlerës së drejtë të kthimeve nga zërat bazë (shih paragrafin B107); dhe

(c) njësia ekonomike pret që një pjesë e konsiderueshme e çdo ndryshimi në shumat që do t'i paguhen tek policë mbajtësi të ndryshojë me ndryshimin në vlerën e drejtë të zërave bazë (shih paragrafin B107).

B102 Njësia ekonomike do të vlerësojë nëse plotësohen të gjitha kushtet e paragrafit B101 duke përdorur të gjitha pritshmëritë në krijimin e kontratës dhe nuk do të rivlerësojë më pas kushtet, me përjashtim të rastit kur kontrata modifikohet, duke zbatuar paragrafin 72.

B103 Në madhësinë që kontratat e sigurimit në një grup ndikojnë flukset monetare tek policë mbajtësit e kontratave në grupet e tjera(shih paragrafët B67–B71),njësia ekonomike do të vlerësojë nëse plotësohen kushtet në paragrafin B101 duke marrë në konsideratë flukset monetare që njësia pret t'u paguajë policë mbajtësve sipas kërkesave të paragrafëve B68–B70.

B104 Kushtet në paragrafin B101sigurojnë se kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë janë kontrata sipas të cilave detyrimi i njësisë ekonomike ndaj policë mbajtësit është vlera neto e:

(a) detyrimit për të paguar policë mbajtësin një shumë të barabartë me vlerën e drejtë të zërave bazë; dhe

(b) komisionit të ndryshueshëm (shih paragrafët B110–B118), të cilin njësia ekonomike do ta zbresë (a) në këmbim të një shërbimit të ardhshëm të ofruar nga kontrata e sigurimit që përfshin:

(i) shumën e pjesës së njësisë ekonomike në vlerën e drejtë të zërave bazë; minus

(ii) flukset monetare të realizuara të cilat nuk ndryshojnë sipas kthimeve në zërat bazë.

B105 Pjesa që citohet në paragrafin B101(a)nuk përjashton ekzistencën e vullnetit të lirë të njësisë ekonomike për të ndryshuar shumat e paguara tek policë mbajtësi. Por, lidhja me zërat bazë duhet të jetë detyruese (shih paragrafin 2).

B106 Grupi i zërave bazë i cituar në paragrafin B101(a)mund të përfshijë çdo zë, për shembull një portofol të referuar aktivesh, aktivet neto të njësisë ekonomike, ose një nëngrup i caktuar i aktiveve neto të njësisë ekonomike, për sa kohë që ato identifikohen qartë në kontratë. Njësia ekonomike nuk ka nevojë të mbajë

grupin e identifikuar të zërave bazë. Megjithatë, një grup i identifikuar qartë i zërave bazë nuk ekziston nëse:

(a) njësia ekonomike mund të ndryshojë zërat bazë që përcaktojnë shumën e detyrimit të njësisë ekonomike me efekt prapaveprues; ose

(b) nuk ka zëra bazë të identifikueshëm edhe nëse policë mbajtësit mund t'i sigurohet një kthim i cili zakonisht pasqyron performancën dhe pritshmëritë e përgjithshme të njësisë ekonomike, ose performancën dhe pritshmëritë për një nëngrup aktivesh që mban njësia ekonomike. Shembull i një kthimi të tillë është një normë kreditimi ose pagesë dividendi i caktuar në fund të periudhës së cilës i përket. Në këtë rast, detyrimi ndaj policë mbajtësit pasqyron normën e kreditimit ose shumat e dividendëve që ka caktuar njësia ekonomike dhe nuk pasqyron zërat bazë të identifikuar.

B107 Paragrafi B101(b) kërkon që njësia ekonomike të presë që një pjesë e rëndësishme e vlerës së drejtë të kthimeve nga zërat bazë t'i paguhet policë mbajtësit dhe paragrafi B101(c) kërkon që njësia ekonomike të presë që një pjesë e rëndësishme e ndonjë ndryshimi në shumat e pagueshme tek policë mbajtësi të ndryshojë me ndryshimin në vlerën e drejtë të zërave bazë. Njësia ekonomike do:

(a) të interpretojë termin 'e rëndësishme' në të dy paragrafët në kontekstin e objektivit të kontratave të sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejt, si kontrata me anë të të cilave njësia ekonomike ofron shërbime të lidhura me investimin dhe kompensohet për shërbimet me një komision që përcaktohet duke ju referuar zërave bazë; dhe

(b) të vlerësojë ndryshimin në shumat e paragrafëve B101(b) dhe B101(c):

(i) gjatë jetës së kontratës së sigurimit; dhe

(ii) bazuar në vlerën aktuale të ponderuar me probabilitetin, jo mbi bazën e rezultatit më të mirë apo më të keq(shih paragrafët B37–B38).

B108 Për shembull nëse njësia ekonomike pret të paguajë një pjesë të rëndësishme të vlerës së drejtë të kthimeve nga zërat bazë, subjekt i një garancie për një minimum kthimi, do të ketë situata në të cilat:

(a) flukset monetare që njësia ekonomike pret të paguajë tek policë mbajtësi, të ndryshojnë me ndryshimet në vlerën e drejtë të zërave bazë, sepse kthimi i garantuar dhe flukset e tjera monetare që nuk ndryshojnë sipas kthimeve në zërat bazë, nuk tejkalojnë vlerën e drejtë të kthimit nga zërat bazë; dhe

(b) flukset monetare që njësia ekonomike pret të paguajë tek policë mbajtësi nuk do të ndryshojnë me ndryshimet në vlerën e drejtë të zërave bazë, sepse kthimi i garantuar dhe flukset e tjera monetare që nuk ndryshojnë sipas kthimeve në zërat bazë, tejkalojnë vlerën e drejtë të kthimit nga zërat bazë.

Vlerësimi i njësisë ekonomike mbi ndryshimin në paragrafin B101(c) për këtë shembull do të pasqyrojë vlerën aktuale të mesatares së ponderuar me probabilitetin për të gjitha këto situata.

B109 Kontratat e sigurimit të emetuara dhe kontratat e sigurimit të mbajtura, nuk mund të jenë kontrata sigurimi me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë sipas SNRF 17.

B110 Për kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë,marzhi i kontraktuar i shërbimit rregullohet që të pasqyrojë natyrën e ndryshueshme të komisionit. Kështu, ndryshimet në shumat e paraqitura në paragrafin B104 trajtohen siç kërkohet në paragrafët B111–B114.

B111 Ndryshimet në detyrimin për t'i paguar policë mbajtësit një shumë të barabartë me vlerën e drejtë të zërave bazë(paragrafi B104(a)) nuk lidhen me shërbimin e ardhshëm dhe nuk rregullojnë marzhin e kontraktuar të shërbimit.

B112 Ndryshimet në madhësinë e pjesës së njësisë ekonomike, mbi vlerën e drejtë të zërave bazë (paragrafi B104(b)(i)) lidhen me shërbimin e ardhshëm dhe rregullojnë marzhin e kontraktuar të shërbimit, duke zbatuar paragrafin 45(b).

B113 Ndryshimet në flukset monetare të realizuara që nuk ndryshojnë sipas kthimeve të zërave bazë (paragrafi B104(b)(ii)) përfshijnë:

(a) ndryshimet në flukset monetare të realizuara të ndryshme nga ato të specifikuara në pikën (b). Njësia ekonomike do të zbatojë paragrafët B96–B97, në mënyrë të qëndrueshme për kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, për të përcaktuar se deri në ç'masë ato lidhen me shërbimin e ardhshëm dhe, në zbatim të paragrafit 45(c), për të rregulluar marzhin e kontraktuar të shërbimit. Të gjitha rregullimet maten duke përdorur normat aktuale të skontimit.

 © Fondacioni i SNRF-ve

(b) ndryshimin në efektin në kohë të parasë dhe rreziqet financiare që nuk vjen nga zërat bazë; për shembull, efekti i garancive financiare. Ato lidhen me shërbimin e ardhshëm dhe, në zbatim të paragrafit 45(c), rregullojnë marzhin e kontraktuar të shërbimit, me përjashtim të rastit kur gjen zbatim paragrafi B115.

B114 Nuk kërkohet që njësia ekonomike të identifikojë veçmas rregullimet e marzhit të kontraktuar të shërbimit kërkuar nga paragrafët B112 dhe B113. Por një shumë e vetme mund të përcaktohet për disa apo të gjitha rregullimet.

Zvogëlimi i rrezikut

B115 Në madhësinë që njësia ekonomike plotëson kushtet në paragrafin B116, ajo mund të zgjedhë të mos njohë një ndryshim në marzhin e kontraktuar të shërbimit për të pasqyruar disa apo të gjitha ndryshimet në efektin e vlerës në kohë të parasë dhe rrezikut financiar në:

(a) madhësinë e pjesës së njësisë ekonomike në zërat bazë (shih paragrafin B112) nëse ajo zvogëlon efektin e rrezikut financiar në atë shumë duke përdorur derivativë ose kontrata risigurimi të mbajtura; dhe

(b) flukset monetare të realizuara të paraqitura në paragrafin B113(b) nëse njësia ekonomike zvogëlon efektin e rrezikut financiar në ato flukse monetare të realizuara duke përdorur derivativë, instrumenta financiarë jo-derivativë të matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, apo kontrata risigurimi të mbajtura.

B116 Për të zbatuar paragrafin B115, njësia ekonomike duhet të ketë dokumentuar më parë objektivin dhe strategjinë për menaxhimin e rrezikut për zvogëlimin e rrezikut financiar të përshkruar në paragrafin B115. Duke zbatuar këtë objektiv dhe strategji:

(a) ekziston një kompensim ekonomik mes kontratave të sigurimit dhe derivativëve, instrumenteve financiarë jo-derivativë të matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, apo kontratat e risigurimit të mbajtuara (dmth vlerat e kontratave të sigurimit dhe të atyre zërave që zvogëlojnë rrezikun zakonisht lëvizin në drejtim të kundërt sepse u përgjigjen njëlloj ndryshimeve në rrezikun që zvogëlohet). Njësia ekonomike nuk do të marrë në konsideratë trajtimin kontabël të matjes së diferencave gjatë vlerësimit të kompensimit ekonomik.

(b) rreziku i kredisë nuk dominon kompensimin ekonomik.

B117 Njësia ekonomike do të përcaktojë flukset monetare të realizuara në një grup për të cilin zbatohet në mënyrë të qëndrueshme paragrafi B115 në çdo periudhë raportimi.

B117A Nëse njësia ekonomike zvogëlon efektin e rrezikut financiar duke përdorur derivativë ose instrumente financiarë jo-derivativë të matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, ajo duhet të përfshijë të ardhurën ose shpenzimet financiare të sigurimit për periudhën që vjen nga zbatimi i paragrafëve B115 në fitim ose humbje (rezultatin e periudhës). Nëse njësia ekonomike zvogëlon efektin e rrezikut financiar duke përdorur kontratat e risigurimit të mbajtura, ajo duhet të zbatojë të njëjtën politikë kontabël për paraqitjen e të ardhurës apo shpenzimeve financiare të sigurimit që vijnë nga zbatimi i paragrafit B115 sikur njësia të zbatonte kontratat e risigurimit të mbajtuara në zbatim të paragrafëve 88 dhe 90.

B118 Nëse dhe vetëm nëse, pushojnë së plotësuari ndonjë nga kushtet e paragrafit B116, njësia ekonomike do të ndalojë zbatimin e paragrafit B115 nga ajo datë. Njësia ekonomike nuk do të bëjë asnjë rregullim për ndryshimet e njohura më parë në rezultat.

Njohja e marzhit të kontraktuar të shërbimit në fitim ose humbje (rezultat)

B119 Një pjesë e marzhit të kontraktuar të shërbimit për një grup kontratash sigurimi njihet në fitimin ose humbjen e secilës periudhë për të pasqyruar shërbimin e kontratave të sigurimit të ofruar sipas grupit të kontratave të sigurimit në atë periudhë (shih paragrafët 44(e), 45(e) dhe 66(e)). Shuma përcaktohet duke:

(a) identifikuar njësitë e mbuluara në grup. Numri i njësive të mbuluara në grup është sa sasia e shërbimeve të kontratës së sigurimit të ofruara nga kontratat në grup, të përcaktuara duke marrë në konsideratë për secilën kontratë sasinë e përfitimeve të ofruara sipas kontratës dhe periudhën e pritshme të mbulimit të saj.

(b) shpërndarë marzhin e kontraktuar të shërbimit në fund të periudhës (para njohjes së ndonjë shume në fitim apo humbje për të pasqyruar shërbimet e kontratës së sigurimit të ofruara gjatë periudhës) në mënyrë të barabartë për çdo njësi mbulimi të ofruar në periudhën aktuale dhe që pritet të ofrohet në të ardhmen.

(c) njohur në fitim ose humbje shumën e shpërndarë tek njësitë e mbulimit të ofruara gjatë periudhës.

B119A Për të zbatuar paragrafin B119, periudha e shërbimit kthim investimi ose shërbimit të lidhur me investimin përfundon në datën ose më parë se data kur të gjitha shumat për t'u paguar policë mbajtësit aktual lidhur me ato shërbime i janë paguar, pa marrë në konsideratë pagesat tek policë mbajtësit e ardhshëm të përfshirë në flukset monetare të realizuara duke zbatuar paragrafin B68.

B119B Kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë mund të ofrojnë një shërbim kthimi investimi, vetëm dhe vetëm nëse:

(a) ekziston përbërësi investim, ose policë mbajtësi ka të drejtë të tërheqë shumën;

(b) njësia ekonomike pret që përbërësi investim ose shuma që ka të drejtë të tërheqë policë mbajtësi, të përfshihet në kthimin nga investimi (një kthim investimi mund të jetë negativ, për shembull në një mjedis me norma negative interesi); dhe

(c) njësia ekonomike pret të realizojë aktivitet investimi për të gjeneruar kthim nga investimi.

Kontratat e risigurimit të mbajtuara—të njohura në humbje të rikuperuara nga kontratat e sigurimit bazë (paragrafët 66A−66B)

B119C Paragrafi 66A zbatohet nëse dhe vetëm nëse, kontrata e risigurimit e mbajtur hyn në fuqi para ose në të njëjtën kohë me njohjen e kontratave të sigurimit bazë me kushte rënduese.

B119D Për të zbatuar paragrafin 66A, njësia ekonomike do të përcaktojë rregullimin e marzhit të kontraktuar të shërbimit të një grupi kontratash risigurimi të mbajtuara dhe të ardhurën që rezulton duke shumëzuar:

(a) humbjen e njohur në kontratat e sigurimit bazë; dhe

(b) përqindjen e kërkesave shtesë mbi kontratat e sigurimit bazë që njësia ekonomike pret të rikuperojë nga grupi i kontratave risigurimit të mbajtura.

B119E Duke zbatuar paragrafët 14–22, njësia ekonomike mund të përfshijë në një grup me kushte rënduese të kontratave të sigurimit, si kontratat e sigurimit me kushte rënduese të mbuluara nga një grup i kontratave të risigurimit të mbajtura ashtu edhe kontratat me kushte rënduese jo të mbuluara nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura. Në raste të tilla, për të zbatuar paragrafët 66(c)(i)–(ii) dhe paragrafin 66A, njësia ekonomike do të përdorë një bazë shpërndarjeje sistematike dhe racionale për të përcaktuar pjesën e humbjes të njohur nga një grup kontratash sigurimi që lidhen me kontratat e sigurimit të mbuluara nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura.

B119F Pasi njësia ekonomike ka krijuar përbërësin rikuperim humbjeje duke zbatuar paragrafin 66B, ajo do të rregullojë përbërësin rikuperim humbjeje për të pasqyruar ndryshimet në përbërësin humbje të një grupi me kushte rënduese të kontratave të sigurimit bazë (shih paragrafët 50–52). Vlera kontabël (neto) e përbërësit rikuperim humbje nuk duhet të tejkalojë pjesën e vlerës kontabël (neto) të përbërësit humbje të grupit me kushte rënduese të kontratave të sigurimit bazë që njësia ekonomike pret të rikuperojë nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura.

Të ardhurat nga sigurimi (paragrafët 83 dhe 85)

B120 Të ardhurat totale nga sigurimi për një grup kontratash sigurimi janë konsiderata për kontratat, d.m.th shuma e primeve të paguara ndaj njësisë ekonomike:

(a) e rregulluar për efektin financues; dhe

(b) duke përjashtuar çdo përbërës investim.

B121 Paragrafi 83 kërkon që shuma e të ardhurave nga sigurimi të njohura gjatë periudhës të përfshijë transferimin e shërbimeve të premtuara në një shumë e cila pasqyron konsideratën, që njësia ekonomike pret të marrë në këmbim të këtyre shërbimeve. Totali i konsideratës për një grup kontratash mbulon shumat në vijim:

(a) shumat e lidhura me dhënien e shërbimit, duke përfshirë:

(i) shpenzimet për shërbimin e sigurimit, duke përfshirë çdo shumë që lidhet me rregullimin e rrezikut për rrezikun jo financiar të përfshirë në pikën (ii) dhe çdo shumë të shpërndarë tek përbërësi humbje i detyrimit për mbulimin e mbetur;

(ia) shumat e lidhura me tatimin mbi të ardhurat, të cilat mund t'i ngarkohen në mënyrë specifike policë mbajtësit;

 © Fondacioni i SNRF-ve

(ii) rregullimin për rrezikun jo-financiar, përjashtuar çdo shumë të shpërndarë tek përbërësi humbje i detyrimit për mbulimin e mbetur; dhe

(iii) marzhin e kontraktuar të shërbimit.

(b) shumat e lidhura me flukset monetare të blerjes së sigurimit.

B122 Të ardhurat nga sigurimi për një periudhë, të lidhur me shumat e përshkruara në paragrafin B121(a) përcaktohen nga sa paraqitet në paragrafët B123–B124. Të ardhurat nga sigurimi për një periudhë, të lidhur me shumat e përshkruara në paragrafin B121(b) përcaktohen nga sa paraqitet në paragrafin B125.

B123 Gjatë zbatimit të SNRF 15, kur një njësi ekonomike ofron shërbime, ajo çregjistron detyrimin për performancën e atyre shërbimeve dhe njeh të ardhurat. Në vijim, gjatë zbatimit të SNRF 17, kur njësia ekonomike ofron shërbime gjatë një periudhe ajo pakëson detyrimin për mbulimin e mbetur për shërbimin e ofruar dhe njeh të ardhurat nga sigurimi. Pakësimi i detyrimit për mbulimin e mbetur që sjell të ardhurat nga sigurimi, përjashton ndryshimet në detyrim që nuk lidhen me shërbimet e pritshme për t'u mbuluar nga konsiderata e marrë nga njësia ekonomike. Këto ndryshime janë:

(a) ndryshimet që nuk lidhen me shërbimin e ofruar gjatë periudhës, për shembull:

(i) ndryshimet që vijnë nga flukset monetare të primeve të marra;

(ii) ndryshimet që lidhen me përbërësit investime gjatë periudhës;

(iia) ndryshimet që vijnë nga flukset monetare të huave ndaj policë mbajtësve;

(iii) ndryshimet që lidhen me taksat e bazuar në transaksione, të mbledhura për llogari të palëve të treta (të tilla si taksat mbi primet, tatimi mbi vlerën e shtuar dhe taksat mbi mallrat apo shërbimet) (shih paragrafin B65(i));

(iv) të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit;

(v) flukset e mjeteve monetare të blerjes së sigurimit(shih paragrafin B125); dhe

(vi) mosnjohja (çregjistrimi) e detyrimeve të transferuara tek një palë e tretë.

(b) ndryshimet që lidhen me shërbimin, por për të cilat njësia ekonomike nuk pret konsideratë, d.m.th rritjet dhe pakësimet në përbërësin humbje të detyrimit për mbulimin e mbetur (shih paragrafët 47–52).

B123A Në masën që njësia ekonomike çregjistron një aktiv për flukset monetare të ndryshme nga flukset monetare të blerjes së sigurimit në datën e njohjes fillestare të një grupi kontratash sigurimi (shih paragrafët 38(c)(ii) dhe B66A), ajo duhet të njohë të ardhurat dhe shpenzimet nga sigurimi për shumën e çregjistruar në atë datë.

B124 Për pasojë, të ardhurat nga sigurimi për periudhën mund të analizohen edhe si total i ndryshimeve në detyrimin për mbulimin e mbetur gjatë periudhës, që lidhet me shërbimet për të cilat njësia ekonomike pret të marrë një konsideratë. Këto ndryshime janë:

(a) shpenzimet e shërbimit të sigurimit të ndodhura gjatë periudhës (të matura me shumat e pritshme në fillim të periudhës), duke përjashtuar:

(i) shumat e shpërndara tek përbërësi humbje i detyrimit për mbulimin e mbetur, duke zbatuar paragrafin 51(a);

(ii) ripagesat e përbërësve investime;

(iii) shumat që lidhen me taksat e bazuar në transaksione, të mbledhura për llogari të palëve të treta (të tilla si taksat mbi primet, tatimi mbi vlerën e shtuar dhe taksat mbi mallrat apo shërbimet) (shih paragrafin B65(i));

(iv) shpenzimet e blerjes së sigurimit(shih paragrafin B125); dhe

(v) shumën e lidhur me rregullimin e rrezikut për rrezikun jo-financiar (shih pikën (b)).

(b) ndryshimi në rregullimin për rrezikun jo-financiar, duke përjashtuar:

(i) ndryshimet në të ardhurat ose shpenzimet financiare nga sigurimi, duke zbatuar paragrafin 87;

(ii) ndryshimet që rregullojnë marzhin e kontraktuar të shërbimit sepse lidhen me shërbimin e ardhshëm, duke zbatuar paragrafët 44(c) dhe 45(c); dhe

(iii) shumat e shpërndara tek përbërësi humbje i detyrimit për mbulimin e mbetur, duke zbatuar paragrafin 51(b).

(c) shumat e marzhit të kontraktuar të shërbimit të njohur në rezultatin e periudhës, duke zbatuar paragrafët 44(e) dhe 45(e).

(d) shumat e tjera, nëse ka, për shembull rregullimet për eksperiencë për primet e marra të ndryshme nga ato që lidhen me shërbimin e ardhshëm (shih paragrafin B96(a)).

B125 Njësia ekonomike do të përcaktojë të ardhurat nga sigurimi të lidhura me flukset monetare të blerjes së sigurimit, duke shpërndarë pjesën e primeve që lidhen me rikuperimin e këtyre flukseve monetare me secilën periudhë raportuese mbi baza sistematike, me kalimin e kohës. Njësia ekonomike do ta njohë të njëjtën shumë si shpenzim nga shërbimi i sigurimit.

B126 Nëse njësia ekonomike zbaton metodën e shpërndarjes së primit në paragrafët 55–58, e ardhura nga sigurimi për periudhën është shuma e arkëtimeve të pritshme nga primet (duke përjashtuar çdo përbërës investim dhe duke e rregulluar për të pasqyruar vlerën në kohë të parasë dhe efektin e rrezikut financiar, nëse është e mundur, duke zbatuar paragrafin 56) që i takon (shpërndahet) periudhës. Njësia ekonomike do të shpërndajë arkëtimet e pritshme të primeve tek secila periudhë e shërbimeve të kontratës së sigurimit:

(a) bazuar në kalimin e kohës; por

(b) nëse modeli i pritshëm i lirimit nga rreziku gjatë periudhës së mbulimit ndryshon ndjeshëm me kalimin e kohës, atëherë bazuar në kohën e pritshme të ndodhjes së shpenzimeve për shërbimin e sigurimit.

B127 Njësia ekonomike do të ndryshojë bazën e shpërndarjes nga paragrafi B126(a) tek B126(b) dhe anasjelltas, sipas nevojës nëse ndryshojnë faktet dhe rrethanat.

Të ardhura ose shpenzime financiare nga sigurimi (paragrafët 87–92)

B128 Paragrafi 87 kërkon që njësia ekonomike të përfshijë në të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit efektin e vlerës në kohë të parasë dhe të rrezikut financiar, si dhe ndryshimet brenda tyre. Sipas SNRF 17:

(a) supozimet rreth inflacionit të bazuara në një indeks çmimesh apo normash, ose mbi çmime aktivesh me kthime të lidhura me inflacionin, janë supozime që lidhen me rrezikun financiar;

(b) supozimet rreth inflacionit të bazuara në pritshmërinë e njësisë ekonomike për ndryshime të caktuara në çmime nuk janë supozime që lidhen me rrezikun financiar; dhe

(c) ndryshimet në matjen e një grupi kontratash sigurimi të shkaktuara nga ndryshimet në vlerën e zërave bazë (duke përjashtuar shtesat dhe tërheqjet) janë ndryshime që vijnë nga efekti i vlerës në kohë të parasë dhe i rrezikut financiar, si dhe ndryshimet brenda tyre.

B129 Paragrafët 88–89 kërkojnë që njësia ekonomike të zgjedhë si politikë kontabël nëse do të zbërthejë të ardhurat ose shpenzimet financiare nga sigurimi për periudhën mes rezultatit të periudhës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Njësia ekonomike do të zbatojë politikën e saj kontabël të zgjedhur për portofolin e kontratave të sigurimit. Gjatë vlerësimit të politikës së duhur kontabël për portofolin e kontratave të sigurimit, duke zbatuar paragrafin 13 të SNK 8 *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë për çdo portofol, aktivet që njësia mban dhe sesi i trajton ajo këto aktive.

B130 Nëse zbatohet paragrafi 88(b), njësia ekonomike do të përfshijë në fitim ose humbje një shumë të përcaktuar nga shpërndarja sistematike e të ardhurës apo shpenzimit total financiar të pritshëm nga sigurimi gjatë jetës së grupit të kontratave të sigurimit. Në këtë kontekst, shpërndarja sistematike është shpërndarja e totalit të pritshëm të të ardhurës apo shpenzimit financiar nga sigurimi gjatë jetës së grupit që:

(a) bazohet në karakteristikat e kontratave, pa i'u referuar faktorëve që nuk ndikojnë flukset monetare të pritshme për të vijuar sipas kontratave. Për shembull, shpërndarja e të ardhurave ose shpenzimeve financiare nuk do të bazohet në kthimet e njohura të pritshme nga aktivet nëse këto kthime të njohura të pritshme nuk ndikojnë flukset monetare në kontratat e grupit.

(b) rezultojnë në shuma të njohura në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse gjatë jetës së grupit të kontratave me totalin zero. Shuma e akumuluar e njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në çdo datë është diferenca mes vlerës kontabël (neto) të grupit të kontratave dhe shumës me të cilën do të matej grupi nëse zbatohej shpërndarja sistematike.

B131 Për grupet e kontratave të sigurimit për të cilat ndryshimet në supozimet që lidhen me rrezikun financiar nuk kanë një efekt të rëndësishëm në shumat e paguara tek policë mbajtësi, shpërndarja sistematike përcaktohet duke përdorur normat e skontimit të specifikuara në paragrafin B72(e)(i).

B132 Për grupet e kontratave të sigurimit për të cilat ndryshimet në supozimet që lidhen me rrezikun financiar kanë një efekt të rëndësishëm në shumat e paguara tek policë mbajtësit:

 © Fondacioni i SNRF-ve

(a) shpërndarja sistematike e të ardhurave ose shpenzimeve financiare që vijnë nga vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme, mund të përcaktohet në një nga mënyrat në vijim:

(i) duke përdorur një normë që shpërndan të ardhurat ose shpenzimet financiare të pritshme, të rishikuara dhe të mbetura, gjatë jetës së mbetur të grupit të kontratave me një normë konstante; ose

(ii) për kontratat që përdorin një normë kreditimi për të përcaktuar shumat ndaj policë mbajtësve—duke përdorur një shpërndarje të bazuar në shumat e krediturara gjatë periudhës dhe që priten të kreditohen në periudhat e ardhshme.

(b) një shpërndarje sistematike e të ardhurave ose shpenzimeve financiare që vijnë nga rregullimi për rrezikun jo-financiar, nëse është e zbërthyer veçmas nga ndryshimet e tjera në rregullimin për rrezikun jo-monetar duke zbatuar paragrafin 81, përcaktohet duke përdorur një shpërndarje në përputhje me atë të përdorur për shpërndarjen e të ardhurave ose shpenzimeve financiare që vijnë nga flukset monetare të ardhshme.

(c) një shpërndarje sistematike për të ardhurat ose shpenzimet financiare që vijnë nga marzhi i kontraktuar i shërbimit përcaktohet:

(i) për kontratat e sigurimit që nuk kanë tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, duke përdorur normat e skontimit të specifikuara në paragrafin B72(b); dhe

(ii) për kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, duke përdorur një shpërndarje në përputhje me atë të përdorur për shpërndarjen e të ardhurave ose shpenzimeve financiare që vijnë nga flukset monetare të ardhshme.

B133 Kur zbatohet metoda e shpërndarjes së primit për kontratat e sigurimit të përshkruara në paragrafët 53–59, njësisë ekonomike mund t'i duhet ose mund të zgjedhë të skontojë detyrimin për kërkesat shtesë të pësuara. Në të tilla raste, ajo mund të zgjedhë të zbërthejë të ardhurat ose shpenzimet financiare nga sigurimi duke zbatuar paragrafin 88(b). Nëse njësia ekonomike bën këtë zgjedhje, ajo do të përcaktojë të ardhurat ose shpenzimet financiare nga sigurimi në rezultatin e periudhës duke zbatuar normën e skontimit të specifikuar në paragrafin B72(e)(iii).

B134 Paragrafi 89 zbatohet nëse njësia ekonomike, zgjedh ose është e detyruar të mbajë zërat bazë për kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë. Nëse njësia ekonomike zgjedh të zbërthejë të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit duke zbatuar paragrafin 89(b), ajo do të përfshijë në rezultatin e periudhës shpenzime ose të ardhura që përputhen ekzaktësisht me të ardhurat ose shpenzimet e përfshira në rezultat nga zërat bazë, duke sjellë që efekti neto i zërave të paraqitur veçmas të jetë zero.

B135 Njësia ekonomike mund të plotësojë kërkesat në paragrafin 89 për zgjedhjen e politikës kontabël në disa periudha, por mund të mos i plotësojë në periudhat e tjera për shkak të një ndryshimi nëse i mban zërat bazë. Nëse ndodh një ndryshim i tillë, zgjedhja e politikës kontabël në dispozicion të njësisë ekonomike ndryshon nga ajo e paraqitur në paragrafin 88 në atë të paraqitur në paragrafin 89 dhe anasjelltas. Kështu njësia ekonomike mund të ndryshojë politikën e saj kontabël mes asaj të paraqitur në paragrafin 88(b) dhe asaj të paraqitur në paragrafin 89(b). Kur bën një ndryshim të tillë, njësia ekonomike do të:

(a) përfshijë shumën e akumuluar më parë të përfshirë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse nga data e ndryshimit si një rregullim riklasifikimi në fitimin ose humbjen e periudhës së ndryshimit dhe në periudhat e ardhshme si vijon:

(i) nëse njësia ekonomike ka zbatuar më parë paragrafin 88(b)—njësia do të përfshijë në rezultatin e periudhës shumën e akumuluar të përfshirë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse para ndryshimit njëlloj sikur njësia ekonomike të ishte duke vijuar qasjen e paragrafit 88(b) të bazuar në supozimet e zbatueshme menjëherë para ndryshimit; dhe

(ii) nëse njësia ekonomike ka zbatuar më parë paragrafin 89(b)—njësia do të përfshijë në rezultatin e periudhës shumën e akumuluar të përfshirë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse para ndryshimit njëlloj sikur njësia ekonomike të ishte duke vijuar qasjen e paragrafit 89(b) të bazuar në supozimet e zbatueshme menjëherë para ndryshimit.

(b) nuk do të riparaqesë informacion krahasues për periudhën e mëparshme.

B136 Kur zbaton paragrafin B135(a), njësia ekonomike nuk do të rillogarisë shumën e akumuluar të përfshirë më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse njëlloj sikur zbërthimi i ri të ishte zbatuar edhe më parë; dhe supozimet e përdorura për riklasifikimin në periudhat e ardhshme nuk do të përditësohen pas datës së ndryshimit.

Efekti i vlerësimeve kontabël në pasqyrat financiare të ndërmjetme

B137 Nëse njësia ekonomike përgatit pasqyra financiare të ndërmjetme duke zbatuar SNK 34 *Raportimi financiar i ndërmjetëm,* njësia ekonomike do të zgjedhë një politikë kontabël njëlloj sikur të ndryshonte trajtimin e vlerësimeve kontabël të bëra në pasqyrat financiare të ndërmjetme të mëparshme duke zbatuar SNRF 17 në pasqyrat financiare të ndërmjetme të mëpasshme dhe në periudhën vjetore raportuese. Njësia ekonomike do të zbatojë zgjedhjen e saj për politikën kontabël tek të gjitha grupet e kontratave të sigurimit të emetuara prej saj dhe grupet e kontratave të risigurimit që ajo mban.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Shtojca C
Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF 17 Kontratat e sigurimit.

Data e hyrjes në fuqi

C1 Njësia ekonomike do ta zbatojë këtë Standard për periudhat vjetore raportuese që fillojnë më 1 janar 2023 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNRF 17 për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Lejohet zbatimi më i hershëm për njësitë ekonomike që zbatojnë SNRF 9 *Instrumentet financiarë* në datën e zbatimit për herë të parë të SNRF 17 ose më parë.

C2 Për shkak të kërkesave në paragrafët C1dhe C3–C33 për periudhën kalimtare:

(a) data e zbatimit fillestar është fillimi i periudhës vjetore të raportimit në të cilën njësia ekonomike zbaton për herë të parë SNRF 17; dhe

(b) data e tranzicionit është fillimi i periudhës vjetore raportuese menjëherë para datës së zbatimit fillestar.

C2A *Zbatimi për Herë të Parë i SNRF 17 dhe i SNRF 9—Informacioni krahasues*, i publikuar në dhjetor 2021, shtoi paragrafët C28A–C28E dhe C33A. Njësia ekonomike që zgjedh të zbatojë paragrafët C28A–C28E dhe C33A duhet t'i zbatojë ato në aplikimin fillestar të SNRF 17.

C2B SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* i publikuar në prill 2024 ndryshoi paragrafët 91, 96, 103 dhe B129. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 18.

Periudha kalimtare

C3 Me përjashtim të rastit kur është i pazbatueshëm, ose kur zbatohet paragrafi C5A, njësia ekonomike duhet të zbatojë SNRF 17 në mënyrë retrospektive, me përjashtim të sa vijon:

(a) njësisë ekonomike nuk i kërkohet të paraqesë informacionin sasior të kërkuar nga paragrafi 28(f) i SNK 8 *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*[2] ose për njësitë ekonomike që zbatojnë SNRF 19 *Filialet pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese*, nga paragrafi 178(f) i SNRF 19; dhe

(b) njësia ekonomike nuk do të zbatojë opsionin në paragrafin B115 për periudha raportuese përpara datës së tranzicionit. Njësia ekonomike mund të zbatojë opsionin në paragrafin B115 në mënyrë prospektive në datën e periudhës kalimtare ose më pas nëse dhe vetëm nëse, ajo përcakton marrëdhëniet e zvogëlimit të rrezikut në atë datë që zbaton opsionin ose më parë.

C4 Për të zbatuar në mënyrë retrospektive SNRF 17, në datën e tranzicionit njësia ekonomike do të:

(a) identifikojë, njohë dhe masë secilin grup të kontratave të sigurimit njëlloj sikur SNRF 17 të ishte zbatuar edhe më parë;

(aa) identifikojë, njohë dhe masë çdo aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit sikur SNRF 17 të ishte zbatuar gjithmonë (me përjashtimin se njësisë ekonomike nuk i kërkohet të zbatojë vlerësimin e rikuperimit të paragrafit 28E para datës së tranzicionit);

(b) çregjistrojë çdo tepricë ekzistuese e cila nuk do të ekzistonte sikur SNRF 17 të ishte zbatuar gjithmonë; dhe

(c) njohë çdo diferencë që rezulton në kapitalin neto.

C5 Vetëm dhe vetëm nëse, për njësinë ekonomike është i pamundur zbatimi i paragrafit C3 për një grup kontratash sigurimi, njësia ekonomike do të zbatojë qasjet në vijim në vend të zbatimit të paragrafit C4(a):

(a) metoda e retrospektivës së modifikuar e paragrafëve C6–C19A, subjekt i paragrafit C6(a); ose

(b) metodën e vlerës së drejtë të paragrafëve C20–C24B.

---

[2] Kur publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* në prill 2024, BSNK ndryshoi titullin e SNK 8 në *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*.

C5A Pavarësisht paragrafit C5, njësia ekonomike mund të zgjedhë të zbatojë metodën e vlerës së drejtë të paragrafëve C20–C24B për një grup kontratash sigurimi me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë për të cilat mund të zbatojë SNRF 17 në mënyrë retrospektive, vetëm dhe vetëm nëse:

(a) njësia ekonomike zgjedh të zbatojë opsionin e zvogëlimit të rrezikut në paragrafin B115 tek grupi i kontratave të sigurimit në mënyrë prospektive nga data e tranzicionit; dhe

(b) njësia ekonomike ka përdorur derivativë, instrumente financiarë jo-derivativë të matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, ose kontrata risigurimi të mbajtura për të zvogëluar rrezikun financiar që vjen nga grupi i kontratave të sigurimit, siç specifikohet në paragrafin B115, para datës së tranzicionit.

C5B Nëse dhe vetëm nëse nuk është e mundur që njësia ekonomike të zbatojë paragrafin C4(aa) për një aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit, njësia ekonomike do të zbatojë qasjet në vijim për matjen e aktivit për flukset monetare të blerjes së sigurimit:

(a) metodën e retrospektivës së modifikuar e paragrafëve C14B–C14D dhe C17A, subjekt i paragrafit C6(a); ose

(b) modelin e vlerës së drejtë në paragrafët C24A–C24B.

Metoda retrospektive e modifikuar

C6 Objektivi i metodës retrospektive të modifikuar është arritja e një rezultati sa më afër zbatimit retrospektiv të mundshëm, duke përdorur informacionin e arsyeshëm dhe mbështetës në dispozicion pa kosto apo përpjekje të papërshtatshme. Prandaj kur zbaton këtë metodë njësia ekonomike do:

(a) të përdorë informacion të arsyeshëm dhe mbështetës. Nëse njësia ekonomike nuk mund të marrë informacionin e arsyeshëm dhe mbështetës të nevojshëm për zbatimin e metodës së retrospektivës së modifikuar, ajo do të zbatojë metodën e vlerës së drejtë.

(b) të maksimizojë përdorimin e informacionit që do të ishte përdorur për të zbatuar një metodë retrospektive të plotë, por i nevojitet të përdorë vetëm informacionin në dispozicion pa kosto apo përpjekje të papërshtatshme.

C7 Në paragrafët C9–C19A paraqiten modifikimet e lejuara për zbatimin retrospektiv në fushat në vijim:

(a) vlerësimet që do të ishin bërë në datën e krijimit ose të njohjes fillestare të kontratave të sigurimit ose grupeve të kontratave të sigurimit;

(b) shumat e lidhura me marzhin e kontraktuar të shërbimit ose përbërësin humbje për kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë;

(c) shumat e lidhura me marzhin e kontraktuar të shërbimit ose përbërësin humbje për kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë; dhe

(d) të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit.

C8 Për të arritur objektivin e metodës së retrospektivës së modifikuar, lejohet që njësia ekonomike të përdorë secilin prej modifikimeve në paragrafët C9–C19A vetëm nëse njësia ekonomike nuk ka informacion të arsyeshëm e mbështetës, të mjaftueshëm për të zbatuar metodën retrospektive.

Vlerësimet në krijimin apo në njohjen fillestare

C9 Përsa lejohet nga paragrafi C8, njësia ekonomike do të përcaktojë çështjet në vijim duke përdorur informacionin në dispozicion në datën e tranzicionit:

(a) sesi të identifikojë grupet e kontratave të sigurimit, duke zbatuar paragrafët 14–24;

(b) nëse një kontratë sigurimi plotëson përkufizimin e kontratës së sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, duke zbatuar paragrafët B101–B109;

(c) sesi të identifikojë flukset monetare sipas vullnetit të njësisë ekonomike për kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, duke zbatuar paragrafët B98–B100; dhe

(d) nëse një kontratë investimi plotëson përkufizimin e një kontrate investimi me tipare të pjesëmarrjes së lirë brenda objektit të SNRF 17, duke zbatuar paragrafin 71.

C9A Në masën e lejuar nga paragrafin C8, njësia ekonomike do të klasifikojë si detyrim për kërkesat shtesë të pësuara një detyrim për shlyerjen e kërkesave shtesë para se një kontratë sigurimi të ishte blerë në një transferim kontratash sigurimi që nuk formojnë një biznes ose në një kombinim biznesi brenda objektit të SNRF 3.

 © Fondacioni i SNRF-ve

C10 Për sa lejohet nga paragrafi C8, njësia ekonomike nuk do të zbatojë paragrafin 22 për të ndarë grupet në grupe që nuk përfshijnë kontratat të emetuara përtej një viti nga njëra tjetra.

Përcaktimi i marzhit të kontraktuar të shërbimit ose përbërësit humbje për grupet e kontratave të sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë

C11 Për sa lejohet nga paragrafi C8, për kontratat pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, njësia ekonomike në datën e tranzicionit duhet të përcaktojë marzhin e kontraktuar të shërbimit ose përbërësin humbje të detyrimit për mbulimin e mbetur(shih paragrafët 49–52) duke zbatuar paragrafët C12–C16C.

C12 Për sa lejohet nga paragrafi C8, njësia ekonomike do të vlerësojë flukset monetare të ardhshme në datën e njohjes fillestare të një grupi kontratash sigurimi si shumë e flukseve monetare të ardhshme në datën e tranzicionit (ose të një date më të hershme, nëse flukset monetare të ardhshme në atë datë më të hershme mund të përcaktohen në mënyrë retrospektive duke zbatuar paragrafin C4(a)), të rregulluar për flukset e mjeteve monetare që janë të njohura si të ndodhura mes datës së njohjes fillestare të një grupi kontratash sigurimi dhe datës së tranzicionit (ose datës më të hershme). Flukset e mjeteve monetare që janë të njohura si të ndodhura përfshijnë flukset monetare që vijnë nga kontratat që kanë pushuar së ekzistuari para datës së tranzicionit.

C13 Për sa lejohet nga paragrafi C8, njësia ekonomike do të përcaktojë normat e skontimit të zbatueshme në datën e njohjes fillestare të një grupi kontratash sigurimi (ose më pas):

(a) duke përdorur kurbën e normave të vrojtueshme, që për të paktën tre vitet paraprirës të datës së tranzicionit përafron kurbën e normave të vlerësuar duke zbatuar paragrafët 36 dhe B72–B85,nëse një kurbë e tillë e vrojtueshme ekziston.

(b) nëse nuk ekziston kurba e normave të vrojtueshme e paragrafit (a), vlerëson normat e skontimit të zbatueshme në datën e njohjes fillestare (ose më pas) duke përcaktuar një marzh mesatar mes kurbës së vrojtueshme dhe kurbës së normave të vlerësuara, duke zbatuar paragrafët 36 si dhe B72–B85, duke zbatuar këtë marzh ndaj kurbës së normave të vrojtueshme. Ky marzh do të jetë një mesatare gjatë tre viteve paraprirëse të datës së tranzicionit.

C14 Përsa lejohet nga paragrafi C8, njësia ekonomike do të përcaktojë rregullimin për rrezikun jo-financiar në datën e njohjes fillestare të një grupi kontratash sigurimi (ose më pas), duke sistemuar rregullimin për rrezikun jo-financiar në datën e tranzicionit me lirimin e pritshëm nga rreziku para datës së tranzicionit. Lirimi i pritur nga rreziku do të përcaktohet duke ju referuar lirimit nga rreziku për kontratat e ngjashme të sigurimit,që njësia ekonomike emeton në datën e tranzicionit.

C14A Duke zbatuar paragrafin B137, njësia ekomomike mund të zgjedhë të mos ndryshojë vlerësimin kontabël të bërë në pasqyrat financiare të ndërmjetme të mëparshme. Në masën e lejuar nga paragrafi C8, një njësi e tillë ekonomike do të përcaktojë marzhin e kontraktuar të shërbimit ose përbërësin humbje në datën e tranzicionit sikur ajo të mos kishte përgatitur pasqyra financiare të ndërmjetme para datës së tranzicionit.

C14B Në masën e lejuar nga paragrafi C8, njësia ekonomike do të përdorë të njëjtë metodën sistematike dhe racionale që ajo pret të përdorë pas datës së tranzicionit kur zbaton paragrafin 28A për të shpërndarë çdo fluks monetar të blerjes së sigurimit të paguar (ose për të cilën është njohur një detyrim në zbatim të një SNRF tjetër) para datës së tranzicionit (duke përjashtuar çdo shumë të lidhur me kontratat e sigurimit që pushojnë së ekzistuari në datën e tranzicionit) tek:

(a) grupet e kontratave të sigurimit të njohura në datën e tranzicionit; dhe

(b) grupet e kontratave të sigurimit që pritet të njihen pas datës së tranzicionit.

C14C Flukset monetare të blerjes së sigurimit të paguara para datës së tranzicionit që shpërndahen tek një grup i kontratave të sigurimit të njohura në datën e tranzicionit rregullojnë marzhin e kontraktuar të shërbimit të atij grupi, në masën që kontratat e sigurimit të cilat pritet të jenë në grup njihen në atë datë (shih paragrafët 28C dhe B35C). Flukse të tjera monetare të blerjes së sigurimit të paguara para datës së tranzicionit, përfshirë ato të shpërndara tek një grup kontratash sigurimi që pritet të njihen pas datës së transaksionit, njihen si një aktiv duke zbatuar paragrafin 28B.

C14D Nëse njësia ekonomike nuk ka informacion të arsyeshëm dhe mbështetës për të zbatuar paragrafin C14B, ajo do të përcaktojë që shumat në vijim të jenë zero në datën e tranzicionit:

(a) rregullimi i marzhit të kontraktuar të shërbimit të një grupi kontratash të njohura në datën e tranzicionit dhe të çdo aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit të lidhura me atë grup; dhe

(b) aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit për grupet e kontratave të sigurimit që pritet të njihen pas datës së tranzicionit.

C15 Nëse zbatimi i paragrafëve C12–C14D rezulton në marzh të kontraktuar shërbimi në datën e njohjes fillestare, për të përcaktuar marzhin e kontraktuar të shërbimit në datën e tranzicionit njësia ekonomike do:

(a) të përdorë normat e vlerësuara të skontimit, që zbatohen në njohjen fillestare për interesin e rritur në marzhin e kontraktuar të shërbimit, nëse njësia zbaton C13 për vlerësimin e këtyre normave; dhe

(b) përsa lejohet nga paragrafi C8, të përcaktojë shumën e marzhit të kontraktuar të shërbimit të njohur në rezultat për shkak të transferimit të shërbimeve para datës së tranzicionit, duke krahasuar njësitë për mbulimin e mbetur në atë datë me njësitë e mbulimit të ofruara sipas grupit të kontratave para datës së tranzicionit (shih paragrafin B119).

C16 Nëse zbatimi i paragrafëve C12–C14D sjell një përbërës humbjeje nga detyrimi për mbulimin e mbetur në datën e njohjes fillestare, njësia ekonomike do të përcaktojë çdo shumë të shpërndarë tek përbërësi humbje para datës së tranzicionit, duke zbatuar paragrafët C12–C14D dhe duke përdorur një bazë shpërndarje sistematike.

C16A Për një grup të kontratave të risigurimit të mbajtura që ofrojnë mbulim për një grup me kushte rënduese të kontratave të sigurimit dhe që kishte hyrë në fuqi në të njëjtën kohë me emetimin e kontratave të sigurimit ose më parë, njësia ekonomike do të krijojë një përbërës rikuperim humbje të aktivit për mbulimin e mbetur në datën e tranzicionit (shih paragrafët 66A–66B). Në masën e lejuar nga paragrafi C8, njësia ekonomike do të përcaktojë përbërësin rikuperim humbje duke shumëzuar:

(a) përbërësin humbje të detyrimit për mbulimin e mbetur të kontratave të sigurimit bazë në datën e transaksionit (shih paragrafët C16 dhe C20); dhe

(b) përqindjen e kërkesave shtesë mbi kontratat e sigurimit bazë që njësia ekonomike pret të rikuperojë nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura.

C16B Duke zbatuar paragrafët 14–22, në datën e tranzicionit njësia ekonomike mund të përfshijë në një grup me kushte rënduese të kontratave të sigurimit, si kontratat e sigurimit me kushte rënduese të mbuluara nga një grup i kontratave të risigurimit të mbajtura ashtu edhe kontratat me kushte rënduese jo të mbuluara nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura. Në raste të tilla, për të zbatuar paragrafin C16A njësia ekonomike do të përdorë një bazë shpërndarjeje sistematike dhe racionale për të përcaktuar pjesën e përbërësit humbje të grupit të kontratave të sigurimit që lidhen me kontratat e sigurimit të mbuluara nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura.

C16C Nëse njësia ekonomike nuk ka informacion të arsyeshëm dhe mbështetës për të zbatuar paragrafin C16A, njësia ekonomike nuk do ta identifikojë një përbërës rikuperim humbjeje për grupin e kontratave të risigurimit të mbajtuara.

Përcaktimi i marzhit të kontraktuar të shërbimit ose përbërësit humbje për grupet e kontratave të sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë

C17 Për sa lejohet nga paragrafi C8, për kontratat me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, njësia ekonomike në datën e tranzicionit duhet të përcaktojë marzhin e kontraktuar të shërbimit ose përbërësin humbje të detyrimit për mbulimin e mbetur si:

(a) total i vlerës së drejtë të zërave bazë në atë datë; minus

(b) flukset e mjeteve monetare të realizuara në atë datë; plus ose minus

(c) një rregullim për:

(i) shumat e ngarkuara nga njësia ekonomike tek policë mbajtësit (përfshirë shumat e zbritura nga zërat bazë) para asaj date.

(ii) shumat e paguara para asaj date, të cilat nuk do të kishin ndryshuar bazuar në zërat bazë.

(iii) ndryshimi në rregullimin për rrezikun jo-financiar të shkaktuar nga lirimi prej rrezikut para asaj date. Njësia ekonomike do të vlerësojë këtë shumë duke i'u referuar lirimit nga rreziku për kontratat e ngjashme të sigurimit, që njësia ekonomike emeton në datën e tranzicionit.

(iv) flukset monetare të blerjes së sigurimit të paguara (ose për të cilat është njohur një detyrim duke zbatuar një SNRF tjetër) para datës së tranzicionit që janë shpërndarë tek grupi (shih paragrafin C17A).

(d) nëse pikat (a)–(c) sjellin një marzh të kontraktuar shërbimi—minus shumën e marzhit të kontraktuar të shërbimit që lidhet me shërbimet e ofruara para asaj date. Totali sipas pikave (a)–(c) është një përafrues i marzhit total të kontraktuar të shërbimit për të gjitha shërbimet që do të

 © Fondacioni i SNRF-ve

ofrohen sipas grupit të kontratave,d.m.th para çdo shume që do të ishte njohur në fitimin ose humbjen për shërbimet e ofruara. Njësia ekonomike do të vlerësojë shumat që do të ishin njohur në rezultat për shërbimet e ofruara, duke krahasuar njësitë për mbulimin e mbetur në datën e tranzicionit me njësitë e mbulimit të ofruara sipas grupit të kontratave para datës së tranzicionit; ose

(e) nëse pikat (a)–(c) sjellin një përbërës humbje—rregullon përbërësin humbje në zero dhe rrit detyrimin për mbulimin e mbetur, duke përjashtuar përbërësin humbje me të njëjtën shumë.

C17A Në masën e lejuar nga paragrafi C8, njësia ekonomike do të zbatojë paragrafët C14B–C14D për të njohur një aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit si dhe çdo rregullim në marzhin e kontraktuar të shërbimit të një grupi kontratash sigurimi me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë për flukset monetare të blerjes së sigurimit (shih paragrafin C17(c)(iv)).

Të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit

C18 Për grupet e kontratave të sigurimit që, duke zbatuar paragrafin C10, përfshijnë kontratat e emetuara përtej një viti nga njëra-tjetra:

(a) lejohet që njësia ekonomike të përcaktojë normat e skontimit në datën e njohjes fillestare të një grupi të specifikuar në paragrafët B72(b)–B72(e)(ii) dhe normat e skontimit në datën e kërkesave shtesë të pësuara të cilësuara në paragrafin B72(e)(iii) në datën e tranzicionit, në vend të datës së njohjes fillestare apo të datës së kërkesës shtesë të pësuar.

(b) nëse njësia ekonomike zgjedh të zbërthejë të ardhurat ose shpenzimet financiare nga sigurimi mes shumave të përfshira në rezultat (fitim ose humbje) dhe shumave të përfshira në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse duke zbatuar paragrafët 88(b) ose 89(b), njësia ekonomike duhet të përcaktojë shumën e akumuluar të të ardhurave ose shpenzimeve financiare nga sigurimi, të njohura në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në datën e tranzicionit për të zbatuar paragrafin 91(a) në periudhat e ardhshme. Lejohet që njësia ekonomike ta përcaktojë atë diferencë të akumuluar ose duke zbatuar paragrafin C19(b) ose:

(i) si zero, me përjashtim të rastit kur zbatohet pika (ii); dhe

(ii) për kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë për të cilat zbatohet paragrafi B134, si shumë të barabartë me shumën e akumuluar të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse nga zërat bazë.

C19 Për grupet e kontratave të sigurimit, të cilat nuk përfshijnë kontratat e emetuara përtej një viti nga njëra-tjetra:

(a) nëse njësia ekonomike zbaton paragrafin C13 për të vlerësuar normat e skontimit që zbatohen në njohjen fillestare (ose më pas), ajo do të përcaktojë edhe normat e skontimit të specifikuara në paragrafët B72(b)–B72(e) duke zbatuar paragrafin C13; dhe

(b) nëse njësia ekonomike zgjedh të zbërthejë të ardhurat ose shpenzimet financiare nga sigurimi mes shumave të përfshira në rezultat (fitim ose humbje) dhe shumave të përfshira në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse duke zbatuar paragrafët 88(b) ose 89(b), njësia ekonomike duhet të përcaktojë shumën e akumuluar të të ardhurave ose shpenzimeve financiare nga sigurimi të njohura në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në datën e tranzicionit për të zbatuar paragrafin 91(a) në periudhat e ardhshme. Njësia ekonomike do të përcaktojë këtë diferencë të akumuluar:

(i) për kontratat e sigurimit për të cilat njësia ekonomike do të zbatojë metodën e shpërndarjes sistematike të paraqitur në paragrafin B131—nëse njësia ekonomike zbaton paragrafin C13 për të vlerësuar normat e skontimit në njohjen fillestare—duke përdorur normat e skontimit që zbatohen në datën e njohjes fillestare, gjithashtu sipas paragrafit C13;

(ii) për kontratat e sigurimit për të cilat njësia ekonomike do të zbatojë metodën e shpërndarjes sistematike të paraqitur në paragrafin B132—mbi bazën se supozimet që lidhen me rrezikun financiar të zbatuar në datën e njohjes fillestare janë ato që zbatohen në datën e tranzicionit, d.m.th zero;

(iii) për kontratat e sigurimit për të cilat njësia ekonomike do të zbatojë metodën e shpërndarjes sistematike të paraqitur në paragrafin B133—nëse njësia ekonomike zbaton paragrafin C13 për të vlerësuar normat e skontimit në njohjen fillestare (ose më pas)—duke përdorur normat e skontimit që zbatohen në datën e kërkesës shtesë të pësuar, gjithashtu sipas paragrafit C13; dhe

(iv) për kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë për të cilat zbatohet paragrafi B134—si shumë të barabartë me shumën e akumuluar të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse nga zërat bazë.

C19A Duke zbatuar paragrafin B137, njësia ekomomike mund të zgjedhë të mos ndryshojë vlerësimin kontabël të bërë në pasqyrat financiare të ndërmjetme të mëparshme. Në masën e lejuar nga paragrafi C8, një njësi e tillë ekonomike do të përcaktojë shumat e lidhura me të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit në datën e tranzicionit sikur ajo të mos kishte përgatitur pasqyra financiare të ndërmjetme para datës së tranzicionit.

Modeli i vlerës së drejtë

C20 Për të zbatuar modelin e vlerës së drejtë, njësia ekonomike do të përcaktojë marzhin e kontraktuar të shërbimit ose përbërësin humbje nga detyrimi për mbulimin e mbetur në datën e tranzicionit si diferencë mes vlerës së drejtë të grupit të kontratave të sigurimit në atë datë dhe flukseve monetare përmbushëse të matura në atë datë. Në përcaktimin e kësaj vlere të drejtë, njësia ekonomike nuk duhet të zbatojë paragrafin 47 të SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë* (që lidhet me tiparet e kërkuara).

C20A Për një grup kontratash risigurimi të mbajtura për të cilat zbatohen paragrafët 66A–66B (pa pasur nevojë të plotësojnë kushtet e paraqitura në paragrafin B119C), njësia ekonomike do të përcaktojë përbërësin rikuperim humbje të aktivit për mbulimin e mbetur në datën e tranzicionit duke shumëzuar:

(a) përbërësin humbje të detyrimit për mbulimin e mbetur të kontratave të sigurimit bazë në datën e transaksionit (shih paragrafët C16 dhe C20); dhe

(b) përqindjen e kërkesave shtesë mbi kontratat e sigurimit bazë që njësia ekonomike pret të rikuperojë nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura.

C20B Duke zbatuar paragrafët 14–22, në datën e tranzicionit njësia ekonomike mund të përfshijë në një grup me kushte rënduese të kontratave të sigurimit, si kontratat e sigurimit me kushte rënduese të mbuluara nga një grup i kontratave të risigurimit të mbajtura ashtu edhe kontratat me kushte rënduese jo të mbuluara nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura. Në raste të tilla, për të zbatuar paragrafin C20A njësia ekonomike do të përdorë një bazë shpërndarjeje sistematike dhe racionale për të përcaktuar pjesën e përbërësit humbje të grupit të kontratave të sigurimit që lidhen me kontratat e sigurimit të mbuluara nga grupi i kontratave të risigurimit të mbajtura.

C21 Kur zbaton metodën e vlerës së drejtë, njësia ekonomike mund të zbatojë paragrafin C22 për të përcaktuar:

(a) sesi të identifikojë grupet e kontratave të sigurimit, duke zbatuar paragrafët 14–24;

(b) nëse një kontratë sigurimi plotëson përkufizimin e kontratës së sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, duke zbatuar paragrafët B101–B109;

(c) sesi të identifikojë flukset monetare sipas vullnetit të njësisë ekonomike për kontratat e sigurimit pa tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, duke zbatuar paragrafët B98–B100; dhe

(d) nëse një kontratë investimi plotëson përkufizimin e një kontrate investimi me tipare të pjesëmarrjes së lirë brenda objektit të SNRF 17, duke zbatuar paragrafin 71.

C22 Njësia ekonomike mund të zgjedhë të përcaktojë çështjet në paragrafin C21 duke përdorur:

(a) informacionin e arsyeshëm dhe mbështetës që njësia do të kishte përcaktuar nisur nga kushtet specifike të kontratës dhe të tregut në datën e krijimi ose të njohjes fillestare, cila të ishte më e përshtatshme; ose

(b) informacionin e arsyeshëm dhe mbështetës në dispozicion në datën e tranzicionit.

C22A Kur zbaton metodën e vlerës së drejtë, njësia ekonomike mund të zgjedhë të klasifikojë si detyrim për kërkesat shtesë të pësuara një detyrim për shlyerjen e kërkesave shtesë të ndeshura para se një kontratë sigurimi të ishte blerë në një transferim kontratash sigurimi që nuk formojnë një biznes ose në një kombinim biznesi brenda objektit të SNRF 3.

C23 Kur zbatohet metoda e vlerës së drejtë, nuk kërkohet që njësia ekonomike të zbatojë paragrafin 22 dhe ajo mund të përfshijë në një grup kontrata të emetuara përtej një viti nga njëra-tjetra. Njësia ekonomike do t'i ndajë grupet vetëm në ato që përfshijnë kontrata të emetuara brenda një viti (ose më pak) nëse ka informacion të arsyeshëm dhe mbështetës për të bërë ndarjen. Pavarësisht nëse njësia ekonomike zbaton paragrafin 22, lejohet që njësia të përcaktojë normat e skontimit në datën e njohjes fillestare të një grupi të specifikuar në paragrafët B72(b)–B72(e)(ii) dhe normat e skontimit në datën e kërkesave shtesë të pësuara të cilësuara në paragrafin B72(e)(iii) në datën e tranzicionit, në vend të datës së njohjes fillestare apo të datës së kërkesës shtesë të pësuar.

 © Fondacioni i SNRF-ve

C24 Kur zbatohet metoda e vlerës së drejtë, nëse njësia ekonomike zgjedh të zbërthejë të ardhurat ose shpenzimet financiare nga sigurimi mes fitimit apo humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, lejohet që ajo të përcaktojë shumën e akumuluar të të ardhurave ose shpenzimeve financiare nga sigurimi të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në datën e tranzicionit:

(a) në mënyrë retrospektive—por vetëm nëse ka informacion të arsyeshëm dhe mbështetës për ta bërë këtë; ose

(b) si zero—me përjashtim të rastit kur zbatohet pika (c); dhe

(c) për kontratat e sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë për të cilat zbatohet paragrafi B134—si shumë të barabartë me shumën e akumuluar të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse nga zërat bazë.

Aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit

C24A Kur zbatohet metoda e vlerës së drejtë për aktivin e flukseve monetare të blerjes së sigurimit (shih paragrafin C5B(b)) në datën e tranzicionit, njësia ekonomike do të përcaktojë një aktiv për flukset monetare të blerjes së sigurimit me një shumë të barabartë me flukset monetare të blerjes së sigurimit që njësia ekonomike do të ndeshë në datën e tranzicionit për të drejtat për të marrë:

(a) rikuperime të flukseve monetare të blerjes së sigurimit nga primet e kontratave të sigurimit të emetuara para datës së tranzicionit por ende të panjohura në datën e tranzicionit;

(b) kontrata të ardhshme të sigurimit që janë rinovime të kontratave të sigurimit të njohura në datën e transaksionit dhe kontratat e sigurimit të përshkruara në pikën (a); dhe

(c) kontrata të ardhshme sigurimi, të ndryshme nga ato në pikën (b), pas datës së transaksionit pa paguar përsëri flukset monetare të blerjes së sigurimit që blerësi ka paguar tashmë dhe që janë të ngarkueshme drejtpërdrejt tek portofoli përkatës i kontratave të sigurimit.

C24B Në datën e tranzicionit, njësia ekonomike do të përjashtojë nga matja e çdo grupi kontratash sigurimi shumën e ndonjë aktivi për flukset monetare të blerjes së sigurimit.

Informacion krahasues

C25 Pavarësisht referencës për periudhën vjetore që menjëherë i paraprin datës së aplikimit fillestar në paragrafin C2(b), një njësi ekonomike mundet gjithashtu të paraqesë informacion krahasues duke zbatuar SNRF 17 për çdo periudhë më të hershme të paraqitur, por kjo nuk i kërkohet. Nëse njësia ekonomike paraqet informacion krahasues të rregulluar për çdo periudhë më të hershme, referenca 'fillimi i periudhës vjetore raportuese që i paraprin menjëherë datës së zbatimit fillestar' në paragrafin C2(b) do të lexohet si 'fillimi i periudhës krahasuese të rregulluar më të hershme të paraqitur'.

C26 Nuk kërkohet që njësia ekonomike të japë informacionet shpjeguese të specifikuara në paragrafët 93–132 për ndonjë periudhë të paraqitur para fillimit të periudhës vjetore të raportimit që paraprin menjëherë datën e zbatimit fillestar.

C27 Nëse një njësi ekonomike paraqet informacion krahasues dhe shpjegues të pa rregulluar për ndonjë periudhë të më hershme, ajo do të identifikojë qartazi që informacioni nuk është i rregulluar, të deklarojë që informacioni është përgatitur mbi baza të ndryshme, si dhe t'i shpjegojë këto baza.

C28 Nuk nevojitet që njësia ekonomike të japë informacione shpjeguese të papublikuara më parë rreth zhvillimit të kërkesave shtesë të ndodhura më herët se pesë vite para fundit të periudhës vjetore raportuese, në të cilën zbatohet për herë të parë SNRF 17. Megjithatë, nëse njësia ekonomike nuk jep atë informacion shpjegues do ta publikojë këtë fakt.

Njësitë ekonomike që zbatojnë njëkohësisht për herë të parë SNRF 17 dhe SNRF 9

C28A Njësia ekonomike që zbaton njëkohësisht për herë të parë SNRF 17 dhe SNRF 9 lejohet të zbatojë paragrafët C28B–C28E (mbivendosje në klasifikim) me qëllim paraqitjen e informacionit krahasues mbi një aktiv financiar, nëse informacioni krahasues për atë aktiv financiar nuk është riparaqitur sipas SRNF 9. Informacioni krahasues për një aktiv financiar nuk do të riparaqitet sipas SNRF 9 nëse njësia ekonomike zgjedh të mos riparaqesë periudhat e mëparshme (shih paragrafin 7.2.15 të SNRF 9), ose nëse njësia ekonomike riparaqet periudhat e mëparshme por aktivi financiar është ç'regjistruar gjatë atyre periudhave të mëparshme (shih paragrafin 7.2.1 të SNRF 9).

C28B Një njësi ekonomike që zbaton mbivendosjen në klasifikim të një aktivi financiar, duhet të paraqesë informacion krahasues sikur kërkesat e SNRF 9 për klasifikimin dhe matjen të ishin zbatuar për atë aktiv financiar. Njësia ekonomike duhet të përdorë informacionin e arsyeshëm dhe mbështetës në dispozicion në datën e tranzicionit (shih paragrafin C2(b)) për të përcaktuar sesi njësia ekonomike pret që aktivi financiar do të klasifikohet dhe matet në zbatimin fillestar të SNRF 9 (për shembull, njësia ekonomike mund të përdorë vlerësime paraprake të kryera më parë për t'u përgatitur për zbatimin fillestar të SNRF 9).

C28C Kur zbatohet mbivendosja në klasifikimin e një aktivi financiar, nuk kërkohet që njësia ekonomike të zbatojë kërkesat për zhvlerësim të Seksionit 5.5 të SNRF 9. Nëse, bazuar në klasifikimin e përcaktuar sipas zbatimit të paragrafit C28B, aktivi financiar do të jetë objekt i kërkesave për zhvlerësim të Seksionit 5.5 të SNRF 9 por njësia ekonomike nuk i zbaton ato kërkesa duke zbatuar mbivendosjen në klasifikim, njësia do të vazhdojë të paraqesë çdo shumë të njohur në lidhje me zhvlerësimin në periudhat e mëparshme, në përputhje me SNK 39 *Instrumentet financiare - Njohja dhe matja.* Përndryshe, shuma të tilla do të anullohen.

C28D Çdo diferencë mes vlerës kontabël (neto) të mëparshme të aktivit financiar dhe vlerës kontabël (neto) në datën e tranzicionit që vjen nga zbatimi i paragrafëve C28B–C28C do të njihet në çeljen e fitimeve të pashpërndara (ose të një përbërësi tjetër të kapitalit neto, si të jetë më e përshtatshme) në datën e tranzicionit.

C28E Njësia ekonomike që zbaton paragrafët C28B–C28D do të:

(a) japë informacion shpjegues cilësor që u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë:

(i) madhësinë e zbatimit të mbivendosjes në klasifikim (për shembull, nëse është zbatuar për të gjithë aktivet financiare të panjohura në periudhën krahasuese);

(ii) nëse dhe deri në ç'masë janë zbatuar kërkesat për zhvlerësim të Seksionit 5.5 të SNRF 9 (shih paragrafin C28C);

(b) zbatojë këta paragrafë vetëm për informacionin krahasues për periudhat e raportimit mes datës së tranzicionit në SNRF 17 dhe datës së zbatimit fillestar të SNRF 17 (shih paragrafët C2 dhe C25); dhe

(c) zbatojë kërkesat kalimtare të SNRF 9 (shih Seksionin 7.2 të SNRF 9) në datën e zbatimit fillestar të SNRF 9.

Riklasifikimi i aktiveve financiare

C29 Në datën e zbatimit fillestar të SNRF 17, njësia ekonomike që ka zbatuar SNRF 9 për periudhat vjetore të raportimit para zbatimit fillestar të SNRF 17:

(a) mund të rivlerësojë nëse një aktiv financiar i përshtatshëm plotëson kushtet në paragrafin 4.1.2(a) ose paragrafin 4.1.2A(a) të SNRF 9. Një aktiv financiar është i përshtatshëm vetëm nëse aktivi financiar nuk mbahet i lidhur me një aktivitet që është i palidhur me kontratat brenda objektit të SNRF 17. Shembuj të aktiveve financiare që nuk do të jenë të pranueshme për rivlerësim janë ato aktive të mbajtura në lidhje me aktivitetet bankare ose aktivet financiare të mbajtura në fonde që kanë të bëjnë me kontratat e investimeve që janë jashtë objektit të SNRF 17.

(b) do të anullojë përcaktimin e saj të mëparshëm të një aktivi financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse kushti në paragrafin 4.1.5 të SNRF 9 nuk përmbushet më si rezultat i zbatimit të SNRF 17.

(c) mund të caktojë një aktiv financiar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse plotësohet kushti në paragrafin 4.1.5 të SNRF 9.

(d) mund të caktojë një investim në instrument kapitali neto si një instrument me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në përputhje me paragrafin 5.7.5 të SNRF 9.

(e) mund të anullojë përcaktimin e tij të mëparshëm për një investim në instrument kapitali neto si një instrument me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në përputhje me paragrafin 5.7.5 të SNRF 9.

C30 Njësia ekonomike do të zbatojë paragrafin C29 në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e zbatimit fillestar të SNRF 17. Njësia ekonomike do të zbatojë këto përcaktime dhe klasifikime në mënyrë retrospektive. Kur bën këtë, njësia do të zbatojë kërkesat kryesore të tranzicionit në SNRF 9. Data e fillimit të zbatimit për këtë qëllim do të konsiderohet data e fillimit të zbatimit të SNRF 17.

C31 Njësisë ekonomike që zbaton paragrafin C29, nuk i kërkohet të riparaqesë periudhat e mëparshme për të pasqyruar këto ndryshime në përcaktime apo klasifikime. Njësia ekonomike mund të riparaqesë periudhat e

 © Fondacioni i SNRF-ve

mëparshme nëse është e mundur pa përdorimin e gjykimit retrospektiv. Nëse njësia ekonomike riparaqet periudhat e mëparshme, pasqyrat financiare të riparaqitura duhet të pasqyrojnë të gjitha kërkesat e SNRF 9 për aktivet financiare të prekura. Nëse njësia ekonomike nuk riparaqet periudhat e mëparshme, në datën e zbatimit fillestar ajo duhet të njohë në çeljen e fitimeve të pashpërndara (ose përbërësit e tjerë të kapitalit neto, si të jetë e përshtatshme) çdo diferencë mes:

(a) vlerës së mëparshme kontabël (neto) të atyre aktiveve financiare; dhe

(b) vlerës kontabël (neto) të atyre aktiveve financiare në datën e zbatimit për herë të parë.

C32 Kur zbaton paragrafin C29, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues në atë periudhë vjetore raportuese për ato aktive financiare sipas klasave:

(a) nëse zbatohet paragrafi C29(a)—për bazën e përcaktimit të aktiveve financiare të përshtatshëm;

(b) nëse zbatohet ndonjë nga paragrafët C29(a)–C29(e) :

(i) kategorinë e matjes dhe vlerën kontabël (neto) të aktiveve financiare të prekura, të përcaktuar menjëherë para datës së zbatimit fillestar të SNRF 17; dhe

(ii) kategorinë e re të matjes dhe vlerën kontabël (neto) të aktiveve financiare të prekura të përcaktuar pas zbatimit të paragrafit C29.

(c) nëse zbatohet paragrafi C29(b) —vlerën kontabël (neto) të aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar, të cilat më parë ishin përcaktuar si të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbje duke zbatuar paragrafin 4.1.5 të SNRF 9 dhe që nuk janë përcaktuar më si të tilla.

C33 Nëse zbaton paragrafin C29,njësia ekonomike do të paraqesë informacion shpjegues cilësor në atë periudhë vjetore raportuese, i cili do t'u mundësojë përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë:

(a) sesi ka zbatuar paragrafin C29 për aktivet financiare, klasifikimi i të cilave ka ndryshuar me zbatimin fillestar të SNRF 17;

(b) arsyet për çdo përcaktim ose jo, të aktiveve financiare si të matur me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes, duke zbatuar paragrafin 4.1.5 të SNRF 9; dhe

(c) pse njësia ekonomike ka dalë në ndonjë përfundim të ndryshëm në vlerësimin e ri duke zbatuar paragrafët 4.1.2(a) ose 4.1.2A(a) të SNRF 9.

C33A Për një aktiv financiar të ç'regjistruar mes datës së tranzicionit dhe datës së zbatimit fillestar të SNRF 17, njësia ekonomike mund të zbatojë paragrafët C28B–C28E (mbivendosja në klasifikim) me qëllim paraqitjen e informacionit krahasues sikur paragrafi C29 të ishte zbatuar ndaj atij aktivi. Njësia ekonomike, në këtë rast do të përshtas kërkesat e paragrafëve C28B–C28E që mbivendosja në klasifikim të bazohet në pritshmërinë e njësisë, për përcaktimin e aktivit financiar sipas paragrafit C29, në datën e zbatimit fillestar të SNRF 17.

Heqja e Standardeve të tjera

C34 SNRF 17 zëvendëson SNRF 4 *Kontrata sigurimi*, të ndryshuar në vitin 2020.